


Sulltan Ahmed Kureshi

Sulltan Ahmed Kureshi

LOGOS-A ■ LETRAT E MUHAMMEDIT A.S.



Letrat e
Muhammedit a.s.





© LOGOS - A
2 0 0 3



S H K U P
PRISHTINË
TIRANË



■ **Sulltan Ahmed Kureshi**

■ **Letrat e**

■ **Muhammedit a.s.**



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jprofitorial.
Njo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Pse, nëse kopjohet riprodhim, transmetimi apo krijimi i kopjeve të tjera në tërësi pa lejeje paraprake të Logos-it.



Përkthet nga anglishtja:
Mimoza Sinani

Titulli i originalit:
Letters of the Holy Prophet,
Muslim Educational Trust,
Book Market, Main Bazar, Lhr.

Sulltan Ahmed Kureshi

Letrat e Muhammedit a.s.



Sulitan Ahmed Kureshi
LETRAT E MUHAMMEDIT A.S.

Baton: **Logos-A**
Biblioteka: **Lexo**

Për botuesin: **Adnan Ismaili**
Kryeredaktor: **Husamedin Abazi**

Redaktor profesional: **Nexhat Ibrahim**

Redaktor gjuhësor: **dr. Qemal Murati**
Redaktor artistik & disenjator: **Edi Agagjyshi**
Redaktor teknik & faqesë: **Azem Zaimi**

Mbikëqyrës i shtypit: **Imer Gogjufi**
Përgatitja kompjuterike: **Focus Pro - Shkup**
Shtypi: **Focus - Prishtinë**

Copyright © Logos-A, 2003

Shënimi i CIP katalogut i këtij libri gjendet
në Bibliotekën Kombëtare Universitare
ISBN 9989-58-059-6

www.logos-a.com



Handwritten text in an early Arabic script, likely from a papyrus scroll. The text is arranged in approximately 12 horizontal lines. The script is dense and somewhat irregular, characteristic of early Arabic writing. The fragment appears to be a portion of a larger document, with some text cut off at the edges.

Letra e Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.),
dërguar Negusit, mbretit të Etiopisë

Handwritten text in an early Arabic script, likely from a papyrus scroll. The text is arranged in approximately 12 horizontal lines. The script is dense and somewhat irregular, characteristic of early Arabic writing. The fragment appears to be a portion of a larger document, with some text cut off at the edges.

Letra e Pejgamberit, Muhammedit (s.a.v.s.),
dërguar Husro Perwezit, Perandorit (Kisra) të Iranit

Përmbajtja

Hyrje.....	6
PJESA E PARË: TRAKTATET, PAKTET DHE MARRËVESHJET	56
1. Karta e Medines	58
2. Pakti me fisin e Xhuhejnit	70
3. Vendimi i dytë i Pejgamberit (s.a.v.s.) për Xhuhejnin.....	71
4. Pakti me Benu Dhamra	73
5. Për Benu Zur'a dhe Benu Rab'a	74
6. Pakti me Benu Gifar	75
7. Traktati i Hudejbijes	77
8. Pakti me Benu Gadaja dhe Benu Ureiz.....	79
9. Pakti i Nexhranit.....	80
10. Pakti i Thekifit (Taif)	84
11. Pakti me Ekber bin Abdu'l-Kais-in.....	90
PJESA E DYTË: LETRAT DREJTUAR PERANDORËVE, MBRETËRVE, SUNDIMTARËVE, MËKËMBSAVE, GUVERNATORËVE ETJ.	92
1. Letra drejtuar Negusit, mbretit të Etiopisë.....	93
2. Letra drejtuar Ebu Sufjanit	97
3. Letra e dytë drejtuar mbretit të Etiopisë	99
3/a. Drejtuar Muhammedit, Pejgamberit të Allahut.....	101
4. Letra e tretë drejtuar Mbretit të Etiopisë	102
5. Letra drejtuar Herakli Çezarit	103
6. Letra drejtuar Husro Perwezit, Perandorit të Farsit (Persisë).....	109
7. Letra drejtuar Hurmuzit.....	110
8. Letra drejtuar Mëkëmbësit të Egjiptit	111
8/a. Drejtuar Muhammedit, djalit të Abdullahun.....	114
9. Letra drejtuar Huza'a bin Ali, guvernatorit të Jemenit.....	117
9/a. Përgjigja e guvernatorit të Jemenit	118
10. Letra drejtuar Haris Gassanit, mbretit të Damaskut.....	119
11. Letra drejtuar Mundhir bin Sawa, guvernatorit të Bahreinit	122
11/a. Letra nga Mundhir bin Sawa,	124
12. Letra e dytë drejtuar Mundhirit.....	125
13. Letra drejtuar Xhaferit dhe 'Abdit, sundimtarëve të Omanit.....	126

14. Letra drejtuar trashëgimtarit të As'hama Negusit	128
15. Letra drejtuar mbretërve të Himjarit.....	130
16. Letra e dytë drejtuar mbretërve të Himjarit	132
17. Letra drejtuar Farwahut, guvernatorit të Maanit	135
18. Letra drejtuar Amr ibn Hazm El-Ensarit, guvernatorit të Jemenit.....	137
19. Letra drejtuar Ukeidirit, sundimtarit të Dummet 'ul-Xhendel.....	142
PJESA E TRETË: LETRAT DHE VENDIMET DREJTUAR KRYETARËVE, UDHËHEQËSVE, PRIJËSVE TË FISEVE TË NDRYSHME DHE INDIVIDËVE	144
1. Letra drejtuar Papës së Romës	146
2. Letra drejtuar çifutëve të Hajberit	148
3. Letra drejtuar Budeil bin Warakas	150
4. Letra drejtuar popullit të fisit Aslam.....	152
5. Letra drejtuar popullit të trevës së Tihama-s	153
6. Letra drejtuar Halid bin Zimad 'ul-Azdit	155
7. Letra drejtuar Hilal bin Umejjes, kryetarit të Bahreinit	157
8. Letra drejtuar Usaibuh bin Abdullah, prijësit të Haxherit.....	158
9. Letra drejtuar Benu Abdullahut	160
10. Letra drejtuar Nahshall bin Malikut, kryetarit të Beni Va'ilit	162
11. Letra drejtuar Rifa' bin Zaid Xhuzamit	163
12. Letra drejtuar Benu Asadit	164
13. Letra drejtuar prijësve të Akaba-s	165
14. Letra drejtuar popullit të Makna-s	168
15. Letra drejtuar popullit të Azruh-it	170
16. Letra drejtuar kryetarit të Hamdan-it	171
17. Letra drejtuar Halid bin Velidit (r.a.).....	173
18. Letra drejtuar Musejleme Kedhabit (Gënjeshtarit)	175
19. Letra drejtuar Mu'adh bin Xhebelit (r.a.)	177
20. Letra drejtuar xhinnëve	179
21. Letra drejtuar Dhul Gussa Kaisit	182
22. Letra drejtuar 'Amr bin Ma'bad El-Xhuheniut.....	183
23. Letra drejtuar Benu Zuheirit	184
24. Letra drejtuar Suheil bin 'Amrit	185
25. Letra drejtuar fisit Has'am.....	187
26. Letra drejtuar Zemel bin 'Amr el-Uzrit.....	188
PJESA E KATËRT: VENDIMET, RREGULLAT, UDHËZIMET, DOKUMENTET, E TË TJERA TË SHPËRNDARA PREJ PEJGAMBERIT (S.A.V.S.), DREJTUAR UDHËHEQËSVE TË FISEVE TË NDRYSHME APO INDIVIDËVE.....	190

1. Vendimet e Pejgamberit (s.a.v.s.) drejtuar 'Amr bin Murra Xuheniut..	192
2. Vendimet drejtuar Muttarif bin Kahin 'ul-Bahilit.....	194
3. Vendimet drejtuar Xuhanna për paqe.....	195
4. Dokumenti dhuruar Temim 'ud-Darit (r.a.).....	196
5. Vendimet drejtuar fisit Laham.....	198
6. Vendimet drejtuar Benu El-Bekkas	199
7. Drejtuar Benu Ukailit	200
8. Letra drejtuar Benu Ukailit.....	201
9. Drejtuar fisit Barik.....	202
10. Drejtuar Zur'a Dhi Xhezan	203
11. Drejtuar prijësve të 'Abahilës, Hadrameutit	205
12. Letra e dytë drejtuar prijësve të 'Abahilës, Hadrameutit.....	207
13. Drejtuar Wa'il bin Huxherit	208
14. Drejtuar kryetarëve të Jemenit.....	210
15. Vendimet drejtuar Jezid Binal-Muhaxhxhel Harithit	214
16. Drejtuar Benu Muavij bin Xherwelit.....	215
17. Urdhërat drejtuar Dhumeir Saisë	216
18. Urdhërat drejtuar Benu Nehadit	218
19. Urdhëri drejtuar 'Abd Jeguth Al-Harithit	219
20. Urdhërat drejtuar Rebi'a bin Dhi Merhab El-Hadrameutit	220
21. Vendimet drejtuar fisit Kelb	221
22. Vendimet drejtuar Mehr bin El-Abjad.....	222
23. Vendimet drejtuar 'Amir bin Eswed Tait	223
24. Vendimet drejtuar Habib bin 'Amar El-Tait	224
25. Urdhërat drejtuar Benu Xhuweinit.....	225
26. Dokumenti dhuruar Zubeir bin Awwamit.....	226
27. Dokumenti dhuruar Ausa bin Hurmele Xuheniut	227
28. Urdhërat drejtuar Benu Xhurmuzit	228
29. Dokumenti dhuruar Benu Shamahut	229
30. Dokumenti dhuruar Benu El-Harisit.....	230
31. Dokumenti dhuruar Bilal bin Haris El-Muzanit	231
32. Dokumenti dhuruar Hiram bin Abd'As-Sulamit	232
33. Dokumenti dhuruar Sa'id bin Sufjanit	233
34. Dokumenti dhuruar 'Utba bin Farkadit	234
Epilogu.....	235

Lista e fotografive të Letrave të të Dërguarit Muhammedit (s.a.v.s.)

- 1. Letra drejtuar Negusit, Mbretit të Etiopisë**
- 2. Letra drejtuar Husro Pervezit, Perandorit të Iranit**
- 3. Letra drejtuar Mukaukisit, Mëkëmbësit të Egjiptit**
- 4. Letra djretuar Mundhir bin Sa'wa, Guvernatorit të Bahreinit**

Shkurtesat:

- | | | |
|------------|---|--|
| - xh.sh | = | xhel-le shanuhu |
| - s.a.v.s. | = | sal-la'll-llahu alejhi ve sel-lem |
| - a.s. | = | alejhi's-selam (alejhimu's-selam) |
| - r.a. | = | radija'll-llahu anhu (anha, apo anhum) |

Hyrje

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

Ky libër është një përpilim i letrave, traktateve, marrëveshjeve dhe vendimeve të njeriut më të çmuar të mbarë njerëzimit. Ai ishte ligjdhënës i parë i botës. I dhuroi mbarë njerëzimit dinjitetin, barazinë dhe drejtësinë e vërtetë. U tregoi rrugën e vërtetë dhe të drejtë pasuesve të tij.

Ai është më i lavdëruari, si askush tjetër ndonjëherë, me lavdërime që i bëhen atij vazhdimisht, ditë e natë, që vazhdojnë dhe do të vazhdojnë t'i bëhen përherë. Ka pasur qindra mijëra peygamberë, heronj, udhëheqës, pushtues, luftëtarë dhe bamirës. Ndoshta emrat e shumë prej tyre sot nuk njihen prej nesh, disa prej tyre jetojnë vetëm në faqet e historisë. Qindra libra janë shkruar për disa prej tyre. Megjithatë, është i pakundërshtueshëm fakti se numri i librave të shkruara për jetën e Pejgamberit. Muhammed, sal-la'll-llahu alejhi ve sel-lem (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të), e tejkalon numrin e librave

të shkruara për jetën e çdonjërit, të marra të gjitha së bashku. Nga të gjithë njerëzit spikat një personalitet i vetëm, unikat dhe i papërsëritshëm, për të cilin mijëra e mijëra njerëz nga e mbarë bota i drejtohen Allahut për ta bekuar. Kurdoherë që një musliman dëgjon të përmen-det emri i Pejgamberit (s.a.v.s.), ai dërgon salavate (paqja dhe bekimi i Allahut) për të. Kur fjalët: "*Rafa'na leke dhikerek*" ("Ne e lartësuam vlerën tënde) (Kur'an 94:4)), iu shpallën Pejgamberit (s.a.v.s.), Kurejshët i kishin bërë muslimanët objekt të poshtërimeve dhe përbuzjeve më të ulëta, tiranisë më të skajshme dhe egërsisë çnjerëzore, me shpresë se muslimanët do të dorëzoheshin nga shtypjet e tyre barbare dhe askush, përveç muslimanëve, nuk do të mund ta besonte se Pejgamberi (s.a.v.s.) do të ishte njeriu i lavdëruar më së shumti, në një të ardhme shumë të afërt. Dhe vetëm pas pak vitesh më vonë, vetë Kurejshët filluan ta lavdërojnë atë më së tepërmi prej të gjithëve. Ky nuk është vetëm mendimi i muslimanëve, por është dëshmuar edhe nga një hulumtu-es jomusliman nga Amerika, Ripley, i cili në volumnin e dytë të librit të tij të famshëm: "*Ta besosh atë apo jo*", ka zbuluar në mënyrë statistikore se zëri që dëgjohet në mënyrë krejtësisht të njëjtë në të gjitha anët e botës është vetëm një dhe ky zë është *Ezani* (thirrja për t'u falur). Ky, s'ka dyshim, është një fenomen unik dhe i pashembullt. Gjatë

ezanit, emri i Pejgamberit (s.a.v.s.) përmendet dy herë, pesë herë në ditë në *tekbir* (thirrja për t'u ngritur dhe për të filluar faljen) dhe gjatë lutjeve.

Pejgamberi (s.a.v.s.) është pa dyshim ligjdhënësi më i shquar i botës, pasi ai dha kushtetutën e parë të shkruar. Përpara kësaj, ligjet dhe rregullat e shkruara ishin të vlefshme, por kushtetuta e shkruar qartë, me ligje të përgjithshme nuk ishte shkruar ndokund. Ajo u formësua në *Traktatin e Medinës*, duke përfshirë 51 nene. U themelua një sistem i mbështetur plotësisht në drejtësi, barazi dhe devocion dhe jo në bazë të racizmit, ngjyrës apo gjuhës. Kjo është vërtetuar përsëri në pllakën përkujtimore të Muzeumit të Linkolnit, në të cilën emri i Pejgamberit (s.a.v.s.) duket në krye.

Përsa i përket rrugës së drejtë dhe të vërtetë që duhet të pasohet nga njerëzimi në të ardhmen, Pejgamberi (s.a.v.s.) tregoi qartë se "*Siratu'l-mustekim*" (Rruga e drejtë), që të udhëheq drejt Allahut, është bindja ndaj Tij: bërja e gjerave çfarë Allahu na urdhëron ne që të bëjmë - *ma'ruf* dhe të përmbajturit nga ajo që Allahu dëshiron t'i shmangemi - *munker*). Ai gjithashtu i këshilloi muslimanët që gjithmonë të ecin "*rrugës së mesme*" dhe të mos ndjekin ndonjë drejtim ekstrem në jetë: Ai, me një gjuhë të kthjellët dhe të qartë, tregoi se rruga e drejtë është një dhe vetëm një dhe kjo është rruga islame, në të cilën njerëzimi është udhëhequr prej të gjithë Pejgamberëve (a.s.).

Përpara se të jepen njohuri përmbledhëse rreth mësimëve islame dhe veprimtarisë së Pejgamberit (s.a.v.s), na duket e përshtatshme të paraqesim një analizë të përmbledhur të kushteve dhe atmosferës që ekzistonte në atë kohë në Arabi, në veçanti dhe në botë në përgjithësi.

Siujdhesa Arabike shërben si pikë takimi e tri kontinenteve: Azisë, Afrikës dhe Evropës. Në lindje të saj është gjiri Arabik, ndërsa në perëndim Deti i Kuq. Në veri të Arabisë janë Jordania, Iraku dhe Siria, ndërsa në jug Oqeani Indian. Sipërfaqja është përafërsisht 2.072.000 km². Pjesa më e madhe e vendit është shkretëtirë. Vargmalet shtrihen nëpër të gjithë vendin. Vargmali më i gjatë është Xhebel'us-Serat, i cili zgjatet prej Jemenit në jug dhe deri në Siri në veri. Disa pjesë të Arabisë janë tepër pjellore dhe të gjelbëruara, po aq sa edhe lugina e Jemenit dhe kodrat e Taifit. Sipërfaqja e El-Hij është e ashpër dhe shkëmbore, Arabia Qendrore është shkretëtirë, pa gjelbërim e pa ujë. Rreth e qark gjenden oaze rreth të cilave rriten kopshte me palma dhe hurma.

Arabia është e pasur me naftë, flori dhe miniera ari. Në kohën e sotme është furnizuesi më i fuqishëm i naftës.

Kur u shfaq Islami në Arabi ekzistonin dy fise, të cilët ishin banorë të hershëm të vendit. Njëri ishte Benu Ismail, pasardhës të pejgamberit

Ismail (a.s.), dhe tjetri Ebu Kahtan. I pari quhej, gjithashtu, edhe fisi Adnan. Po ashtu, në pjesë të ndryshme të vendit ekzistonin edhe koloni të vogla çifutësh. Kështu, popullsia e Arabisë, në atë kohë, përbëhej prej këtyre tre elementeve. Degë dhe nëndegë të vogla dhe të panumërta të këtyre fiseve ishin shpërndarë nëpër të gjithë vendin. Në këtë libër do të shfaqen dendur emrat e fiseve dhe nënfiseve të ndryshme, të cilëve Pejgamberi (s.a.v.s.) u dërgoi letra dhe vendime. Si rrjedhojë, do të ishte e nevojshme t'i drejtohem një përmbledhjeje të shkurtër gjenealogjike të dhënë në pjesën që vijon.

Megjithëse disa pjesë të Arabisë kishin arritur një shkallë të lartë kulture, kjo më së shumti ishte pasojë e ndikimit të vendeve fqinje. Sidoqoftë, kushtet në pjesët dhe skajet e largëta të vendit mbeteshin primitive. Përgjithësisht populli nuk kishte as kushtet më të domosdoshme. Po ashtu bindjet dhe besimet e njerëzve ndryshonin. Disa besonin tek Allahu e disa jo. Pjesa më e madhe e njerëzve ishin adhurues të idhujve. Megjithatë, ata nuk i konsideronin idhujt si zota të tyre, por besonin se idhujt shërbenin për t'i afruar tek Allahu. Si rrjedhim, ata kishin besim tek Allahu i Mbinatyrshëm. Judaizmi, kristianizmi dhe disa besime të tjera kishin gjithashtu ithtarët e tyre. Me kalimin e kohës shumë zakone të gabuara u përzier me Islamin, fenë e Ibrahimit

(a.s.). Si pasojë, feja që u mësua prej Ibrahimit - thyerja e idhujve - gradualisht u shndërrua në adhurim të idhujve. Kjo gjë kishte vajtur kaq larg, sa që idhujt filluan të adhuroheshin në Qabe, në Shtëpinë e Allahut. Besimi në jetën e përtejme, ndëshkimi për mëkatet dhe shpërblimi për virtytet, ishin të panjohura për ta. Në vend të kësaj ata kishin të zhvilluar ndjenjën e ekzagjeruar të arrogancës dhe krenarisë boshe. Për shkak të kësaj, shumë njerëz në Arabi i varrosnin vajzat e tyre të gjalla, sepse mendonin se vajzat do të ishin burim i poshtërimeve për ta dhe do t'u sillnin atyre turp.

Flijimet e njerëzve ofroheshin në altarin e idhujve. Ata nuk e dinin se ç'ishte inçesti. Ishte e lejueshme që vëllai të martohej me motrën. Po ashtu dy ose më shumë motra mund të martohej me një burrë në të njëjtën kohë. Poligamia e pakufizuar ishte diçka e zakonshme midis arabëve.

Bixhozi dhe bastet ishin mënyra e tyre e të kaluarit të kohës. Të pirët, amoraliteti dhe shturja ishin në rend të ditës. Mungesa e modestisë dhe mospasja e turpërimit kishin marrë një shtrirje kaq të madhe, sa që tregimet e shturura dhe përdhunimet tregoheshin me hollësi në publik.

Në luftë ishte diçka normale t'i digjien njerëzit të gjallë, të shqyejnë barkun e nënave dhe t'i prisjen foshnjat me shpatë. Arabët ishin të njohur për

mizoritë dhe shturrjen e tyre në mbarë botën. Pretekste të vogla ishin të mjaftueshme për të shkaktuar grindje të përgjakshme, që vazhdonin me vite. Kështu, arabët si komb kishin rënë në nivelin më të ulët e më të degraduar të shturrjes dhe degjenerimit. Fiset e ndryshme ishin vazhdimisht në grindje me njëri-tjetrin dhe luftonin ndërmjet vete. Nuk ekzistonte ndonjë forcë e unifikuar që do të mund t'i bashkonte ata, të gjithë së bashku, në një komb të vetëm. Pjesët jugore të Arabisë ishin marrë nën kontrollin e Etiopisë, pjesa lindore ishte nën kontrollin e Iranit, ndërsa pjesët veriore ishin pushtuar prej degëve bizantine të Perandorisë Romake. Megjithatë, krahinat e brendshme kishin një liri të papërfillshme, por shtetet e fuqishme fqinje dëshironin t'i pushtonin ato.

Pavarësia brenda vendit kishte një kuptim tepër përçmues në popull dhe shkaktonte tek ata një ndjenjë fodullëku dhe mendjemadhësie. Ata dëshironin ta sfidonin njëri-tjetrin me mposhtjen e burrave të vetë vendit të tyre. Ata gjuhën e tyre të pasur e përdornin për t'u vetëmbrojtur, për të poshtëruar të tjerët ose për të publikuar hapur paturpësitë e veta.

Gjendja morale e botës në përgjithësi nuk ishte më e mirë se sa ato që mbizotëronin në Arabi gjatë shekullit V dhe VI-të. Qytetërimi dhe kultura e vjetër gradualisht ishin duke u rrënuar

dhe vendin e tyre e zuri shkatërrimi, çrregullimi dhe kaosi. Kodet etike, zakonet dhe rregullat që u zhvilluan gjatë shekujve pas një pune të lodhshme dhe të vështirë, ishin shpërfillur dhe injoruar dhe vendin e tyre e kishin zënë shturja dhe dekompozimi. Është e qartë se sundimi i kaosit, përçarjes dhe brutalitetit e kishte mbërthyer tërë botën. Feja çifute dhe kristiane ishin treguar krejtësisht të paafta për ta kthyer njerëzimin në rrugën e drejtësisë, paqes, dinjitetit njerëzor dhe moralit. Shtrembërimi dhe deformimi i zakoneve të drejta burimore fetare, doktrinat dhe besimet e sjella me kalimin e kohës, luftërat fraksioniste, plogështia, interesi personal dhe humbja e teksteve origjinale të *Shkrimeve të shenjta*, i shmangën njerëzit nga rruga e drejtë. Përmbajtje të huaja ishin futur brenda Shkrimeve të shenjta. Ky ishte shkaku i mosmarrëveshjes, pasi çifutët pretendonin se pejgamberi Uzejri (a.s) ishte bir i Zotit, ashtu siç shkruhej në brendi të Torës. Po kështu thoshin edhe kristianët, të cilët Zotin e zbërthenin në tre: Vetë Zoti si Ati, Isai (a.s.) biri i Zotit dhe Shpirti i Shenjtë, megjithëse mësimi Islam në thelb mësonte se Allahu nuk ka nevojë për bir apo për partner. Ai është larg këtyre kufizimeve. Është i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm. Kristianët e kanë predikuar kristianizmin tek Arabët për afro pesë shekuj. Përfundimi është se, megjithatë, numri i të konvertuarve ishte

pothuaj i papërfillshëm. Shumë pak njerëz pranuan besimin çifut, megjithëse rabinët çifutë bënë të pamundurën t'i kthenin arabët në bindjet e tyre. Këto përpjekje ishin të pafrytshme në përballimin e rrjedhës së idhujtarisë, mëkatit, imoralitetit, tiranisë dhe shturjes në Siujdhesën Arabike.

E tillë ishte shtrirja e zvetënimit, korrupsionit dhe mosbindjes së shoqërisë, të cilën Pejgamberi (s.a.v.s.) ishte dërguar ta reformojë dhe ta kthejë drejt rrugës së vërtetë dhe të drejtë Islame. Nuk është e vështirë të përfytyrohet habia, vështirësitë, rrezikshmëria dhe misioni pothuaj i pamundur që iu la në dorë njeriut, i cili ishte jetim, nuk kishte kryer ndonjë shkollë dhe nuk dinte shkrim e lexim, që nuk zotëronte pasuri materiale, që nuk kishte përkrahjen e ndonjë autoriteti të fuqishëm dhe që nuk ushtronte ndonjë ndikim të veçantë në popull. Ai ishte i armatosur vetëm me forcën e rrallë të karakterit të tij, të ndershmërisë së pashembullt, të drejtësisë dhe shkallës më të lartë të vërtetësisë. Çfarë mund të jetë mrekulli më tepër se fakti që me ndihmën e Allahut dhe udhëheqjen e Tij, pejgamberi Muhammed (s.a.v.s.) transformoi një shoqëri kaq shumë të larguar nga Zoti në një shoqëri që i nështrohet Atij me përunje, të devotshme, të drejtë dhe të guximshme, brenda një periudhe të shkurtër përreth dy dekada. Asnjë nga pejgamberët (a.s.) e mëparshëm nuk kish mundur të bënte

një mrekulli të tillë. Pejgamberi Nuhi (a.s.) kishte predikuar gjatë gjithë jetës së tij qindravjeçare, por kishte mundur të bashkonte rreth vetes vetëm një dorë pasuesish, punëtorë të thjeshtë dhe zejtarë. Ka pasur liderë madhështorë, reformatorë dhe heronj, por askush nuk ka mundur të arrijë një sukses kaq mahnitës, pavarësisht prej faktit se në shumë reforma ata kishin përdorur dhunën, masakrimet, djegiet, shkatërrimet dhe metoda të tjera shtrënguese. Ç'është e vërteta, disa prej këtyre të ashtuquajturve reformatorë kanë deklaruar hapur se masakrimi i njerëzve ishte i nevojshëm në këto lëvizje. Islami qëndron i prerë kundër vrasjeve të tilla, sepse Islami deklaron se nuk duhet të ketë absolutisht asnjë shtrëngim në ato çështje që kanë lidhje me fenë. Ky ishte edhe shkaku që nëse ndokush e përqafonte Islamin, ai duhej të deklaronte hapur se "*ai e pranonte Islamin me vullnetin e vet të lirë*". Kjo kishte bërë që Shteti Islam, i cili ishte duke u formuar gjatë jetës së Pejgamberit (s.a.v.s), të zgjerohej mesatarisht me afro 800 km² në ditë. Kur Pejgamberi (s.a.v.s) u nda nga kjo botë, një sipërfaqe që i tejkalonte 2.5 milionë km² kishte hyrë nën qeverisjen e tij. Gjatë procesit të islamizimit vdiqën pothuaj 150 burra nga ana e armikut. Numri i muslimanëve të martirizuar llogaritet rreth 120. Historia botërore nuk mund të paraqesë shembullin e një revolucioni të tillë.

Pavarësisht nga kjo, disa armiq të Islamit kanë bërë deklarata të pambështetura se Islami është përhapur me forcë, me mjete detyrimi dhe me përdorimin e shpatës. Nuk mund të ketë shpifje më të madhe se sa kjo thënie e hidhur.

Pejgamberi (s.a.v.s.) jo vetëm e pastroi shoqërinë prej të gjitha fatkeqsive dhe poshtërsive, por ai lidhi ngushtë një vëllazëri të qëndrueshme dhe krijoi një pasuri të patundshme dhe mirëqënie të vërtetë, në të cilën të gjithë ishin të barabartë. Disa njerëz shkurtpamës shpesh e mërznin Pejgamberin (s.a.v.s.) që ai t'u paraqiste mrekulli, në mënyrë që të mund të siguroheshin në pejgamberinë e tij dhe ai bëri mrekulli. Këtu nuk po propozohet të përmendet ndonjë prej tyre. Për një njeri të arsyeshëm dhe të paanshëm, nuk do të duhej mrekulli më e madhe se lartësimi i shoqërisë më të degraduar dhe i njerëzve të ngarkuar me mëkate, në kulmin më të lartë të fisnikërisë dhe madhësisë, sa që u bënë simbol i fisnikërisë dhe madhësisë për mbarë botën. Ka pasur perandorë dhe diktatorë të fuqishëm e agresivë, të cilët kanë pasur në dispozicion të tyre të gjitha pasuritë botërore, armë dhe ushtarë, për të imponuar dëshirat e tyre. Disa prej tyre trilluan besime të veta apo sisteme sociale dhe i urdhëruan njerëzit t'i pranonin ato. Pavarësisht prej forcës së tyre, reprezaljeve dhe mekanizmave shtrënguese, vetëm disa prej të nënshtruarve pranuan

kundër dëshirës së vet sistemet e tyre, por sapo vdiqën ata po aq shpejt vdiqën edhe teoritë e tyre.

Në ditët e sotme, atmosfera e zymtë nuk duket se ndryshon shumë nga ajo që ekzistonte në shekullin V dhe VI-të. Pavarësisht prej faktit se bota ka bërë një përparim të jashtëzakonshëm material, realisht ajo po shkon poshtë e më poshtë. Zhvillimi apo progresi ynë mund të krahasohet me krahët e një peshorje, njëra anë e së cilës përfaqëson zhvillimin shkencor është duke u ngritur lart dhe, nga ana tjetër, ajo përfaqëson virtytin, moralin dhe fisnikërinë, është duke zbritur poshtë. Është e vërtetë plotësisht se aparatet shkatërruese janë kaq të përsosura, saqë tërë universin mund ta zhdukim nga faqja e dheut për fare pak kohë. Po a ka ndjenjë sigurie, paqe, qetësie dhe besimi në këto që janë krijuar? Sa më shumë ne ecim përpara, aq më shumë probleme të rrezikshmërisë, pasigurisë, çmendurisë, shturjes, shkatërrimit, mosbesimit, degjenerimit, kriminalitetit, bastardimit, papunësisë e të tjera, do të na shihen në fytyrë. Sa më shumë të përparojnë shtetet, aq më shumë ato përballen me këto probleme. Për pasojë, paqja me vetveten, kënaqësia, durimi, ndjenja e garancisë dhe siguria janë duke i shkarë me të shpejtë njeriut dhe në vend të tyre, skizofrenia, neuroza, pakënaqësia melankolike, pikëllimi dhe intoleranca e kanë mbërthyer atë. Konsumimi i një sasive barërash

nuk mund ta ndihmojnë atë të ngushëllohet, pasi ai të digjet nga dëshirat. Ekziston një dhe vetëm një rrugë: lehtësimi prej këtyre fatkeqësive në këtë botë dhe shpëtimi për tjetrën, e kjo është rruga e Allahut. Kjo është siguruar plotësisht më parë me heqjen qafe të të gjitha këtyre fatkeqësive dhe shqetësimeve rreth 14 shekuj të shkuar dhe duhet të bëhet kështu edhe sot.

Në lidhje me këtë duhet të sqarojmë se Islami nuk është një besim i thjeshtë ose një doktrinë e ngurtë, që kryhet duke adhuruar ose duke thënë lutjet, ashtu sikurse e kuptojnë shumica e njerëzve. Ai është në të vërtetë "*Din*", që është rrugë e jetës, që mbulon secilin sektor të saj. Njerëzit që kanë pranuar besimet e tjera bëjnë një dallim të qartë midis fesë dhe sektorëve të jetës. Shumë shpesh ata pohojnë: "*Çfarë lidhje ka feja me politikën, biznesin dhe tregtinë?*". Por Islami i përfshin dhe ka lidhje me të gjitha fushat e ndryshme të jetës, qoftë ajo tregti apo industri, blerje apo shitje, peshim apo matje, politikë apo probleme sociale, drejtësi apo ndëshkim, kredit apo hua, bujqësi apo pronësim, rregulla të ngrënies dhe të pirjes, të higjienës personale dhe pastrimit; sjellje të përgjithshme apo mënyrë qeverisjeje, shprehi apo zakone, marrëdhënie fisnore dhe martesore, lindje apo vdekje. Islami parashikon udhëheqje të plotë dhe këshillon në shumë çështje, pavarësisht nëse janë ato të papërfillshme apo të rëndësishme,

duke i dhënë një shtrirje orientimit të njeriut sesi të ecë apo të bisedojë, si të ulet apo të flejë, si të hajë apo të ushqehet, si të sillet me më të vjetërit, veçanërisht me prindërit apo me më të rinjtë, sidomos me të vegjëlit; si të gostisë musafirët, si të sillet me udhëtarët, lypësit dhe nevojtarët. Për më tepër Islami nuk predikon thjesht një shqipit të lartë dhe moralshmëri të pazbatueshme, por ai është një "*din*" i natyrshëm. Lavdërohet njeriu i cili vetëpërmbahet, kur është në gjendje të hakmerret. Megjithatë, duke iu përmbajtur natyrës së qenies njerëzore, lejohet që ai të hakmerret kur i shkelen brutalisht të drejtat, por vetëm në atë shkallë në të cilën është dëmtuar apo i është bërë padrejtësi - syri për syrin, dhëmbi për dhëmbin e kështu me radhë, por i lartë do jetë shpërblimi me të cilin Allahu do ta shpërblejë atë njeri, që fal dhe harron. Kështu hapen dy udhë: një për ata që nuk mund ta kontrollojnë shpagimin dhe hakmarrjen e vet dhe, tjetra, për atë që është i durueshëm, i kënaqur dhe inspirohet me vlera më të larta dhe më fisnike, me ndjenja dhe arsye. Por ka edhe shumë të tjerë që me kënaqësi të ofrojnë faqen tjetër, nëse ia ke goditur njërën. Vetë Pejgamberi (s.a.v.s.) konkretizonte atë që ai predikonte dhe dha një shembull të pakrahasueshëm të sjelljes së tij fisnike në Taif, ku ai kishte shkuar të predikonte dhe ishte tallur prej dy prijësve, të cilët nuk u kënaqën me

poshtërsitë dhe sjelljen e tyre të përbuzëshme, por dërguan pas Pejgamberit (s.a.v.s.) disa horra dhe rrugaçë, të cilët e gjuajtën atë me gurë dhe copa shkëmbinjsh në një shkallë të tillë, sa që këpucët e tij u mbushën me gjak. (Një përshkrim i mbushur plot me sjellje të tilla të turpshme do të paraqitet edhe në vende të tjera të këtij libri). Por në vend që t'i drejtohej me lutje Allahut për të mallkuar të poshtërit e pashpirtë, ai e luti që t'i udhëzojë ata dhe t'u jepte atyre aftësinë që ata të mund të bënin dallimin midis të mirës dhe të keqes. Por vetëm pas një kohe të shkurtër më vonë, kur të njëjtët prijës shkuan te Pejgamberi (s.a.v.s.) për të bërë traktatin e paqes, ai i trajtoi ata me dashamirësi dhe nderime. Një provë e ngjashme e sjelljes së tij të bekuar shihet edhe në rastin e fitores së Mekës, ku Kurejshët atë dhe shokët e tij i kishin bërë objekt të fatkeqësive dhe torturave të pamëshirshme. Ai me shpirtmadhësi i fali të gjitha padrejtësitë e bëra dhe dha amnisti të përgjithshme për të gjithë. A mundet bota jonë, e ashtuquajtur e civilizuar dhe e moderuar, të paraqesë një shembull të vetëm, të një sjelljeje të tillë kaq të lartë. Veprimet dhe sjelljet e fuqive të mëdha e të vogla, gjatë luftës së fundit botërore, janë ende të freskëta në kujtesën e njerëzve dhe na bëjnë të varim kokën me turp. Madje edhe sot leksionet e drejtësisë, moralit, ndershmërisë dhe tolerancës që u mësohen vasalëve të

tyre dhe vendeve më të dobëta, prej fuqive më të mëdha, na bëjnë të përpëlitemi në dhembje dhe agoni. Nëse ata nuk heqin dorë nga politika e tanishme dritëshkurtër e shkatërrimit të ndërsjellë, nuk është e largët dita kur kjo tokë e mirë ka të ngjarë të shndërrohet në një kasaphanë dhe grumbull hiri.

Midis shumë kërkesave të domosdoshme thelbësore, për një jetë paqesore në këtë botë, drejtësia zë vendin më të rëndësishëm. Për këtë arsye Islami ka vendosur rregulla shumë strikte dhe të rrepta për respektimin e drejtësisë. Por bota, në tërësi, është duke shkuar në drejtim të paligjshmërisë apo ligjeve të xhunglës. Gjykatat hijerënda me kryelartësi predikojnë dhënien simbol të balancuar të drejtësisë pa kurrfarë trysnie apo favori. Por në të vërtetë procedurat e pandërprera juridike merren me kapjen e imtësirave fare të vogla dhe me interpretimin e një zhargonit të ngatërruar ligjor, në të cilën secila palë përpiket të anojë pikat e ngatërruara të ligjit në dobi të vetvetes. Kjo shkakton një varg të pafund argumentesh dhe kundërargumentesh, të cilat shpesh në vend që ta sqarojnë çështjen, e pëshpëllojnë atë në një grackë dyshimi dhe pasigurie, e cila lehtësisht e shndërron të pafajshmin në fajtor dhe shkelësin e ligjit në të pafajshëm. Po ashtu, në çështjet ndërkombëtare, drejtësia është shndërruar në një parodi. Shtetet e fuqishme,

nën faljen e ndihmës shteteve më të dobëta, në mënyrë flagrante e dhunojnë atë, pa u ndëshkuar, pa i vrarë ndërgjegja dhe pa e dëmtuar aspak shtetin e tyre; kështu ka një shkelje dhe përlligje të saj njëkohësisht. Por nëse ndonjë nga fuqitë e tjera të mëdha e përdor po të njëjtin "diktat të policit", pikërisht dhunuesi i mëparshëm e ngrë zërin në qiell kundër vëllait të vet grabitqar. Kështu, në kohën tonë, drejtësia ka fituar një domethënie të re. Ajo që është e drejtë për shtetet e mëdha, nuk është e drejtë për një shtet të vogël.

Lajkat e panumërta, kanosjet apo propaganda nuk kanë ndonjë vlerë, po të mos merret një veprim i përbashkët kundër dhunuesve të tillë. Përse duhet t'i drejtojmë armët kundër njëri-tjetrit për hir të të tjerëve? Islami është drejtësi complete dhe kuptimplote për gjithësecilin: të lartin apo të ultin, zotëriun apo skllavin, burrin apo gruan; të gjithë janë të barabartë sipas fesë Islame. Urdhëri Islam është që armiqësia apo urrejtja kundër ndonjërit nuk duhet ta shmangë njeriun nga rruga e drejtë dhe e ndershme.

Megjithëse në kundërshtim me frymën e drejtësisë dhe fesë, çifutët kishin sajuar zakonet e vrasjes së skllëveve të ndonjë pronari të madh dhe fisnik, nëse ky (pronari) gjendej fajtor për ndonjë vrasje. Pejgamberi (s.a.v.s.) në mënyrë emfatike i dënoi zakonet e këqija dhe ritheksoi se të gjithë, sido qofshin, të vegjël apo të mëdhenj,

janë të barabartë dhe kushdo që ishte fajtor duhej të ndëshkohej dhe askush tjetër nuk duhej të dënohej në vend të tij. Islami ndalon rreptësisht favorizimin e ndonjë nga të afërmve apo të dashurve si dhe dhënien e ndonjë dëshmie të rreme, madje edhe sikur ajo të jetë kundër tij. Kjo përfshin edhe ndalimin e përdorimit të fjalëve me dy kuptime apo shtrembërimin e fjalëve, të cilat mund të keqinterpretojnë një dëshmi të dyshimtë. Po ashtu Islami ofron udhëzime edhe në çështjet e tjera po kaq thelbësore.

Tipari më i rëndësishëm dhe më dallues i fesë islame është universaliteti i saj. Pejgamberët e mëparshëm ishin kryesisht për vende, krahina, qytete apo madje fshatra të veçanta. Po ashtu edhe mësimet e tyre ishin për periudha, fise apo gjenerata të caktuara. Megjithëse mësimet e tyre ishin në përgjithësi të njëjta, disa prej zakoneve dhe doktrinave fetare, kufizoheshin për popuj dhe për kohë të caktuar. Ndërkaq Islami erdhi të udhëheqë tërë njerëzimin për të gjitha kohërat që do të vinë. Nuk do të ketë asnjë pejgamber tjetër. Si rrjedhim, tani është detyrë e të gjithë muslimanëve, veçanërisht e prijësve fetarë islamë, t'ia transmetojnë mesazhin e Islamit të gjithë njerëzimit dhe të bëjnë gjithë atë që është e mundshme brenda mundësive njerëzore për përhapjen e mesazhit Islam, në mënyrë që askush të mos mund të justifikohet para Allahut se nuk e

ka marrë mesazhin, në Ditën e Gjykimit. Gjithashtu është detyrë e çdo femre apo mashkulli që të shohë për vetveten se çfarë është e gabuar. Siç është thënë edhe më parë, ekziston një dhe vetëm një rrugë që të çon drejt Allahut. Allahu, me faljen dhe mëshirën e tij të pakufishme, na dhuroi mençuri dhe aftësi të dallojmë midis të mirës dhe të keqes, mëkatit dhe virtytit. Allahu na e ka treguar rrugën dhe udhëheqjen e sigurt, por Ai nuk na ka shtrënguar që të ndjekim atë rrugë që Ai na e ka caktuar si të drejtë. Vetë njeriu duhet të zgjedhë se cilën nga dy rrugët do të ndjekë, rrugën e drejtë apo rrugën e gabuar. Nga vetë zgjedhja e tij, do të varet shpëtimi dhe ndëshkimi në botën tjetër. Të gjithë njerëzit, kushdo qofshin ata, çfarëdo shteti apo kombi t'i përka-sin, le ta marrin përsipër të mendojnë mbi këtë çështje tepër të rëndësishme, pa paragjykime, fanatizëm dhe mëdyshje, por me sinqeritet, me mendje të arsyeshme dhe të pastër. Në qoftë se ndo-një vepron me këtë frymë të shqyrtimit, Allahu vërtet do ta udhëheqë atë ta gjejë rrugën e drejtë.

Allahu sigurisht nuk na dërgoi në këtë botë që të ecim verbtazi. Ai dërgoi Pejgamberët e Tij (a.s.), që të garantojnë drejtimin që duhet të zgjedhim ne. Mësimet e Pejgamberit të fundit, Muhammedit (s.a.v.s.), sjellja dhe veprimet e tij janë fanar ndriçues për ne, për ta mbështetur moralin tonë dhe çështjet e përkohshme të kësaj

bote në baza të qëndrueshme. Shembulli dhe sjellja e tij e bekuar janë para nesh. Është obligimi ynë studimi i porosive të tij fisnike dhe rregullimi i jetës sonë në përputhje me to.

E tërë jeta e Pejgamberit (s.a.v.s.) i ngjan një libri të hapur përpara botës. S'ka fazë të jetës së tij, që nga lindja deri në vdekje, qoftë ajo private apo publike, që të jetë e fshehur prej kërkimeve të hollësishme të njerëzve. Çdo minutë e jetës së tij ka qenë e ruajtur me kaq imtësi, saktësi, përpikmëri, saqë asnjë kritik nuk mund të zbulojë ndokund ndonjë zbrazëti. Shënime voluminoze, dokumente dhe gojëdhëna të shumta janë shkruar dhe vazhdojnë të shkruhen, madje edhe rreth detajeve më të vogla të jetës së tij. Asnjëherë nuk është shkruar kaq shumë me respekt të ndonjë tjetri, sado madhështor apo i rëndësishëm mund të ketë qenë ai. Madje datat dhe orët e shumë ngjarjeve të jetës së tij njihen me saktësi. Xhon Davenport në librin e tij të titulluar "*Apollogjia e Mubamedit dhe Kur'anit*" e pohon këtë fakt dhe pranon se është një realitet i padiskutueshëm fakti se prej të gjithë personaliteteve të famshëm të botës, nuk mund të përmendet askush tjetër, jeta e të cilit të jetë e paraqitur me detajet më të plota dhe më autentike, se sa jeta e Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.).

Vetë Allahu siguroi jo vetëm ruajtjen e tekstit origjinal të Kur'anit të Shenjtë, madje të çdo

prike e presje të tij, por gjithashtu bëri që jeta e Pejgamberit të (s.a.v.s.) dhe fjalët e folura prej tij, të mbeten të pacënuara në analet e historisë. Arsyja është e thjeshtë për t'u kuptuar, dhe kjo është se Kur'ani i Shenjtë është libri i fundit i shpallur për të udhëhequr njerëzimin deri në Ditën e Gjykimit dhe Pejgamberi (s.a.v.s.) është i dërguari i fundit në këtë botë për t'u dhënë një demonstrim praktik mësimave të Kur'anit.

Me qëllim që mesazhi i Islamit të mund të shtrihej në të gjitha vendet, kombet, fiset dhe popujt, Pejgamberi (s.a.v.s.) shkoi në pjesë dhe vende të ndryshme të Arabisë si dhe në rajone kufitare për të predikuar Islamin. Ai u drejtoi letra mbretërve, sundimtarëve dhe guvernatorëve të vendeve fqinje, prijësve të një numri fisesh dhe klanesh, liderëve të shtresave të ndryshme të popullit, duke i ftuar ata të heqin dorë prej rrugës së shtrembër dhe të përqafojnë Islamin. Ai gjithashtu u dha një numër vendimesh dhe rregullash shtresave të ndryshme të shoqërisë dhe hyri në marrëveshje dhe traktate me Kurejshët, çifutët dhe fise të ndryshme. Megjithëse këto letra, traktate, vendime dhe dokumente përbëjnë një pjesë të rëndësishme të historisë së jetës dhe punës së Pejgamberit (s.a.v.s.), mësimave dhe ngjarjeve të tjera të jetës së tij, shumica e tyre fatkeqësisht mbetën të panjohura dhe u mbuluan për një kohë të gjatë. U bënë përpjekje për të

zbuluar dhe për të nxjerrë në dritë këtë thesar të paçmuar. Bota perëndimore nuk është familjarizuar ende me këto letra dhe dokumente.

Një studim pa paragjykime i letrave do të zbulonte një lloj të pashoq të revolucionit mendor, ideologjik dhe ideor, që ato shkaktuan; parimet e pakrahasueshme që u formuluan për të ngritur standardin moral dhe social të mbarë njerëzimit dhe rrugën e drejtë që është caktuar për civilizimin dhe kulturën. Ato gjithashtu tregojnë masën dhe kufijtë brenda të cilave do të mund të plotësoheshin dëshirat dhe kërkesat njerëzore. Ky edukim dhe përgatitje e madhërishtme dhe fisnike ishte paracaktuar për të transformuar vendet më injorante, më të prapambetura dhe më të pakulturuara të botës, në shoqëritë më të ditura, më të kulturuara, më të devotshme, më të virtytshme dhe më të njerëzishme.

Letrat dhe dokumentet e Pejgamberit (s.a.v.s.) janë të katër kategorive. Të parat janë traktate, marrëveshje dhe pakte të përfunduara me fise dhe klane të ndryshme, me çifutët dhe me Kurejshët. Të dytat janë letra drejtuar perandorëve, mbretërve, sundimtarëve dhe guvernatorëve. Të tretat janë letra dhe vendime drejtuar udhëheqësive të fiseve, kryetarëve dhe prijësve të klaneve. Të katërtat janë urdhëra, vendime dhe dokumente drejtuar udhëheqësve të fiseve, grupeve dhe individëve. Këto do të paraqiten në katër pjesë të ndara.

Në lidhje me këtë na duket me vend të shpjegojmë se traktatet, marrëveshjet dhe paktet siguronin jo vetëm mbrojtjen e muslimanëve prej trazirave dhe konflikteve, por ishin në interes të krijimit të një atmosfere të një paqeje dhe qetësie universale, në të cilën secilit i jepet liri e plotë të mendojë, të shprehet dhe të flasë në mënyrë të pavarur. Kjo tregon qartë se qëllimi kryesor i Pejgamberit (s.a.v.s.) ishte krijimi i paqes dhe qetësisë. Pa dyshim ai i dha botës një leksion të shkëlqyer, fisnik, madhështor dhe të frymëzuar. Traktatet dhe paktet janë në fakt shprehje e paqes, lirisë, barazisë dhe drejtësisë. Nëpërmjet tyre, Pejgamberi (s.a.v.s.) u dha qytetarëve jomuslimanë të drejtat e tyre themelore. Këto ishin në realitet statusi dhe baza e shumë parimeve politike elementare të shëndosha, prej të cilave u formuluan më vonë ligjet dhe rregullat për jomuslimanët. Një tjetër aspekt i rëndësishëm, që buron prej këtyre traktateve, është se ato japin një ide të mirë ose një vlerësim të udhëheqjes së respektuar, të sjelljes, të zakoneve dhe mendimeve të Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe mënyrës islame të adhurimit, parimeve, problemeve kushtetuese dhe juridike, civilizimit të ri islam, themelimi i të cilit kishte filluar të përhapej në atë kohë. Këto tregojnë qartë se vëllazërimi internacional dhe botëror, miqësia dhe bashkimi ekzistojnë me të vërtetë.

Siç është thënë edhe më herët, Pejgamberi (s.a.v.s.) ishte njeriu i parë që i dha botës një *kushtetutë* të shkruar, në formën e Kartës së Medinës. Kemi përmendur që Pejgamberi (s.a.v.s.) migroi për Medine, që në atë kohë quhej *Jethrib*, në vitin e 13-të të pejgamberisë së tij, kur Kurejshët e bënë qëndrimin e tij dhe të shokëve të tij, pothuaj të padurueshëm. Pas kësaj Medina filloi të quhej *Medinet'un-Nebi* - (Qyteti i Pejgamberit), dhe ai mori formën e një qyteti-shtet. Qyteti u shpall Harem (Qielli i sigurisë), ku vrasja dhe plaçkitja ishin absolutisht të ndaluara, ashtu si edhe Haremi i Ka'bes.

Në atë kohë, përveç dy fiseve të *ensarëve* të njohur si Ews dhe Hazrexh, jetonin edhe një numër fisesh çifute. Në afërsi të qytetit jetonin tre fise çifutësh të njohur, si Benu Kainuka, Benu Nadir dhe Benu Kureidha. Ata atje kishin ndërtuar kështjella dhe fortifikime. Benu Kureidha gjithmonë mbanin anën e fisit Ews në luftë, dhe Benu Nadir ndihmonin fisin Hazrexh. Të dy fiset e Ensarëve gjithmonë qëndronin në luftë me njëri-tjetrin. Çifutët që ishin mësuar t'u shisnin armë të dy fiseve, dëshironin që Ensarët të mbeleshin gjithmonë të përçarë dhe të dobët. Pas migrimit, një numër i madh i njerëzve midis Ensarëve të Medinës, pranuan Islamin. Pejgamberi (s.a.v.s.) i bashkoi ata. Është e qartë që çifutët nuk e dëshironin këtë. Përveç kësaj, Kurejshët e

Mekës, me të cilët çifutët kishin marrëdhënie të mira, i nxitën ata më vonë që të fyenin muslimanët dhe përveç kësaj u thanë atyre që të përgatiteshin për ta pushtuar Medinën. Si rrjedhim, muslimanët u ndien tepër të pasigurt, prandaj problemi i parë me të cilin u angazhua Profeti i shenjtë ishte rregullimi i marrëdhënieve midis muslimanëve dhe çifutëve. Për këtë qëllim ai hyri në traktat me Ensarët dhe çifutët dhe në këtë mënyrë u krijua Traktati i Medinës.

Në ditët e sotme, vende dhe kombe të ndryshme kanë barrikaduar përpara vetes pengesa të pakapërcyeshme të urrejtjes, fanatizmit, krenarisë false dhe armiqësisë, që burojnë nga prirja e një nacionalizmi të ngushtë. Kjo është, në fakt, rrënja e shumë fatkeqësive që në ditët e sotme janë duke e kthyer botën në një ferr të vërtetë. E ndjera *Lidhja e Kombeve*, tani *Organizata e Kombeve të Bashkuara*, përkundër trumbetimit të një publiciteti, propagande dhe shpezimeve kolosale, ka qenë absolutisht e pazonja në bashkimin e kombeve të ndryshme. Prandaj, bota ka shumë për të mësuar prej Islamit, që nënkupton paqe dhe qetësi. Islami absolutisht hedh poshtë mediokritetin, arrogancën, krenarinë artificiale, koprracinë, padrejtësinë, tiraninë, nënshtrimin dhe mbivlerësimin e vetes. I respektuar dhe i nderuar para Allahut është ai që më së shumti i frikësohet Allahut. Dhe frikë ndaj Allahut do të thotë nënshtrim

i plotë ndaj Vullnetit të Allahut, që ende do të thotë krijim i paqes, drejtësisë, vëllazërimit, dënjitetit njerëzor, miqësisë, barazisë, dashurisë për të gjithë, pa urreyer askënd. Letrat janë shkruar me këtë frymë. Si rezultat ato kanë frymën e mirëdashjes, dhembshurisë dhe vullnetit të mirë për letërmarrësin. Qëllimi ishte shpëtimi i njerëzimit prej rrezikut dhe shkatërrimit në këtë botë dhe në botën tjetër. Është momenti që njerëzit ta pranojnë fjalën e Allahut dhe ta shpëtojnë vetveten, ose të pranojnë shkatërrimin e vetvetes.

Letrat janë shkruar me një gjuhë tepër të thjeshtë, faktike, realiste, efektive dhe janë krejtësisht pa retorikë, fjalë të shumta dhe teprime. Megjithatë, ato janë mbresëlënëse, bindëse dhe një komunikim i ngrohtë zemrash. Marrësi ftohet të heqë dorë nga ajo që është e gabuar dhe të pranojë atë që është e drejtë - rrugën Islame. Letrat tregojnë qartë drejtësinë, ndershmërinë, qëndrueshmërinë dhe bindshmërinë e thellë dhe lënë përshtypje thellësisht në zemër e në shpirt. Njëkohësisht ato janë thelbësore, të përmbledhura dhe të qarta. Një veti e mrekullueshme e letrave është që edhe pse kanë kaluar mbi 14 shekuj, ato ende e ruajnë freskinë, shkëlqimin dhe bukurinë, pa të cilat nuk do të mund të bënin për vete drejtpërsëdrejti mendjen njerëzore. Fjalitë janë të shkurtra, por energjike. Të duket se një galaktikë yjesh vezullues janë derdhur në

to. Pak kryevepra të letërsisë mund të krahasohen për nga bukuria, thjeshtësia dhe shkurtësia e këtyre Letrave. Ato (veprat letrare) janë mendime të mërzitshme. Karakteristikat më dalluese të të shkruarit të Letrave janë:

a) Letrat fillojnë në mënyrë konstante me: "*Bismi'l-labi'r-Rrahmani'r-Rrahim*", (Në emër të Zotit, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit")

b) Mbas kësaj, letrat tregojnë që janë nga: "*Muhammedi (s.a.v.s.), I Dërguari i Allahut.*"

c) Mbas kësaj, *emri ose pozita e letërmarrësit* dhe më pas vazhdon *mbiemri* i tyre.

d) Letrat hapen ose me një fjali, në të cilën *madhërohet Allahu*, ose me një lutje për *mëshirën e Tij*.

e) Pastaj vazhdon shkurtimisht *përmbajtja e temës*, në të cilën vihet në dukje fuqia dhe përpunimi i lartë i fjalive.

f) Në fund duket *vula*, në të cilën *emri i Allahut* është në krye, poshtë Tij është emri *Resul* dhe më poshtë vjen *emri i Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.)*.

Prej letrave të cilat Pejgamberi (s.a.v.s.) ua shkroi sundimtarëve të shteteve fqinje, pesë kanë mbërritur deri në ditët e sotme në origjinal. Këto Letra i ishin adresuar mbretit të Etiopisë, Sundimtarit të Egjiptit, Perandorit të Iranit dhe Guvernatorit të Bahrejnit. Fotografitë e tyre janë riprodhuar në vendet respektive. Perandori i mëvonshëm Haile Salasi u njoftua se duhej t'ia

tregonte një delegacioni muslimanësh letrën drejtuar mbretit të Etiopisë, pasi që ai e kishte nxjerrë atë prej thesarit të tij¹. Letra është e shkruar në një pergamen 13 inç e gjatë dhe 9 inç e gjerë. Në të gjenden 13 radhë, të shkruara me ngjyrë të kaftë. Por *Bismi'l-lah* dhe *vula* nuk shihen plotësisht qartë. Këtu duhet përmendur që teksti i gjashtë letrave që janë gjetur deri tani, është i njëjtë me atë që është dhënë në përmbledhejt e Haditheve. Edhe nëse ekziston ndonjë ndryshim i parëndësishëm i ndonjë fjale, kuptimi mbetet i pandryshuar.

Nuk na duket e tepërt të themi se transmetimi është dy llojesh dhe konkretisht: fjalë për fjalë, domethënë transmetimi në të cilën fjalët janë krejtësisht të njëjta me ato që janë folur nga Pejgamberi (s.a.v.s.); dhe lloji tjetër është ai në të cilin transmetuesi tregon kuptimin e përpiktë, me vetë fjalët e tij. Konfirmimi dhe identifikimi i teksteve të Letrave i siguruar nga burime të ndryshme, me tekstin e gjetur në "hadithet", provojnë që letrat na kanë mbërritur neve, në përputhje me tekstet origjinale. Përpikmëria e teksteve bart gjithashtu dëshminë bindëse që të rrëfyerit e Haditheve ishte bërë nga njerëz me kujtesë të jashtëzakonshme. Kjo vërtetohet prej

¹ Jeta politike e Pejgamberit (s.a.v.s.) është përpiluar nga Dr. Muhammed Hamidullah. fq.169 - 182.

tekstit të letrave dhe thënieve të cilat janë të njëjta fjalë për fjalë, siç janë përdorur në librat e Haditheve dhe në biografite e Pejgamberit (s.a.v.s.) gjatë fundit të shekullit të katërmëdhjetë. Edhe nëse ka ndonjë ndryshim të parëndësishëm të fjalëve, kuptimet janë të njëjta. Përveç kësaj, ato vërtetojnë aftësinë e pagabuar të transmetimit të Haditheve, për të sjellë ndërmend dhe rikujtuar fjalët e Pejgamberit (s.a.v.s.), si edhe vazhdojnë të dëshmojnë gjithashtu vigjilencën dhe syçeltësinë e jashtëzakonshme në transmetimin e Haditheve. Madje Hadithet ruheshin shumë gjatë në kujtesën e tyre.

Ekziston edhe një faktor tjetër i rëndësishëm që garanton vërtetësinë dhe komunikimin absolutisht të saktë të haditheve brezave pasardhës. Muslimanët shtjelluan dhe zhvilluan një metodë të lartë shkencore dhe racionale të *Esma 'ur-Rixhal* (Biografi). Parimi i parë i metodës quhet "Rivajat", sipas së cilës çdo gjë që konsiderohet si "e dhënë" duhet të deklarohet prej personit i cili e ka parë apo ka marrë pjesë vetë në të. Në rast se ai nuk ka qenë vetë dëshmitar, ai duhet të lidhë rend pas rendi emrat e të gjithë transmetuesve, deri tek ai që ka marrë pjesë vetë në ngjarje. Mbas kësaj duhej të shqyrohej se çfarë lloj njerëzish janë transmetuesit? Cili është zanati apo mjeshtëria e tij? Çfarë karakteri dhe sjellje kanë ata? Sa e fortë është kujtesa e tyre? Në çfarë niveli

është zgjuarsia dhe fuqia e tyre e të arsyetuarit - është e thellë apo e përciptë? A është i devotshëm, a i frikësohet Zotit dhe a është i besueshëm? (*Sirat'un-Nebi* nga Shibli Nu'mani, vol. I, faqe 37). A ishin ata të shkolluar apo analfabetë? A njiheshin ata për sinqeritetin e tyre apo kishin gënjyer ndonjëherë? Nuk na duket e tepërt të themi në lidhje me këtë se biografia e Pejgamberit (s.a.v.s.) filloi të dokumentohet përafërsisht njëqind vjet pas pejgamberisë së tij. Prandaj hartuesit e biografisë së tij nuk kanë pasur material të regjistruar të mirëfilltë, por atyre u erdhi në ndihmë vetëm transmetimi gojor. Në rrethana të tilla ndonjë autor tjetër zakonisht do të jepej pas ndonjë materiali që ai do të ishte i aftë për ta përmbledhur, shumica e të cilit do të ishin fjalë andej-këndej, ose përgojime, pa e çuar deri në fund hallkën e transmetimeve prej nga kanë dalë ato. Më vonë një dokumentim i tillë mori formën e historisë. Mjaft nga shkruesit e historisë së Evropës dëshironin ta adaptonin këtë linjë. Megjithatë, muslimanët vepronin me një maturi të madhe dhe i mënjanuan të gjitha materialet e pabesueshme. Ata vendosën bazat e biografisë së vërtetë, e cila mbetet ende e pakrahasueshme. Siç bëmë të ditur më lart, parimi i parë të cilit ata iu përmbajtën fuqimisht ishte *Rivajat*. Në rast se ata gjenin ndonjë transmetim të pabesueshëm, ata nuk e pranonin materialin e transmetuar.

Për të garantuar besueshmërinë e plotë, biografisë e transmetuesve ishin përgatitur imtësisht nga burime shumë autentike, të besueshme dhe të qëndrueshme. Falë kësaj teknike, përmbledhja e shkurtër e jetës së qindra e mijëra transmetuesve është e njohur prej nesh. Sipas doktorit të njohur gjerman Springer, vlerësohen 500.000 (pesëqindmijë) shkrime të dokumentuara. Doktor i njohur zemërhapur pohoi se nuk ka ekzistuar ndonjë popull tjetër që të ketë zbuluar një teknikë të tillë, që na bën të mundur të njohim të dhënat historike prej një numri kaq të madh njerëzish. Këto dëshmi nuk janë një koleksion i thjeshtë i të dhënave të pabazuara, por përfundim i një shqyrtimi rrënjësor. Karakteri i çdo transmetuesi është studiuar në mënyrë të hollësishme, pa kurfarrë ndrojtje apo favorizimi². Parimi i dytë, të cilit gjithashtu iu përmbajtën fuqishëm gjatë transmetimeve, është i njohur me emrin *Dirajat*, që do të thotë se çdo gjë që është treguar apo rrëfyer ishte në pajtim me arsyen, ose me fjalë të tjera, në qoftë se ato ishin plotësisht racionale. Nëse ngjarja ose çështja konsiderohej se ishte në kundërshtim me gjykimin e shëndoshë, arsyen, përvojën, dhe nuk ishte në pajtim me atë që të dikton mendja dhe përvoja e

² Parimi i dytë, të cilit gjithashtu iu përmbajtën fuqishëm *Siret'un-Nebi*, vol.I, f.37.

pranuar, ajo është hedhur poshtë plotësisht. Ky parim gjithashtu ishte shpallur në Kur'anin e Shenjtë: "O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, në mënyrë që të mos e dëmtoni një popull pa e ditur të vërtetën, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë". Kjo ishte edhe baza e përpilimit të Haditheve. Sado të ketë pasur pozitë të lartë transmetuesi, fjalët e tij i janë nënshtruar një shqyrtimi të rreptë dhe të përpiktë.

Në letrat që gjenden në këtë libër ka përdorime të shpeshta të fjalëve: *Iman, Salat, Sawm, Zekat, Ushr, Hums, Haxh, Tewhid, Dijat, Fidja, Umre, Xhizje, Haram, Sadaka dhe Hajrat*. Na duket e nevojshme të shpjegojmë kuptimet dhe nënkuptimet e këtyre termave shkurtimisht.

Iman: Përsa u përket pesë termave të parë, mund të vemë në dukje se ato përbëjnë kushtet themelore të Islamit. I pari dhe më kryesori i këtyre kushteve është Imani, që do të thotë besim i fortë dhe i palëkundur tek 1) *Allabu*, 2) *Engjëjt e Tij*, 3) *të Dërguarit e Tij*, 4) *Librat e Tij dhe* 5) *tek Dita e Gjykimit* - ditë në të cilën për veprimet e virtytshme dhe të drejta do të shpërblehemi shumë më tepër, dhe për mëkatet dhe gabimet do të ndëshkohemi siç duhet. Është e domosdoshme tërësisht që të besosh të gjitha këto me zemër të shëndoshë dhe t'i pohosh ato gojarisht, pasi asnjë veprim i drejtë nuk mund të kryhet pa këto besime.

Besimi në Allah do të thotë që Allahu është Një dhe Ai është i Vetmi Krijues dhe Pronar i kësaj bote. Ai është në dijeni të gjithçkaje që ne bëjmë, qoftë ajo e hapur apo e fshehtë. Prandaj ne, jo vetëm haptazi por edhe fshehtazi, duhet të bëjmë atë çfarë është e drejtë. Kjo është e mundur në qoftë se besimi është i patundshëm dhe i shëndoshë dhe shërben si bazë e fortë e gjithë asaj që është e mirë dhe e virtytshme.

Besimi tek pejgamberët (a.s.) është gjithashtu i domosdoshëm, se parimet dhe urdhërat e Allahut janë pranuar nëpërmjet tyre. Përveç kësaj, ata janë simbol i dirlësisë dhe devotshmërisë dhe veprimet e tyre të drejta dhe sjellja e tyre e virtytshme ofrojnë për ne sot një shembull të mrekullueshëm dhe fisnik.

Përsa u përket *Librave apo shkrimeve të Shenjta*, ato kanë për qëllim të na bëjnë të ditura me shkrim urdhërat dhe parimet e Allahut. Kjo e bën të domosdoshëm besimin në Librat e Shenjta. Në mungesë të kësaj, nuk ka asnjë kuptim tjetër njohja e Pejgamberëve dhe urdhërave të Allahut.

Përbërësja e fundit e kushteve të Imanit është *të besuarit në Ditën e Gjykimit*. Bota tjetër është kurorëzim i pashmangshëm i kësaj bote, e cila e vetme do të kishte qenë pa ndonjë qëllim kuptimplotë. Nëse nuk do të kishte shpërblim apo ndëshkim për veprimet e kësaj bote, nuk do të kishte ndonjë nxitës për punë të mirë apo sjellje

të drejtë. Natyra njerëzore është e tillë që nëse njeriu bën diçka të virtytshme, ai shpreson se do të kompesohet për të. Po ashtu nëse ai kryen ndonjë mëkat, ai dhe ndërgjegja e tij i frikësohen dënimit si kundërpërgjigje. Kjo frikë apo vetëdije e bën atë të kryejë obligimet e tij, të bëjë atë që është e drejtë dhe të largohet prej mëkateve. Kështu, mund të konkludojmë se pa një besim në Ditën e Gjykimit nuk është e mundshme të përparojë puna për reformimin dhe përmirësimin e një shoqërie të shëndoshë. Prandaj Islami i kushton një vëmendje të veçantë këtij aspekti të besimit.

Salat: Salati (namazi) apo të falurit në Islam dallohet nga adhurimi në fetë e tjera dhe është i veçantë në llojin e vet. Në *salat (namaz)* lavdërohet i Gjithëfuqishmi dhe kërkohet ndihma, drejtimi dhe mirësia e Tij. Namazi është gjithashtu një shprehje e përruljes dhe bindjes së plotë ndaj Allahut. Muslimani qëndron përpara Krijuesit të tij me përrulësi; përkulet përpara Tij në shenjë nderimi të plotë ndaj Allahut. Falja këshillohet të kryhet bashkarisht, pesë herë në ditë, regullisht në kohën e caktuar - përpara lindjes së diellit, pas drekës, përpara perëndimit, pas perëndimit dhe në fillim të natës.

Namazi jo vetëm i rikujton vazhdimisht mendjes së njeriut idenë se ai është rob i Allahut, por gjithashtu bën që jeta e tij të vendoset mbi një vetëprogramim të kontrolluar, e mban

atë të dliërë dhe të pastër, formon tek ai sensin e përgjegjësisë ndaj vetvetes, si dhe e forcon moralin e tij.

Saum: Saumi (agjërimi) nuk është karakteristike vetëm për Islamin, por gjithashtu ai është pjesë thelbësore edhe e religjioneve të tjera. Muaji i nëntë i kalendarit islamik, Ramazani, është muaji i agjëritimit. Zgjatja e agjëritimit është që para agimit deri në perëndim të diellit. Gjatë agjëritimit njeriu duhet të respektojë plotësisht abstënimin prej ngrënies, pirjes, marrëdhëniesve intime, si dhe prej të gjitha veprave të këqija dhe të dëmshme. Madje edhe grindjet më të vogla si dhe shfaqja e zemërimit, zënkave dhe inatit të pahijshëm, ndalohen gjatë muajit të Ramazanit. Praktiki fillon ditën e parë të Ramazanit dhe përfundon ditën e fundit të muajit. Agjërimi krijon tek ai sensin e përpiktë të disiplinës, durimit, përmbajtjes dhe pastërtisë. Për më tepër, duke krijuar tek ai ndjenjën e bindjes ndaj Allahut, bëhet e mundur që ai të kuptojë se Allahu sheh çdo veprim të tij dhe kjo është ajo që e mban atë larg shkeljeve të ndalesave të shenjta (haramit), edhe kur ai është vetëm dhe askush s'është duke e parë atë.

Zekat: zekati ose pagesa e detyruar për të varfërit është një përbërëse shumë e rëndësishme në Islam. Pas *Iman*-it ajo i bashkangjitet *Salatit* për nga rëndësia. Në Kur'anin e Shenjtë zekati përmendet së bashku me salatin. Dallimi është

që ndërsa salati është përbërësi më i rëndësishëm i *Të drejtave të Allahut*, zekati përbën pjesën më thelbësore të *Të drejtave të njeriut*. Kuptimi fjalë për fjalë i zekatit është pastërti dhe lartësim, sepse ai e pastron apo dliëson zemrën dhe mendjen e atij që e paguan atë, si edhe zhvillon virtyte të larta tek ai. Qëllimi kryesor i zekatit është të ndihmojë nevojtarët, të varfërit dhe t'u sigurojë atyre kërkesat më të domosdoshme për jetë. Në këtë mënyrë zekati është pjesa e të varfërve në pasurinë e të pasurve. Megjithatë, është e obligueshme që dhënësi i zekatit nuk duhet ta japë atë me qëllim për t'u dukur dhe as që dhënësi i zekatit nuk duhet ta bëjë marrësin e zekatit të ndihet më vonë si borxhli ndaj tij. Pëqindja në një vit për pasurinë e akumuluar, stolitë dhe tregtinë e mallrave është 2,5%. Për vendet e vaditura *hums* (pesë për qind) dhe për vendet jo të vaditura *'ushr* (dhjetë për qind) e prodhimit paguhet si zekat.

Zekati mund t'u paguhet fatkeqve apo nevojtarëve, të varfërve, mbledhësve të zekatit, udhëtarëve që s'kanë të holla, borxhlinjve, personave apo institucioneve që përhapin Islamin, për t'u bërë mirë njerëzve të zakonshëm, për të shpëtuar ndokënd nga robëria dhe skllavëria, si edhe u paguhet njerëzve për të nxitur ata që të pranojnë Islamin dhe për të ndalur kundërshimin ndaj tij.

Institucioni i zekatit thekson faktin se e gjithë ajo që fiton njeriu nuk është thjesht rezultat i punës apo i talentit të tij, por është një dhuratë e Allahut, i Cili përmes një numri rrugësh dhe mjetesh e ndihmon njeriun të fitojë atë që është paracaktuar për të. Kjo të çon në konkluzionin se pasuria e fituar duhet shpërndarë me të tjerët. Qëllimi i vërtetë që qëndron mbrapa kësaj është që pasuria nuk duhet të grumbullohet në duar të një pakice, por duhet të shpërndahet për të gjithë. Shteti islamik i mbarëvajtjes në Medine e organizoi punën për mbledhjen dhe shpërndarjen e zekatit, në mënyrë kaq të përsosur dhe efikase, sa që pas pak kohe paguesit e zekatit gjendeshin në të gjitha anët, por ishte e vështirë të gjeje marrësit e tij. A mundet ndonjë sistem socialist apo komunist të përballet me një shembull të tillë?

Haxh: fjalë për fjalë do të thotë të vizituarit e Qabes me qëllim të caktuar. Islami i ka bërë të obligueshëm për çdo moshëritur që ta kryejë haxhin të paktën një herë gjatë jetës së tij. Ndonjëri, i cili përkundër faktit se posedon pasurinë e nevojshme për kryerjen e haxhit, por nuk e kryen atë, e vë në dyshim faktin se është musliman. Kur Ibrahimimi dhe Ismaili (a.s.) e ndërjuan Kaben me duart e tyre, ata iu lutën Allahut që të shumonte prej pasardhësve të tyre një grup që do të ishin të bindur ndaj Allahut. Kjo do të thotë që puna që u fillua prej tyre do të përfundohej nga

disa pasardhës të tyre. Pejgamberi a.s., i cili ishte pasardhës i Ismailit, e përfundoi këtë punë.

Haxhiu (pelegrini) duhet ta mbështjellë vetveten me ihram (çarçaf të paqepur), prej pëlhu-re, që preferohet të jetë i bardhë. Kështu ai e paraqet vetveten tek Allahu me një rrobë të pastër, pa ndonjë zbukurim apo dukje dhe si një rob të bindur ndaj Tij. Në ditën e nëntë të muajit Dhu'l-hixhe, miliona haxhinj mblidhen me këtë veshje në Arafat. Ky është një demonstrim i pashoq i vëllazërimit islam. Njerëz të nacionaliteteve të ndryshme i heqin veshjet e tyre kombëtare, veshin veshje të njëjtë dhe në gojët e tyre dëgjo-hen fjalët: "*Lebbejke All-llabumme lebbejke*" (Të përgjigjem, o Zot, të përgjigjem), të cilat ata i përsëri-sin pandërprerë, në një gjendje përkushtimi dhe vetëmohimi të vetvetes. Kjo në të vërtetë është dëshmi e faktit se të gjithë muslimanët i përkasin një kombi të vetëm e të pathyeshëm, kombësisë së Islamit. Kjo është pasojë e frymës universale, për të cilën ka më së shumti nevojë bota sot - nevojën për mbrojtjen e një vëllazërimit, të çliru-ar nga të gjitha dallimet racore, të ngjyrës, gjuhës dhe prej prirjes së një nacionalizmi të ngushtë. Islami siguron përgjigje për këtë nevojë urgjente.

Tewhidi (Njëshmëria e Allahut). Siç është thënë më lart, e tërë struktura e Islamit, sistemi i tij i besimit dhe Imani, bazohet në besimin e fortë në Njëshmërinë e Allahut. Tewhid do të thotë se

askush tjetër, përveç Allahut, s' është i denjë për adhurim dhe se Ai është Burimi apo Krijuesi i gjithë asaj që gjendet në univers. Ky nuk është një besim i thjeshtë, por aspekti më thelbësor i jetës dhe ka një ndikim me shtrirje të gjerë mbi të gjithë jetën njerëzore. Sa më tepër që njeriu beson në shumë zotëra apo fuqi mbinatyrore, aq më shumë ai do të ndihej si të ishte i rrethuar nga të gjitha anët nga forca të errëta, i nënshtruar, i pikëlluar dhe fatkeq. Ai u frikësohet atyre dhe përpiqet që t'i kënaqë ata duke u përkulur para tyre. Ndërsa ai që zotëron një besim të fortë në Një Krijues të Vetëm, ai është i çliruar prej kësaj frike dhe tek ai zhvillohet ndjenja e vetë-respektit. Ai fillon të kuptojë se e gjithë forca është në dorë të Allahut dhe të askujt tjetër. Për më tepër zhvillon tek ai ndjenjën e respektit dhe të përruljes ndaj Krijuesit dhe largon prej tij dëshpërimin, trishtimin dhe pesimizmin. Në Islam humbja e të gjitha shpresave është shenjë e mosbesimit tek Allahu. Një besimtar i vërtetë është gjithmonë i durueshëm, këmbëngulës, i qëndrueshëm dhe i vendosur, larg çdo servilizmi, hipokrizie, ryshfeti, koprracie, lakmie apo intrige.

Dija: Shpagim me para. Nëse ndonjëri kryen një vrasje, si ndëshkim atij i caktohet dënimi me vdekje. Por nëse farefisi i afërm e fal vrasësin dhe merren vesh të pranojnë shpërblimin ose pagimin e gjakut, atëherë vrasësi detyrohet të paguajë

shumën e caktuar të parave që quhet *Dija*. Dijati gjithashtu duhet të paguhet edhe për ndonjë gjymtyrë të humbur ose që rrjedh vazhdimisht. Për gjymtyrë të ndryshme paguhet shpërblim i ndryshëm.

Fidja. Fidja është pagesa për të liruar një skllav ose të burgosur, si edhe shpërblimi për ndonjë dëm të bërë etj.

Umra: Umra, ashtu si edhe haxhi, është të vizituarit e Kabes, por ka një ndryshim të vogël prej haxhit. Në umre nuk qëndrohet në Mine apo Arafat dhe nuk ofrohet ndonjë (kurban) flijim. Përveç kësaj, ndërsa haxhi kryhet në kohë të caktuar, për umren nuk ekziston kohë e caktuar, por ajo mund të kryhet në çdo kohë. Haxhi është i obligueshëm, ndërsa Umra jo.

Xhizja: Xhizja është taksë mbrojtjeje, të cilën qytetarët jomuslimanë të një shteti musliman duhet ta paguajnë për t'u shkarkuar nga shërbimet mbrojtëse në një shtet islamik, për të mbuluar shpenzimet e mbrojtjes së jetës dhe pasurisë së tyre, si edhe për ruajtjen e paqes dhe qetësisë. Në Iran kjo taksë, që quhej "xhizje", ishte mbledhur që në kohët e lashta.

Kundërshtarët e Islamit, të cilët nuk shpërfillojnë edhe gjërat më të parëndësishme për të shpifur ndaj Islamit, pa shkak e arsye, kanë bërë përpjekje të mëdha për të keqinterpretuar kapitalin e *xhizjes*. Megjithëse nuk është e nevojshme të

bëhet ndonjë justifikim për të, disa prej shkrimtarëve muslimanë, veçanërisht historianët, janë përpjekur të shfajësohen në mbrojtje të kësaj takse shumë të arsyeshme. Sidoqoftë, kjo çështje kërkon një sqarim për ata që janë të paanshëm dhe që dëshirojnë të dinë faktet e vërteta dhe të komplikuarat të çështjes.

Jomuslimanët zakonisht tërheqin vërejtjen se përse detyroheshin vetëm jomuslimanët të paguanin taksën. Është e qartë se vërejtja bëhet me qëllim plotësisht të paramenduar për t'i pozicionuar njerëzit kundër Islamit.

Kush do të mund ta mohonte faktin se detyra e parë dhe më kryesore e çdo qeverie është të mbrojë jetën dhe pronën e të gjithë qytetarëve, si edhe sigurimin e paqes. Për sigurimin e kësaj mbrojtjeje, pagesa është e nevojshme dhe ajo duhet të burojë prej vetë njerëzve. Në të gjitha vendet me zhvillim dhe përparim të lartë të botës, populli bart barrën e taksave të rënda, të shpenzimeve të përditshme të administratës shtetërore.

Islami ngarkon një numër të caktuar taksash si edhe *zekatin*, të cilat një musliman duhet t'i paguajë. Zekati për çdo vit është 2.5 % e pasurisë së grumbulluar, e zbukurimeve dhe e tregtisë së ndershme, ashtu si u tha edhe më herët, dhe është i obligueshëm për t'u paguar. Asnjë nuk mund të heqë dorë prej pagesës së zekatit dhe nuk mund ta zvogëlojë sasinë e tij në çfarëdo

rrethanash. Përveç kësaj, muslimani duhet të japë sadaka dhe hajrat (mirësi). Njëherë iu drejtua një pyetje Pejgamberit (s.a.v.s.) sesa ishte shuma që duhej të jepej për sadakë dhe Allahu, nëpërmjet Pejgamberit, shpalli se njerëzit duhet të japin çdo gjë që është mbi nevojat e tyre. Muslimani i pasur duhet të paguajë sadakai - fitrin me rastin e mbarimit të Ramazanit, në emër të të gjithë fëmijëve dhe të gruas së vet. Në id'ul-ad'ha ai duhet të ofrojë kurbanin e një bagëtie dhe mishin e tij duhet t'ua shpërndajë njerëzve të vobektë, por më së miri farefisit të tij. Në këtë mënyrë muslimanit i duhet të paguajë një shumë të konsiderueshme parash nëpërmejt zekatit dhe sadakasë. Ndërsa një jomuslimani i duhet të paguajë vetëm një shumë të papërfillshme nëpërmjet xhizjes. Vlera më e madhe të cilën një pasanik jomusliman duhet ta paguajë arrin afërsisht 48 dirhemë për çdo vit (Kitab 'ul-haraxh, nga Kadi Ebu Jusufi dhe kapitulli i xhizjes, Durr'ul-muhtar). Por kjo shumë duhet të paguhet prej atij personi i cili ka të paktën dhjetë mijë dirhemë në zotërimin e tij, pra është më pak se gjysmë përqind. Dirhemi, duhet të shpjegojmë, ishte një monedhë e vogël prej argjendi, e cila është e barabartë afërsisht me çerek rapi në monedhën pakistaneze ose 2 centi dollarë amerikanë. E tërë shuma e xhizjes e paguar prej jomuslimanit më të pasur është afërsisht sa vlera e 1 dollari amerikan.

Përkundër kësaj shume të vogël, vetëm zekati i paguar prej një muslimani që posedon të njëjtën pasuri, është baraz me pesë dollarë amerikanë. Nga ana tjetër, atij i duhet që përveç atij të japë edhe të tjera lëmosha. Gjithashtu ndërsa shuma e vogël e përmendur më lart është maksimumi i xhizjes së paguar, vlera e zekatit rritet me rritjen e sasisë së pasurisë. Kështu, nuk ekziston kufi maksimal për zekatin. Gjithashtu të moshuarit, fëmijët, gratë, të varfërit, të gjymtuarit, burrat që bëjnë shërbim ushtarak dhe drejtuesit fetarë përjashtohen prej pagimit të xhizjes. Ndërkaq, përsa i përket zekatit, nuk ka kaq shumë persona të përjashtuar. Çdonjëri që posedon pasuri duhet ta paguajë zekatin.

Faktet e përmendura më lart dëshmojnë pa asnjë fije dyshimi se pagimi i xhizjes nuk shkakton aspak ndonjë padrejtësi, shtypje apo fanatizëm, siç është kuptuar prej shumë shkrimtarëve kristianë. Asgjë s'mund të jetë më larg së vërtetës. Në të vërtetë, duke përjashtuar Islamin, sjellje të tilla dashamirëse, të drejta dhe tolerante, vështirë se mund të priten prej ndonjë religjioni tjetër. Njeriu habitet se në çfarë shkalle paragjykimet dhe fanatizmi mund të shndërrojnë cilësitë me të vërtetë të larta në të dëmshme.

Harem: Haremi është një zonë apo vend në të cilin çdo gjë siguron statutin e diçkaje të shënjtë. Bari dhe pemët e këtij vendi nuk mund të priten, zogjtë dhe kafshët nuk gjuhen apo vriten

dhe aty ndalohet derdhja e gjakut. Të gjithë ata që shkojnë atje trajtohen sikur t'u ishte dhënë strehim, gjatë qëndrimit të tyre atje, madje edhe nëse ata janë kriminelë.

Sadaka - Hajrat. Këto terma janë simbol i bamirësisë, të cilën një musliman mendohet ta kryejë në shërbim të njerëzimit, pavarësisht prej ndonjë ndryshimi të besimit, kaste apo ideje. Në Islam ekzistojnë dispozita rigorozisht të përcaktuara, që lypësi të mos qortohet me fjalë të vrazhda, por nëse ndonjëri është i paaftë të japë lëmoshë, atëherë duhet të kërkojë ndjesë. Madje edhe fjalët e sjellshme dhe të përzemërta hyjnë në kategorinë e sadakasë, përpara syve të Zotit.

Na duket me vend të bëjmë me dije se Pejgamberi (s.a.v.s.) letrën e parë ia dërgoi mbretit të Etiopisë prej Mekës, në kohën kur grupi i dytë i muslimanëve, të detyruar prej shtypjes së padurueshme dhe çnjerëzore të Kurejshëve, emigroi në Etiopi. Periudhat e letrave mund të ndahen në dy. Periudha e parë e letrave është prej vitit të tetë pas pejgamberisë, dhe e dyta prej fillimit të traktatit të Hudejbijes.

Në letrat drejtuar çifutëve dhe të krishterëve, Pejgamberi (s.a.v.s.) në përgjithësi vë theksin në Njëjësinë e Allahut dhe në faktin se asnjë qenie njerëzore sado e rëndësishme, e shquar apo e fuqishme, nuk mund të barazohet as të shoqërohet me Allahun, prandaj asnjë prej idhujve s'ishte i

denjë për t'u krahasuar me Të në asnjë mënyrë. Ai gjithashtu ua bëri të qartë atyre që të hiqnin dorë nga të gjitha çështjet në të cilat kishin mos-përputhje mendimesh, dhe të merreshin vesh në ato gjëra të cilat pranoheshin edhe prej tyre edhe prej muslimanëve. Në letrat drejtuar të pafeve apo pabesimtarëve, Pejgamberi (s.a.v.s.) theksonte se idhujt absolutisht nuk kishin ndonjë forcë dhe se e gjithë fuqia i përket Allahut.

Një studim i hollësishëm i marrëveshjeve dhe pakteve do të zbulonte se ato përshkruheshin nga fryma e pajtimit, miqësisë, vullnetit të mirë, drejtësisë dhe ndershmërisë. Kurejshitët këmbëngulnin që në paktin e Hudejbijes të përfshiheshin edhe disa nene të cilat në dukje ishin të papranueshme për muslimanët. Pejgamberi (s.a.v.s.) u morr vesh me ta, megjithëse shokët e tij nuk ishin të kënaqur me përfundimin e paktit me kushte, të cilat dukeshin poshtëruese për muslimanët, veçanërisht neni katër, në të cilin ishte vendosur se nëse një musliman binte në duar të Kurejshëve, ata mund ta mbanin atë, por nëse ndonjë prej anës së Kurejshëve zihej rob prej muslimanëve, ai mund t'u kthehej Kurejshëve. Sidoqoftë, shokët e tij treguan bindje të plotë ndaj Pejgamberit (s.a.v.s.). Kjo ishte një provë e vërtetë për Pejgamberin (s.a.v.s.) se ai ishte parashikues i vërtetë dhe mundi të parashikojë atë që një njeri i zakonshëm nuk do të mund ta bënte.

Në parashikimin e tij ai mundi qartë ta parashikonte të ardhmen dhe shfaqti maturi të jashtëzakonshme në pranimin e kushteve të kundërshtarëve të tij. Ai ishte lajmëtar i paqes dhe prandaj zgjodhi rrugën e paqes dhe jo të konfliktit. Ai kishte mirëbesim tek shokët e tij dhe mundi të parashikonte se nëse ndonjëri prej tyre do të burgosej prej Kurejshitëve, ai me sjelljen dhe karakterin e tij të lartë do të mund të ushtronte ndikim mbi pabesimtarët dhe kjo ishte ajo që ndodhi në të vërtetë. Në realitet ajo ishte një fitore e shkëlqyer e Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe Allahu i Madhërishëm e quajti atë në Kur'anin e Shenjtë: "*Fitore e pastër apo e hapur*". Traktati shërbeu si pikënisje e përfitimeve dhe sukseseve të konsiderueshme për Islamin në një të ardhme të afërt. Arritja më e rëndësishme e traktatit ishte se më vonë muslimanët dhe pabesimtarët u bënë më të afërt dhe kjo çoi në një shoqërim më të ngushtë midis dy palëve. Kjo zhvilloi marrëdhënie të afërta dhe ndërroi idetë dhe pikëpamjet. Natyrisht ata filluan të anonin në drejtim të Islamit dhe vlerave të larta të tij. Rrjedhim logjik i gjithë kësaj ishte fakti që brenda një periudhe prej dy vitesh një numër i madh i njerëzve u konvertuan në fenë Islame. Në volumnin e dytë të *Historisë së Taberit* (Ngjarja e Hudejbijës) bëhej e ditur se numri i njerëzve që e pranuan Islamin gjatë kësaj periudhe e tejkalonte numrin e atyre

që u bënë muslimanë gjatë periudhës së tetëmbëdhjetë viteve që pasuan.

Gjithashtu duhet të nënvizohet fakti se shumica e *letrave* ishin jashtëzakonisht të efektshme. Letra e cila iu dërgua Husro Pervez-it e tërboi fare këtë të fundit, i cili e konsideronte veten si gjysëmperëndi. Mbretëria e Husro Pervezit ishte mjaft e madhe, pasuria dhe shkëlqimi i pallateve të tij ishin përrallore. Ai nuk mund ta përfytyronte se si një njeri i zakonshëm, të cilin ai e konsideronte si të nënshtruarin e tij, mund të shkruante emrin e vet, përpara emrit të perandorit dhe të mund të guxojë të kërkojë atij të pranohet Islamin. Ai u tërbua kaq shumë saqë e grisi letrën dhe bërtiti: "*Si një skllav guxon të na dërgojë neve një letër të tillë?*" Ai e urdhëroi Guvernatorin e Jemenit ta kapte atë dhe ta dërgonte në oborrin e tyre mbretëror. Lajmësi i Pejgamberit (s.a.v.s.) me mjaft guxim iu drejtua perandorit dhe oborrit të tij mbretëror, duke iu thënë atyre se ekzistonin mbretëri më të mëdha se mbretëria e tyre, e cila s'ishte veçse një pjesë e vogël e tokës së Allahut dhe në të cilin ata ishin kaq krenarë. Ai gjithashtu ua bëri të qartë se thirrja e drejtë nuk mund të shtypej prej sjelljes së tyre poshtëruese. Ai mbas kësaj u largua prej oborrit mbretëror dhe në raportin e tij e tregoi ngjarjen përpara Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili kishte vënë në dukje (pikërisht në momentin e grisjes së letrës) se mbretëria e madhe

e Kisrasë në pak vite do të shpërbëhej dhe do të ndahej në copa. (*Historia e Taberit*).

Siç thamë më lart, Husro Pervezi urdhëroi Bazantin, Guvernatorin e Jemenit, ta kapte Pejgamberin (s.a.v.s.) dhe ta sillte atë në oborrin e tij. Bazani caktoi Bebojën dhe Ker Kasrën në Medine për të përmbushur urdhërat. Të dy u paraqitën tek Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe me respektin e duhur e njoftuan se perandori Husro i ka dërguar për të. Përveç kësaj ata sqaruan se nëse urdhërat e Perandorit nuk do të përmbusheshin, më vonë ai do ta shkatërronte atë (Pejgamberin) dhe vendin e tij. Por të dërguarit e Bazanit u sprapsën kur dëgjuan Pejgamberin të thoshte: *"Fati i ka rrotulluar tavolinat e mbretërisë suaj. Husro ka për t'u vrarë prej djalit të vet Sheroja. Ju çojani të rehat zotëriut tuaj. Gjithashtu njoftojeni atë se ai shumë shpejt do të bindet se Shteti Islamik do të shtrihet në kryeqytetin e mbretërisë së Kisrasë"*.

Kështu ndodhi që Çezari e mundi Kusron dhe ushtria bizantine u tërhoq në kryeqytetin e Iranit. Në këtë kohë shpërthyen trazira në familjen Kusro, i cili ishte burgosur prej djalit të tij, Sheroja. Është shkruar në *Historinë e Taberit* që Sheroja e vrau babain e tij në natën e 13-të të Xhumade'l-Ula, të vitit të 7-të Hixhri, pra në vitin 628 e.s. Të dërguarit e guvernatorit të Jemenit ishin shumë të impresionuar prej karakterit dhe sjelljes së lartë të Pejgamberit (s.a.v.s.), si dhe

mënyrës jashtëzakonisht të thjeshtë të jetës së tij dhe e shokëve të tij. Me të arritur në Jemen ata treguan përshtypjet e tyre dhe peygamberinë e Muhammedit (s.a.v.s.). Bazani u ndikua gjithashtu tepër prej këtyre fjalëve dhe tha: "*Sipas fjalëve të tij, ai nuk dubet të jetë mbret i kësaj jete, por sigurisht një i dërguar i Allahut. do të dubet të presim ende të verifikojmë peygamberinë*".

Kur Beboja dhe Ker Hasra u kthyen në Jemen, Bazani mori një mesazh prej Sheroja, se Husro ishte vrarë për shkak të veprimeve të tij shumë tiranike. Ai gjithashtu tregonte se Peygamberi Arab (s.a.v.s.) nuk ishte përzier në këtë çështje. Më në fund Bazani u bind në vërtetësinë e Peygamberit (s.a.v.s.) dhe ai përqafoi Islamin, bashkë me një numër të madh të popullit të tij.

(Historia e Taberit, vol. 3, faqe 91)

Pavarësisht prej faktit se Letra dërguar Husro Pervezit ishte grisur prej tij, ishte një mrekulli që ajo i rezistoi zhdukjes për më tepër se trembëdhjetë shekuj. Kur Husro e grisi dhe e hodhi tutje, dikush e ngriti atë dhe dalëngadalë ajo e gjeti udhën në një koleksion të një familjeje kristiane të Libanit dhe së fundi u zbulua prej ministrit të jashtëm të dikurshëm të Libanit, Henri Paraoh. Studiuesit të cilët e shqyrtuan letrën hollësisht, vërtetuan se ajo ishte letra e vërtetë e shkruar prej Peygamberit Muhammedit (s.a.v.s.) drejtuar Husro Pervezit.

PJESA E PARË:
**Traktatet,
paktet dhe
marrëveshjet**

1. Karta e Medines

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kjo marrëveshje e Pejgamberit të Allahut, Muhammedit (s.a.v.s.) u drejtohet të migruarve, Kurejshëve, qytetarëve të Jethribit (Medines) që e kanë pranuar Islamin dhe të gjithë atyre njerëzve që janë në marrëveshje me grupet e përmendura më lart dhe marrin anën e tyre në kohë lufte.

2. Të gjithë ata që bëjnë pjesë në këtë marrëveshje do të trajtohen si grup i ndarë prej të gjithë atyre që nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje.

3. Kurejshët e migruar, si edhe më parë, përbëjnë një grup më vete, ata duhet të jenë përgjegjës për shpagimin e gjakut të kriminelëve të tyre dhe ata vetë duhet t'i lirojnë robërit e tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të jetë në përputhje me parimet e besimit (Imanit) dhe drejtësisë.

4. Benu Auf duhet të jetë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet ta paguajnë bashkarisht shpagimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

5. Benu El-Haris duhet të jetë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet ta paguajnë bashkarisht shpagimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

6. Benu Sa'ida duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet ta paguajnë bashkarisht shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

7. Benu Xhusham duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkarisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

8. Benu En-Nexhxhar duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkarisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

9. Benu Amr duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkarisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

10. Benu El-Wabijjat duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkarisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

11. Benu El-Ews duhet të jenë përgjegjës për vetë fisin e tyre dhe duhet bashkarisht ta paguajnë shpërblimin e gjakut në përputhje me nenin 3 dhe ata duhet të jenë vetë përgjegjës për lirimin e robërve të tyre pas pagimit të shpërblimit për lirim. I gjithë ky proces duhet të kryhet në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë.

12. Nëse në radhët e muslimanëve një njeri i varfër është fajtor i ndonjë sulmi, për të cilin shpagimi i gjakut bëhet i detyrueshëm, ose ai merret rob dhe nuk është i aftë vetë ta paguajë shpërblimin për lirim, duhet të jetë detyrë e muslimanëve të tjerë ta paguajnë në emër të tij shpagimin e gjakut ose shpërblimin për lirim

dhe ta lirojnë atë, me qëllim që, në marrëdhëniet e ndërsjella të muslimanëve, të krijoheshin virtutet dhe dashamirësia.

13. Asnjë musliman nuk duhet të armiqësohet me një rob të liruar prej një muslimani tjetër.

14. Është detyrë e muslimanëve të kundërshtojnë hapur çdo person që shkakton dëme dhe trazira, shqetëson njerëzit ose me forcë do t'iu grabisë diçka dhe përdor dhunën. Të gjithë muslimanët duhet të mbeten të bashkuar njëri me tjetrin, në dënimin e një personi të tillë, madje edhe nëse ai është djali i ndonjërit prej tyre.

15. Muslimani nuk ka të drejtë të vrasë një musliman tjetër në shkëmbim të një të pafeji (i cili është në gjendje lufte) ose të ndihmojë një person, i cili është në gjendje lufte me muslimanët.

16. Premtimi i Allahut, përgjegjësia dhe përkrahja, janë të njëjta për të gjithë. Kjo do të thotë se nëse një musliman i jep strehim ndonjërit, duhet të jetë detyrë e të gjithë muslimanëve ta nderojnë atë, edhe nëse muslimani që e ka siguruar të strehuarin mund të jetë prej shtrese të ulët. Të gjithë muslimanët janë të vëllazëruar ndërmjet vete, në krahasim me të tjerët.

17. Është detyrë e gjithë muslimanëve të ndihmojnë dhe t'u ofrojnë sjellje miqësore çifutëve, të cilët kanë hyrë në marrëveshje me ta. Asnjë shtrëngim i çfarëdo lloji qoftë nuk duhet

ushtruar mbi ta dhe nuk duhen ndihmuar armiq-të e tyre kundër tyre.

18. Armëpushimi i të gjithë muslimanëve duhet të jetë i njëkohshëm: Kur ka luftë në rrugë të Allahut, asnjë prej muslimanëve s'duhet të mënjanohet prej muslimanëve të tjerë, apo të hyjë në traktat paqe me armikun, veçse nëse traktati është i njëkohshëm dhe i njëjtë për të gjithë muslimanët.

19. Të gjitha grupeve, të cilat marrin pjesë në luftë bashkë me ne, do t'u jepet mundësia për të pushuar me radhë.

20. Nëse një musliman bie dëshmor në rrugë të Allahut, furnizimi i jetës së atyre që varen prej tij duhet të jetë përgjegjësi e të gjithë muslimanëve.

21. Pa asnjë dyshim të gjithë muslimanët e devotshëm që i frikësohen Zotit janë në rrugë të drejtë dhe janë pasues së rrugës më të mirë të jetës.

22. Asnjë jomusliman që është palë e kësaj marrëveshjeje, nuk duhet të sigurojë strehim të jetës dhe të pronës së ndonjë Kurejshi e as duhet të ndihmojë ndonjë jomusliman kundër një muslimani.

23. Nëse dikush vret një musliman dhe për këtë ka fakte kundër tij, vrasësi duhet të ndëshkohet. Por nëse farefisi i afërm është pajtuar të pranojë shpagimin e gjakut, vrasësi duhet të lihet i lirë. Duhet të jetë obligim i të gjithë muslimanëve ta respektojnë këtë vendim pa asnjë përjashtim.

Asgjë tjetër përveç asaj që paracaktojnë urdhërat nuk duhet të pranohet.

24. Për një musliman, i cili pas pranimit të marrëveshjes ka rënë dakord që ta respektojë atë, dhe ai beson në Allah dhe në Ditën e Gjyimit, atij nuk i lejohet të sajojë asnjë veprim apo zakon të ri e as do të ishte e pranushme që ai të ketë marrëdhënie tregtare me një person që nuk e respekton këtë marrëveshje. Mallkimi dhe zemërimi i Zotit do të bierë në ditën e Gjykimit mbi cilindo që shkel këtë marrëveshje dhe në këtë drejtim asnjë shfajësim dhe asnjë kërkesë për falje nuk do të pranohet prej tij.

25. Kur të lindin mosmarrëveshje të dyanshme rreth ndonjë pike të kësaj marrëveshjeje, çështja do të drejtohet për vendim Allahut dhe Muhammedit (s.a.v.s.).

26. Pas traktatit, çifutët do të jenë të obliguar t'u dorëzojnë muslimanëve ndihmë financiare, kur ata të jenë në luftë me armikun.

27. Çifutët e fisit Benu Auf, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyre. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej tyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

28. Çifutët e Benu En-Nexhxhar, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyre. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej tyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

29. Çifutët e fisit Benu El-Haris, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyre. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

30. Çifutët e fisit Benu Sa'id, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyre. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

31. Çifutët e fisit Benu Hashim, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe përkrahës të muslimanëve,

duhet t'i përmbahen me vendosëmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyre. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

32. Çifutët e fisit Benu El-Avs, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyre. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

33. Çifutët e fisit Benu Sa'laba, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosëmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyre. Përveç çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

34. Çifutët e fisit Benu Xhafna, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet t'i përmbahen me vendosëmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyre. Përveç

çështjeve fetare, muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale, thyen betimin ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

35. Çifutët e fisit Benu El-Shataiba, që janë palë e kësaj marrëveshjeje dhe janë përkrahës të muslimanëve, duhet të përmbahen me vendosmëri fesë së tyre dhe muslimanët së tyre. Përveç çështjeve fetare muslimanët dhe çifutët duhet të konsiderohen se i përkasin një grupi të vetëm. Nëse ndonjë prej këtyre kryen shkelje brutale ose thyen betimin, ose është fajtor për ndonjë krim, ai meriton të ndëshkohet për krimin e tij.

36. Degët e varura prej fiseve të përmendura më lart do të kenë të drejta të njëjta me ato që gëzojnë degët bazë.

37. Asnjë prej hartuesve të traktatit nuk mund të marrë ndonjë aksion ushtarak pa lejen e Muhammedit (s.a.v.s.).

38. Asnjë pengesë nuk duhet të shkaktohet për kompensimin apo shpagimin e ndonjë plage apo goditjeje. Kushdo që bën shkeljen e betimit meriton të ndëshkohet për këtë dhe cilido që i përmbahet me shumë vendosmëri këtij traktati, Allahu do ta ndihmojë atë.

39. Nëse një bashkësi e tretë zhvillon luftë kundër muslimanëve dhe çifutëve, pjesëmarrës në traktat, ata do të duhet të luftojnë bashkarisht.

Ata duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin reciprokisht dhe ndërmjet tyre duhet të ekzistojë dashamirësia dhe besueshmëria e ndërsjellë. Çifutët duhet t'i përballojnë shpenzimet e tyre të luftës dhe muslimanët shpenzimet e tyre.

40. Është detyrë e palëve të kësaj marrëveshjeje të sillen me njëri-tjetrin sinqerisht dhe t'ia dëshirojnë të mirën njëri-tjetrit. Asnjëri nuk duhet ta bëjë tjetrin objekt shtypjeje dhe padrejtësie dhe i shtypuri duhet të ndihmohet.

41. Çifutët duhet t'i ndajnë shpenzimet së bashku me muslimanët për aq kohë sa ata luftojnë bashkarisht.

42. Rafshina e Jethribit, e cila rrethohet prej kodrave, do të jetë *haram* (strehim) për palët pjesëmarrëse të traktatit.

43. I njëjti trajtim duhet të bëhet edhe ndaj një refugjati, që konsiderohet personi të cilit i është dhënë e drejta e strehimit, ai nuk duhet të dëmtohet. I strehuari duhet ta respektojë këtë marrëveshje dhe nuk duhet të lejohet ta thyejë premtimin.

44. Askush nuk duhet të strehojë një refugjat pa lejen e njerëzve të këtij vendi.

45. Nëse ka ndonjë moskuptim apo mosmarrëveshje të mendimeve midis palëve pjesëmarrëse të traktatit, e cila mund të çojë në prishjen e paqes, çështja duhet t'i drejtohet për zgjidhje Allahut dhe Muhammedit, të Dërguarit të Allahut

(s.a.v.s.). Allahu do të jetë me atë, i cili më së shumti i përmbahet traktatit.

46. Askush nuk duhet të garantojë mbrojtje për Kurejshët e Mekes apo për ndonjë nga përkrähësit e tyre.

47. Nëse Jethribi (Medina) do të pushtohet, muslimanët dhe çifutët bashkarisht duhet t'iu kundërvihen me një mbrojtje të bashkuar.

48. Nëse muslimanët bëjnë traktat paqeje me ndokënd, çifutët duhet ta respektojnë atë. Edhe nëse çifutët bëjnë paqe me ndokënd, muslimanët janë të obliguar të ofrojnë bashkëpunim të ngjashëm me çifutët. Por në rast të një lufte fetare të njërës palë, nuk do të jetë përgjegjësi e palës tjetër të bashkëveprojë në të.

49. Në rast të pushtimit të Medines, secila palë duhet të mbrojë pjesën që është përpara saj.

50. Përkrähësit e fisit Evs do të kenë të drejta të njëjta ashtu sikurse gëzojnë edhe palët pjesëmarrëse të këtij traktati, me kusht që ata të dëshmojnë besnikërinë e tyre. Allahu është Mbrojtësi dhe Përkrähësi i atij që i përmbahet me vendosmëri më së shumti këtij traktati.

51. Nëse ndonjëra prej palëve pjesëmarrëse të këtij traktati duhet të dalë jashtë Medines për shkak të kërkesave urgjente të luftës, ajo duhet të gëzojë të drejtën e mbrojtjes dhe përkrähjes. Gjithashtu edhe cilido që qëndron në Medine gëzon të drejtën e paprekshmërisë. As nuk duhet të

dhunohet ndokush e as nuk duhet të lejohet që ai ta shkelë premtimin. Allahu dhe i Dërguari i Tij (s.a.v.s.) do të jenë mbrojtësit e cilitdo që do ta respektojë me gjithë zemër këtë marrëveshje dhe do t'i bindet asaj³.

³ Ibn Hisham, vol. 1, f. 178-179; Ibn Kethir, *El-Bidaje we'n-Nibaje*, vol. 3, f. 224-226; dhe *El-Wesaike 'us-Sijasije*, f. 1-7.

2. Pakti me fisin e Xhuhejnit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Jeta dhe prona e fisit të Xhuhejnit do të jenë të sigurta.

2. Kushdo që kryen ndonjë shkelje brutale ndaj tyre apo i pushton ata, ata (Xhuhejnët) do të ndihmohen kundër tyre.

3. Por, për çfarëdo ngatërrese apo lufte që ndodh ndërmjet të afërmve dhe farefisit të tyre, ose nëse kjo ka lidhje me çështjet e tyre fetare, ndihma nga kjo pikëpamje nuk duhet të jetë e domosdoshme.

4. Njerëzit e mirë dhe të bindur ndaj Zotit, që banojnë afër këtij populli, duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta që janë të lejueshme për Xhuhejnin⁴.

⁴ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 64 - 67.

3. Vendimi i dytë i Pejgamberit (s.a.v.s.) për Xhuhejnin

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Cilido prej fisit të Xhuhejnit që pranon Islamin, kryen namazet, paguan zekatin, qëndron i bindur ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.), i përmbahet pagimit të humsit (5 %) të të ardhurave të luftës, deklaron pranimin e tij të Islamit dhe qëndron larg pabesimtarëve, ai është nën mbrojtjen e Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.).

Përsa i përket pasurisë së lënë peng apo pagimit të huave, duhet të paguhet vetëm vlera fillestare pasi (borxhliu) pranon Islamin. Interesat mbi vlerën e lënë peng duhet të anulohen. Ndërsa zekati i frutave - një e dhjeta e prodhimit, duhet të paguhet. Kushdo që i bashkangjitet këtij populli duhet të gëzojë të njëjtat të drejta dhe të njëjtat kushte duhet të zbatohen prej tij⁵.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁵ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 24, 25, 27.

Shënim. Kur pas pak kohe, shumica e anëtarëve të fisit e pranuan Islamin, Pejgamberi (s.a.v.s.) nxori një vendim për këta njerëz, në të cilin përmendte detyrat e tyre.

4. Pakti me Benu Dhamra

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Kjo shkresë është prej Pejgamberit të Allahut,
Mubammedit (s.a.v.s.), drejtuar Benu Dhamra*

1. Këtij populli i garantohet siguria e jetës dhe e pronës.

2. Ky popull do të ndihmohet kundër kujtdo që do t'i sulmojë ata.

3. Kjo duhet ta obligojë këtë popull që gjithmonë ta ndihmojë Pejgamberin (s.a.v.s.) dhe kurdo që Pejgamberi i Allahut kërkon ndihmën e tyre, ata duhet ta japin përkrahjen e vet, ndërsa në luftërat fetare ndihma nuk është e domosdoshme.

4. Përsa kohë ky popull i përmbahet me vendosmëri paktit, ai do të ndihmohet.

5. Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë dëshmitarë për këtë pakt⁶.

Shënim. Një numër paktesh të tilla u vendosën edhe me fiset që jetonin afër Benu Dhamra.⁷ Pakti që vijon me Benu Zur'a dhe Benu Rab'a të Xhubejnit është i së njëjtës natyrë.

⁶ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 27

⁷ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 24.

5. Për Benu Zur'a dhe Benu Rab'a

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Jeta dhe prona e Benu Zur'a dhe Benu Rab'a do të kenë garanci dhe siguri.

2. Benu Zur'a dhe Benu Rab'a duhet të ndihmohen kundër çdo personi që i sulmon ata.

3. Në konfliktet e tyre të brendshme nuk do të ndërhyhet.

4. Njerëzit e devotshëm dhe që i frikësohen Zotit, që banojnë në afërsi të këtyre fiseve, do të gëzojnë të drejta të njëjta me ato që gëzojnë njerëzit e këtyre fiseve⁸.

⁸ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 24.

6. Pakti me Benu Gifar

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Benu Gifar do të vlerësohen prej muslimanëve. Ata do të kenë të njëjtat të drejta sikurse edhe muslimanët dhe ata duhet t'u nënshtrohen të njëjtave urdhëra që zbatohen edhe prej muslimanëve.

2. Pejgamberi Muhammed (s.a.v.s.) ka hyrë në pakt për ruajtjen e jetës dhe të pronës suaj dhe Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë dëshmitarë për këtë.

3. Ata do të ndihmohen kundër çdo armiku që do t'i sulmojë egërsisht.

4. Është obligim i këtij populli të japë ndihmën e vet kur ajo të kërkohet prej Pejgamberit të Allahut (s.a.v.s.). Por në luftërat fetare secila palë duhet të mbetet e paanshme.

5. Nëse ndokush bie në kundërshtim me këtë, ky pakt nuk do të vlejë më dhe s'ka asnjë justifikim (ose falje) për atë.

Shënim. Fisi Benu Gifar dërgoi një delegacion te Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe propozoi të hynte në pakt/ marrëveshjeje me të. Kërkesa u pranua prej Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili bëri hartimin e paktit. Përpara se të përfaqsonin Islamin, anëtarët e fisit ishin kusarë dhe hajdutë profesionistë, që grabisnin karvanet dhe fiset. Ebu Dherr Gifari (r.a.), as'habi i njohur i Pejgamberit (s.a.v.s.), i përkiste këtij fisi⁹.

⁹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq.27

7. Traktati i Hudejbijes

*Në emër të Allahut*¹⁰.

1. Ky është traktati në të cilin Muahammedi (s.a.v.s.), djali i Abdullahut, ka bërë kompromis me Suhejlin, djalin e Omerit.

2. Nuk do të ketë luftë të ndërsjellë për 10 vjet.

3. Gjatë kësaj periudhe çdo person që i përket qoftë njërës apo tjetrës palë, do të jetë i mbrojtur dhe i sigurt dhe askush nuk do ta ngrejë armën kundër tjetrit.

4. Nëse një person nga ana e Kurejshëve shkon në Medine, ai duhet të kthehet mprapsht, por nëse ndonjë musliman shkon në Meke, ai nuk do të kthehet¹¹.

5. Fiset arabe do të jenë të lira të hyjnë në traktat nga ana e cilësdo prej të dy palëve.

¹⁰ Zakonisht Pejgamberi (s.a.v.s.) në fillim të marrëveshjes ka shkruar: "*Bismi'l-Labi'r-Rrahmani'r-Rrahim*", por për shkak të kundërshtimit të Suhejlit, përfaqësuesit të Kurejshëve, në vend të saj u shkrua "*Bismi Ka'll-llabumme*", në përputhje me një zakon arab.

¹¹ Ky traktat është një shembull i qartë i maturisë së jashtëzakonshme të Pejgamberit s.a.v.s., për të përmbushur premtimet. Traktati ishte në procesin e shkruarjes së tij, kur Ebu Xhunal, djali i Suhejlit, i cili e kishte pranuar Islamin dhe të cilin babai i vet për ta ndëshkuar e kishte futur në burg, u arratis prej burgut dhe i lidhur me pranga u shfaq përpara Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe iu lut që ai të shpëtohej prej tiranisë së Kurejshëve. Shokët e tij u tmerruan kur e panë gjendjen e tij. Por duke e respektuar traktatin, Pejgamberi (s.a.v.s.) e ktheu atë tek Kurejshët.

6. Muslimanët do të kthehen mbrapsht kësaj here dhe do të vijnë vitin tjetër, por ata nuk duhet të qëndrojnë në Meke më shumë se 3 ditë.

7. Ata nuk duhet të kthehen të armatosur dhe me vete duhet të kenë vetëm shpatat, por këto nuk duhet të mbahen jashtë këllëfit dhe në këllëf duhet të mbahen nëpër trasta¹².

¹² Historia e Taberit, vol. 8.

8. Pakti me Benu Gadaja dhe Benu Ureiz

Pakti që pason është bërë me çifutët e Benu Gadaja.

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Nga Muhamedi, Pejgamberi i Allahut
Drejtuar çifutëve të Benu Gadaja.*

1. Merret përsipër përgjegjësia përsa i përket çifutëve të Gadaja.
2. Këtij populli i është caktuar xhizja.
3. Ky popull në asnjë mënyrë nuk duhet të ngrihet kundër Pejgamberit.
4. Ky popull nuk do të dëbohet prej shtëpive të tyre.
5. Asgjë s'duhet ta bëjë këtë pakt të pavlefshëm¹³.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

¹³ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3. p. 27.

9. Pakti i Nexhranit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Ky pakt i Muhammedit (s.a.v.s.), Pejgamberit të Allahut, është për popullin e Nexhranit

1. Megjithëse Pejgamberi Muhammed (s.a.v.s.) kishte mundësi të merrte pjesë prej prodhimit tuaj, flori, argjend, armë dhe sklevër, ai i trajtoi njerëzit me shpirtmadhësi dhe duke i lënë mënjane të gjitha këto gjëra, caktoi për ta dy mijë *hullas*¹⁴, për çdo vit, secila me një vlerë prej një *Aukia* - një mijë (të furnizohen) në muajin *Rexheb* dhe një mijë në muajin *Safer*.

2. Secila *Hulla* duhet të jetë në vlerën e një *Aukia* dhe çdo gjë që është më shumë ose më pak se kjo vlerë, duhet të vlerësohet në pajtim me këtë.

3. Nëse në vend të *Hullas* jepet diçka tjetër, si armë, kuaj apo deve udhëtimi, atëherë ato duhet të llogariten në përputhje me vlerën e tyre.

4. Duhet të jetë obligim i popullit të Nexhranit, të parapërgatitet për qëndrimin e punëtorëve të mi. Ndërkaq ata do të duhet të paguajnë taksat

¹⁴ *Hulla* është një lloj veshjeje arabe që përbëhet prej dy çarçafëve, të cilat mund ta mbulojnë krejt trupin e njeriut.

brenda një muaji. Ata nuk do të qëndrojnë më tepër se një muaj.

5. Nëse ne do të duhet të bëjmë luftë për shkak të ndonjë rebelimi në Jemen, populli i Nexhranit do të duhet të na huazojë 30 armë, 20 kuaj dhe 30 deve. Nëse ndonjë prej kafshëve humbet, populli i Nexhranit do të kompensohet.

6. Jeta e popullit të Nexhranit dhe hapësira rrethuese e tij, feja e tyre, vendi i tyre, pasuria, kafshët dhe gjithçka e tyre ku është e ku s'është, lajmëtarët dhe vendet e tyre të adhurimit janë nën mbrojtjen e Allahut dhe mbikëqyrjen e Pejgamberit të Tij. Gjendja e tyre e tanishme nuk do të trazohet, rregullat e tyre nuk do të ndryshohen dhe as idhujt e tyre nuk do të shformohen. Uskuf¹⁵ (Peshkopi) Rahib apo Weka nuk duhet të hiqen nga funksionet e tyre. Qëllimi është që të ruhet gjendja e gjithsecilit, ashtu siç është (të ruhet status quo).

7. Asnjë njeri nuk do të ndëshkohet për ndonjë krim apo vrasje të kryer në të kaluarën, dhe ata nuk do të detyrohen të kryejnë shërbimin ushtarak. Askush nuk duhet t'u imponojë atyre *Ushr* dhe nuk duhet që në zonën e tyre të depërtojë ndonjë ushtri.

¹⁵ Këto ishin rangje fetare të popullit të Nexhranit. Këto janë të njëvlershme me Peshkopin (peshkopi i Saksonisë së vjetër, peshkopi i Gjermanisë së Vjetër të Madhe apo Oshënari)

8. Nëse ndonjëri nga populli i Nexhranit kërkon të drejtën e tij, drejtësia duhet të ndërhyjë midis paditësit dhe të paditurit. Nuk do të lejohet të kryhet asnjë lloj shtypjeje mbi ta, e as ata nuk do të lejohen të shtypin ndokënd.

9. Kushdo prej banorëve të Nexhranit, që do të marrë kamatë pas përfundimit të paktit, do të jetë i përjashtuar prej garancisë sime.

10. Asnjë prej popullit të Nexhranit nuk duhet të ngatërrohet në krimin e dikujt tjetër.

11. Për çdo gjë që është shkruar në këtë pakt, Allahu dhe Pejgamberi i Tij, Muhammedi (s.a.v.s.), janë garantues për to, derisa të ekzistojë urdhëri i Allahut në lidhje me këtë dhe për aq kohë sa populli i Nexhranit qëndron i devotshëm dhe u përmbahet me vendosmëri kushteve të cilat u janë vendosur atyre, me përjashtim të rastit kur dikush i detyron ata të veprojnë ndryshe¹⁶.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

¹⁶ Beladhuri, *Futub'ul-Buldan*, vol. 1, f. 64, 64.

Shënim. Nexhrani, që ishte një qendër tepër e rëndësishme e Krishterimit në Arabi, është një rajon në veri të Jemenit. Në të ka ekzistuar një Katedrale madhështore, të cilën të krishterët e konsideronin si Kabe të tyre. Pronat e mëdha që i përkisnin Katedrales ishin burim i të ardhurave të mëdha. Kur populli i Nexhranit e mori letrën e Pejgamberit (s.a.v.s.), ata dërguan një delegacion tek Pejgamberi (s.a.v.s), të cilët shqyrtuan kushtet dhe bënë diskutime. Pejgamberi (s.a.v.s.) i ftoi ata te Mubabila (Lutje për Mallkimin e Allahut mbi grupin që është në rrugë të gabuar dhe kërkoi prej tyre që të mblidheshin së bashku me miq dhe farefis dhe t'i luteshin Allahut, që të dërgojë Mallkimin e Tij mbi gënjeshtarët. Delegacioni nuk e pranoi këtë kërkesë, nga frika se mallkimi do të binte mbi ta dhe u morën vesh të vendosin një pakt.

10. Pakti i Thekifit (Taif)

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kjo shkresë e Muhammedit (s.a.v.s.), Pejgamberit të Allahut, është për Thekif.

2. Dëshmitar për çdo gjë që është shkruar në këtë dokument është Allahu, i cili është Një e i Plotëfuqishëm dhe Muhammedi (s.a.v.s.) djali i Abdullahut.

3. Lugina e Thekifit shpallet Haram. Për këtë arsye prerja e pemëve të egra gjëmbore, gjuetia, dhuna, vjedhja dhe veprimet e tjera të dëmshme në të janë të gjitha haram (rreptësisht të ndaluara).

4. Sekif ka pjesën më të madhe të së djathtës të Wujit¹⁷. Përmes tokës së Taifit nuk duhet të depërtojë ndonjë ushtri dhe asnjë musliman nuk duhet të shkojë atje dhe t'i nxjerrë njerëzit prej aty. Ky popull mund të bëjë çdo gjë që dëshiron në Taif dhe në luginën e tij dhe mund të konstruktojnë çfarëdo ndërtese që atyre u pëlqen.

5. Populli i Taifit do të jetë i liruar prej ushrit, zekatit dhe ndihmës ushtarake. Nuk duhet të ketë asnjë shtrëngim përsa i përket jetës dhe pronës së tyre.

¹⁷ Kjo ishte një luginë ranore në kohën e Pejgamberit (s.a.v.s.). Ajo rrethohej prej kodrash. Në kohën e sotme Taifi shtrihet në të njëjtën luginë.

6. Ky popull duhet të konsiderohet si një grup muslimanësh. Si rrjedhim, ata mund të lëvizin midis muslimanëve pa ndonjë kufizim.

7. Nëse dikush prej njerëzve të Taifit kapet rob, ata duhet të kenë të drejtë ta zgjidhin vetë problemin.

8. Çfarëdo borxhi që njerëzit e Taifit janë të detyruar të paguajnë për sendet e lëna peng dhe të gjitha borxhet për sendet e lëna peng, që do të duhej të paguheshin deri pas sezonit të Ukadhut¹⁸, duhet të paguhen gjatë Ukadhit. Allahu është dëshmitar përsa i përket kamatës.

9. Në kontratat e banorëve të Taifit, çfarëdo borxhesh që kanë qenë për t'u marrë deri në momentin e pranimit të Islamit, prej tyre, është e drejtë t'i marrin ato.

10. Nëse ndonjë send që u përket banorëve të Taifit i është besuar dikujt dhe dëmtohet prej atij që e ka në ngarkim, duhet që ky t'ia kthejë objektin pronarit të vet ashtu siç ka qenë në fillim.

11. Banorët e Thekifit, që nuk gjenden, këtu gëzojnë të njëjtat masa sigurie dhe të njëjtat të drejta sikurse i gëzojnë edhe ata që janë këtu. Çfarëdo prone që ata kanë në Lajja, duhet të jetë e siguruar si Wuj.

¹⁸ Ukadhi ishte një panair që mbahej përpara Islamit midis Taifit dhe Nahlab dhe zgjaste 20 ditë. Ajo ishte një lloj arene letrare kombëtare. Ajo ishte një luginë, që shtrihej në një distancë 6 miljesh prej Taifit.

12. Po ashtu, kushdo që është bashkëpunor i tyre në tregti apo ndihmës i tyre, gëzon të njëjtat të drejta sikurse ata.

13. Nëse ndokush kryen ndonjë dëm financiar apo fizik, apo merr nëpër këmbë të drejtat e banorëve të Thekifit, të gjithë muslimanët duhet ta ndihmojnë Thekifin kundër fajtorit.

14. Nëse ndokush është i padëshirushëm për të hyrë në këtë vend, ai nuk duhet të hyjë në të.

15. Këta banorë mund të ndërtojnë vende për blerje dhe shitje në pjesët e përparme të shtëpive të tyre.

16. Sundimtari i Thekifit duhet të emërohet prej vetë mesit të tyre. Për këtë arsye Benu Malik dhe Benu Ahlaf duhet të kenë Emirët e tyre.

17. Banorët e Thekifit që do të vadisin kopshtet e Kurejshëve duhet të kenë të drejtën e gjysmës së prodhimit.

18. Për sendet e lëna peng nuk duhet të vendoset kamatë. Nëse ata janë në gjendje ta paguajnë vlerën e pengut, atëherë ata duhet ta paguajnë atë. Nëse ata nuk janë në gjendje ta paguajnë menjëherë, do të duhet ta shlyejnë tërësisht gjatë muajit Xhemad'ul-ula të vitit tjetër. Dhe nëse ndokujt i kapërcen koha dhe ai nuk mund të paguajë, ai ka për ta kthyer pa dyshim atë në të mirë të marrëveshjes.

19. Nëse banorët e Thekifit janë borxhlinj, duhet që kreditorit t'i paguhet vetëm vlera fillestare.

20. Nëse ata kanë midis tyre një rob, të cilin pronari i vet e ka shitur, marrëveshja duhet të jetë e rregullt. Nëse nuk është i shitur, shpërblimi për lirimin e tij duhet të jetë gjashtë (6) deve femra, të cilat mund të jepen në dy këste.

21. Vetëm personi që e ka blerë sendin ka të drejtën e shitjes së tij¹⁹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

¹⁹ Ebu Ubeid, Kitab'ul-Emwal, f. 19, 92.

Shënim. Si edhe në ditët e sotme, Taifi ishte një vend pushimi veror për Kurejshët e pasur. Duke qenë pesë mijë këmbë mbi nivelin e detit, klima e tij është e freskët dhe e këndshme. Në të kaluarën ai ishte i mbushur me kopshte dhe prodhonte fruta dhe perime. Qyteti i Taifit është një qendër e madhe tregtie që po zhvillohet dhe modernizohet fuqimisht.

Pavarësisht prej faktit se Kurejshët e dinin se Pejgamberi (s.a.v.s.) ishte jashtëzakonisht fisnik, i drejtë, i ndershëm, bamirës dhe njeri i besueshëm, kur ai deklaroi se ishte Pejgamber i Allahut, ata e trajtuan atë me përçmim, përbuzje dhe urrejtje. Ditë pas dite qëndrimi i tyre bëhej gjithnjë e më tepër armiqësor dhe i hidhur. Kur pati shpresën më të vogël se ata do ta dëgjonin zërin e arsyës, Pejgamberi (s.a.v.s.) shkoi në Taif të predikonte Islamin. Por, fatkeqësisht, banorët e Taifit u treguan se ishin tepër të pashpirtë, të paarsyeshëm dhe mizorë.

Në qytet jetonin vetëm njerëz të pasur dhe me influencë. Pejgamberi shkoi tek tre vëllezër të quajtur Abd 'ullejl, Mas'ud dhe Habib, të cilët i përkisnin fisit Umeir, që ishte prijatari i të gjithë fiseve të tjera, dhe i ftoi ata të pranonin Islamin. Ajo që thanë ata të tre ishte tepër përçmuese dhe poshtëruese. Njëri prej tyre tha: "Nëse Allahu ju ka dërguar juve si Pejgamber, ju jeni duke e grisur mbulesën e Kabes". I dyti tha: "A s'gjeti Allahu ndokënd tjetër për Pejgamber, përveç jush?!" I treti tha: "Unë nuk mund të bisedoj me ju. Në qoftë se ju thoni të vërtetën, do të ishte e pasjellshme të bisedonim me ju. Në qoftë se ju jeni një gënjeshtar, ju nuk e meritoni të bisedoni me ne"²⁰.

²⁰ *Siretu'n-Nebi* nga Shibli Numani, vol. 1, f. 232.

Pasi nuk u kënaqën me një sjellje të tillë fyerse, ata nxitën rrugaçët dhe horrat e Taifit të talleshin dhe të për-qeshnin Pejgamberin (s.a.v.s.). Për t'ia arritur asaj, ata u rreshtuan në të dyja anët e rrugës. Kur Pejgamberi (s.a.v.s.) shkoi asaj rruge, ata hodhën gurë dhe copa shkëmbinjsh mbi të, derisa këpucët e tij u lyen me gjak²¹. Kur, për shkak të goditjeve dhe plagëve, ishin duke e lënë fuqitë, ai u ul, por maskarenjtë e pashpirtë e kapën për krabësh dhe e ngritën lart. Kur ai filloi të ecë përsëri, ata e fyen atë dhe i përflasnin duart e tyre (në shenjë talljeje)²². Më së fundi Pejgamberi mundi të strehohet në një vreshtë.

Në përgjithësi të gjithë të Dërguarit (a.s.) u janë nënshtruar goditjeve dhe fyerjeve të tilla. Disa prej tyre u lutën që Allahu t'i mallkonte mizorët. Mallkimi i Pejgamberit Nuh (a.s.) çoi në përmbytjen e një pjese të madhe të tokës, prej Vërshimit. Por Pejgamberi ishte dërguar për të mirën dhe dobinë e mbarë botës, madje ai as nuk mund ta mendonte një mallkim të tillë. Kur bashkëshoqëruesi i tij i udhëtimit, Zejdi (r.a.), i kërkoi atij që ta luste Allahun për ta mallkuar një popull të tillë kaq mizor, Pejgamberi i pakënaqur tha: "Kurrë! Unë jam dërguar për ta bekuar botën!" Pas kësaj ai u lut: "O Allah! Udhëzoje popullin tim dhe jepi atij aftësinë për të zgjedhur midis të mirës dhe të keqes." Por dhëmbjet morale dhe fizike të cilat ai i pësoi mund të kuptohen lehtë prej përgjigjes që Pejgamberi i dha pyetjes së Aishes (r.a.) se: cila ka qenë dita më e vështirë e jetës së tij? Ai iu referua pikërisht asaj dite në Taif.

²¹ Po aty.

²² Për hollësira mund të shihet tek: "Historia e Taberit" dhe "Ibn Hishamit"

11. Pakti me Ekber bin Abdu'l-Kais-in

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Ekber bin Abdu'l-Kaisit*

1. Allahu dhe Pejgamberi i Tij nuk do t'u kërkojnë llogari atyre të cilët në kohën e injorancës kanë marrë pjesë në ngatërresa dhe trazira dhe kanë bërë mëkate. Por në të ardhmen duhet të jetë obligim i këtyre njerëzve që t'i përmbushin premtimet e veta.

2. Asnjë nuk do të furnizohet prej ushqimeve të tyre dhe as nuk do ta prekë drithin e tyre dhe askush nuk do t'i shqetësojë ata në kohën e pjekjes së frutave.

3. Ata do të gëzojnë të drejtën e përdorimit të ujit të mbledhur prej shirave.

4. Ula bin El Hazarmi (r.a.) do të vazhdojë t'i mbikëqyrë ata në emër të Pejgamberit (s.a.v.s.). Është obligim i popullit të Bahrejnit të bashkëpunojë me të.

5. Ushtria muslimane e ka për detyrë të ndajë me ta plaçkat e luftës të kapura gjatë luftërave fetare dhe të sillen me ata me ndershmëri dhe drejtësi. Në kohën e zbutjes së luftërave fetare

dhe rrugës së mesme të veprimit, duhet të qëndrojnë vëzhgues.

6. Të dy palëve nuk duhet t'u jepet e drejta të bëjnë ndryshime në këtë pakt. Të dy palët as duhet ta ndryshojnë paktin e as duhet të heqin dorë prej tij.

7. Allahu dhe Pejgamberi i tij dëshmojnë për këtë pakt²³.




Pejgamberi
i Allahut
Mubammed

Shënim. Udbëheqësi i Babrejnit, i quajtur Ekber bin Abd'ul-Kais, shkoi me një delegacion të klanit të vet te Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe tha se meqë rruga e tyre ishte e pasigurt, ata nuk ishin në gjendje të vinin tek ai lehtësisht. Prandaj ata kërkuan që atyre t'u mësoheshin çështjet fetare me ndihmën e të cilave të mund të dallonin midis të drejtës dhe të gabuarës, në mënyrë që ata të mund t'i transmetonin ato tek njerëzit e tyre. Pejgamberi (s.a.v.s.) u mësoi atyre rreth Njesisë së Allahut, Pejgamberisë së tij, namazit, zekatit, agjërimit etj. Ai gjithashtu ua dha atyre paktin e mësipërm.

²³ *Tabekat Ibn Sa'd*, vol. 3, f. 33.

PJESA E DYTË:
Letrat drejtuar
perandorëve, mbretërve,
sundimtarëve, mëkëmbsave,
guvernatorëve etj.



Letra e Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.),
dërguar Negusit, mbretit të Etiopisë

1. Letra drejtuar Negusit, mbretit të Etiopisë

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit (s.a.v.s.), Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Negusit, mbretit të Etiopisë.*

Lavdia i takon Allahut, i Cili është Sundimtar i tërë botës dhe përveç të Cilit askush tjetër nuk është i denjë për t'u adhuruar. Ai është i Lartë dhe i Pastër (prej të gjitha dobësive, mungesave, të metave apo gabimeve). Ai është Strehuesi dhe Ushqyesi i të gjithëve.

Unë e pranoj që Isa/Jezusi (a.s.), djali i Merjemes/Marisë, ishte shpirt prej Allahut dhe fjalë e tij (Urdhër), që u fut tek Merjemja, e cila ishte e pastër dhe e paprekshme prej mëkatit. Isa (a.s.) u lind prej Merjemes. Allahu e krijoi atë prej shpirtit dhe frymës së Tij, në të njëjtën mënyrë që krijoi, me dorën e Vet, edhe Ademin (a.s.). Unë ju ftoj t'i besoni Allahut, i Cili është Një i Vetëm dhe nuk ka shok. Besoni tek Ai dhe bashkohuni me mua në bindjen ndaj Tij. Më pasoni mua dhe pranoni pejgamberinë time, sepse unë jam i Dërguar i Allahut. Duke ua përçuar mesazhin e Allahut, unë ju dua të mirën me tërë sinqeritetin tim. Është lartësim për ju të pranoni

këshillat e mia dashamirëse. Përhapeni të njëjtën thirrje edhe tek shtetasit tuaj. Po ju dërgoj kushëririn tim Xhaferin (r.a.) me disa muslimanë të tjerë. Kur ata të mbërrijnë te ju, trajtojini ata me bujari, larg çdo mendjemadhësie dhe krenarie prej sundimtari.

Paqja qoftë mbi atë që ndjek rrugën e drejtë²⁴.

Shënim. Siç e kemi përmendur edhe më parë, pasi Pejgamberi filloi të predikojë Islamin, Kurejshët u bënë armiq të më të ashpër të Islamit. Në fillim ata i përqeshnin, i tallnin dhe i keqtrajtonin muslimanët. Por gradualisht kundërshtimi i tyre mori formën e tiranisë. Sjellja e tyre ndaj muslimanëve, veçanërisht ndaj atyre më të varfërve, ishte aq brutale, sa që ata ndiheshin krejtësisht të pasigurt në Meke dhe i frikësoheshin asgjesimit të tyre nga ana e Kurejshëve. Në këtë kohë (viti i 6-të para Hixhretit, apo më 614 e.s.), Pejgamberi (s.a.v.s.) i lejoi muslimanët të migronin përkohësisht në Etiopi, ku ai shpresonte për një trajtim të mirë nga ana e Mbretit të Etiopisë. Kjo vazhdoi deri në Migrimin e famshëm të Pejgamberit, pas së cilit të migruarit filluan të kthehen në Medine. Karvani i fundit u kthye nga Etiopia në vitin e 7-të Hixhri, - për afërsisht në vitin 629 e.s. Kur karvani i dytë shkoi në Etiopi, Pejgamberi (s.a.v.s.) i adresoi një letër mbretit të Etiopisë.

²⁴ Historia e Taberit, vol 3, fq. 789.

Kurejshët nuk mund ta toleronin faktin se Muslimanët mund të jetonin në paqe, madje edhe në Etiopi. Ata dërguan një delegacion te mbreti Negus dhe i vunë atij në dukje se muslimanët kanë një besim të çuditshëm, i cili është krejtësisht i ri dhe kërkuan prej tij që muslimanët të ktheheshin mbrapa. Mbreti kërkoi prej muslimanëve që ata ta informonin atë rreth besimit të tyre. Me këtë rast Xhaferi (r.a.) mbajti një fjalim tepër mbresëlënës, duke thënë:

"Kemi qenë një popull krejtësisht injorant dhe pagan, që adhuronim idolet që i bënim vetë me duart tona. Shturja, mizoria dhe ngrënia e cofinave ishin mënyra jonë e të jetuarit, por Allahu na dërgoi një peygamber (s.a.v.s.), i cili i ndryshoi jetët tona krejtësisht. Ai na këshilloi të adhurojmë vetëm Allahun dhe ta respektojmë Atë si Pronarin tonë. Ai na predikoi që gjithmonë të jemi të drejtë dhe të mos e shpërdorojmë besimin, të sillemi me fqinjët me dashamirësi, t'i shmangemi gjakderdhjes dhe gjithë asaj që Allahu e ka ndaluar. Të adhurojmë vetëm Allahun, i Cili është Një i Vetëm, të kryejmë agjërimin dhe të paguajmë zekatin. Ky është krimi për të cilin bashkëvendësit tanë na detyruan të lemë tokat dhe shtëpitë tona dhe të kërkojmë strehim në Etiopi".

Mbreti i Etiopisë u prek shpirtërisht së tepërmi prej këtij fjalimi dhe shpalli hapur se ai nuk do të lejonte që këta njerëz kaq të devotshëm të ktheheshin përsëri nën tiraninë e tyre.

Muslimanët, mbas kësaj, gjithmonë kanë pasur një respekt të thellë për Etiopinë dhe kurrë nuk menduan ta sulmojnë këtë vend. Ata pushtuan shtete të mëdha si Irani, por kurrë nuk e prekën shtetin fqinj të Etiopisë.

2. Letra drejtuar Ebu Sufjanit

E mora letrën tuaj. E di që ju gjithmonë keni qenë i zhytur në fodullëk dhe arrogancë kundër Allahut të Madhërishëm. Ju keni përmendur se do të ndërmerri një sulm në Medine, me një ushtri trimash, e cila ka vendosur të prishë të korrat e Medines. Le të jetë e qartë për ju se kjo varret nga vullneti i Allahut! Nëse dëshiron, Ai mund t'iu heqë juve forcën, madje të mos mund të shqiptoni edhe emrat e Latit dhe Uzza-së²⁵. Ju jeni befasuar, keni menduar se unë nuk e njihja metodën e hendeqeve (për mbrojtje). Ju duhet ta dini se kjo metodë më është bërë e njohur prej Allahut, pasi që indinjata dhe zemërimi juaj kishin arritur në një pikë të tillë, sa që ju vendosët ta shkatërroni Medinen.

Ju duhet ta dini sa larg qëndron realizimi i shpresave tuaja të kota; tani ka ardhur koha që Lati, Uzza-ja, Menat-i dhe Nail-i²⁶ të thërrmohen në copa²⁷.

²⁵ Emrat e dy idhujve arabë.

²⁶ Emri i një idhulli arab

²⁷ Dr. Muhammed Hamidullah, El-Wesaik'us-Sijasijje, Kairo, 1941, f. 10

Shënim. Kur muslimanët, për shkak të shtypjes së padurueshme, migruan për në Medine, Kurejshët filluan përgatitjet për pushtetin e Qytetit, me qëllim që muslimanët të mos mund të jetonin në paqe. Në vitin e dytë Hixhri ata vërshuan me një ushtri të fuqishme të përbërë prej një mijë vetash, ndërsa muslimanët numëronin në radhët e tyre vetëm 313 veta. Lufta u zhvillua në Bedër. Kurejshët pësuan humbje të rënda dhe flakën armët. Të gjithë prijësat e tyre të famshëm dhe trima u vranë. Beteja e dytë u zhvillua në Uhud, betejë në të cilën muslimanët e pësuan rëndë, për shkak se ata nuk vepruan në përputhje me urdhërat e Pejgamberit (s.a.v.s.). Lufta, megjithatë, ishte jovendimtare. Në vitin e pestë Hixhri, Kurejshët mblodhën një ushtri të madhe prej 10 mijë vetash, në të cilën morën pjesë gjithashtu edhe çifutët e Hajberit. Këtë herë ata shpresonin se do t'i mposhtnin muslimanët qysh me sulmin e parë. Pejgamberi (s.a.v.s.) hapi bendeqe në veri të Medines dhe kështu u ndërpre vërshimi i Kurejshëve. Ebu Sufjani, i cili ishte tërbuar, i shkroi një letër kërcënuese Pejgamberit (s.a.v.s.), në të cilën ai thoshte se ushtria e tij e madhe mund ta shkatërronte plotësisht Medinen. Letra e mësipërme e Pejgamberit (s.a.v.s.) ishte përgjigja e asaj letre.

Kurejshët e rrethuan Medinen për disa javë, por nuk mundën ta pushtonin atë. Një ditë fryu një erë e fortë dhe e furishme, e cila i shkuli me rrënjë çadrat e Kurejshëve. Devet dhe kuajt vrapuan gjithandej dhe kazanët e tyre fluturuan tutje. Si pasojë Kurejshët u dëshpëruan tepër dhe guximi i tyre u iku tutje. U humbën shpresat për të fituar dhe e braktisën fushë-betejën gjatë natës. Ky ishte sulmi i fundit i Kurejshëve ndaj Medines.

3. Letra e dytë drejtuar mbretit të Etiopisë

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit (s.a.v.s.), Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Negusit, mbretit të Etiopisë*

Paqja qoftë mbi atë që pason udhën e drejtë. Unë adhuroj Allahun, i Cili është i Vetmi që duhet adhuruar. Ai është Zot i gjithë universit. Ai është i Madhërishëm. Vetëm Ai është strehim i paqes dhe sigurisë. Unë dëshmoj se Isa/Jezusi, djali i Merjemes/Marisë, ishte shpirt i Allahut dhe fjalë e Tij, të cilën Ai ia komunikoi Merjemes/Marisë së devotshme dhe kështu ajo u bë nënë e Pejgamberit të Allahut, Isës (a.s.). Allahu e krijoi atë prej shpirtit të Tij dhe e futi atë tek Merjemja, pikërisht ashtu sikurse Ai e krijoi Ademin (a.s.) me dorën e Tij të fuqishme.

Unë ju ftoj të pranoni bindjen, pëlqimin dhe dashurinë e Allahut, i Cili është Një dhe s'ka shok. Ju duhet të më pasoni mua dhe duhet të besoni në mesazhin e Allahut që u kam dërguar.

Unë ju ftoj juve dhe ushtrinë tuaj të adhuroni Allahun, i Cili është i denjë për çdo nder e respekt. Unë e kam plotësuar detyrën time për

përçimin e mesazhit dhe këshillave të Tij. Ju duhet t'i pranoni ato. Paqja qoftë mbi atë që pason rrugën e drejtë²⁸.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Ndërkohë që Negusi vazhdonte të dëgjonte mesazhin e shenjtë, ai filloi të ndikohet prej tij. Kur teksti ishte në mbarim e sipër, ai e puthi letrën me dashuri të jashtëzakonshme dhe e vendosi atë sipër kokës së tij. Ai dërgoi përgjigjen si vijon:

²⁸ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 15.

3/a. Drejtuar Muhammedit, Pejgamberit të Allahut

*Paqja qoftë mbi ju.
Prej As'hama, Negusit*

Paqja qoftë mbi ju, o i Dërguar i Allahut. Bekimi dhe përkrahja e Allahut qoftë mbi ju. Allahu, përveç të Cilit askush tjetër nuk është i denjë për t'u adhuruar, më tregoi mua rrugën e Islamit dhe më udhëzoi:

O Pejgamber i Allahut! Kam pasur nderin ta shoh letrën tuaj të çmuar. Për çdo gjë që ju keni shkruar rreth Isës/Jezusit (a.s.), unë betohem për Allahun, Zotin e tokës dhe të qiejve, që Isa (a.s.) nuk është asgjë më tepër se kaq. Unë i kam kuptuar mirë të gjitha çështjet që ju m'i keni përcjellë mua. Kushëriri juaj dhe shokët e tij janë miqtë e mi më të afërt.

Unë dëshmoj hapur se ju jeni Pejgamber i vërtetë i Allahut. Unë jam betuar (bai'at), betim për besnikëri ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij, në dorën e kushëririt tuaj, për hir të Allahut dhe jam bërë rob i Islamit. O Pejgamber i Allahut! Unë po dërgoj djalin tim Arha tek ju. Nëse ju do të urdhëronit, unë do të paraqitesha vetë tek ju. Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ju²⁹.

²⁹ Histrìa e Taberit, vol.3, fq.89.

4. Letra e tretë drejtuar mbretit të Etiopisë

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Paqja qoftë mbi ju. Ju na trajtuat neve mjaft mirë. Ne kemi besim të plotë tek ju. Çështja, që ne shpresuam prej jush, është realizuar dhe jemi shëndoshë e mirë prej çështjes së cilës i frikësoheshim. Nuk ka forcë tjetër (për të vepruar) përveç Allahut.³⁰



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Qëllimi kryesor i dërgimit të letrës ishte t'u bëhej thirrje të migruarve për t'u kthyer në Medine. Negusi ishte njoftuar se duhej t'i mbante Letrat në një kuti të fildishtë dhe se për sa kohë letrat ishin atje, populli i Etiopisë do të ishte i sigurt dhe i qetë.

³⁰ Tabekat Ibn Sa'd, vol 3. fq. 16.

5. Letra drejtuar Herakli Çezarit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, që është rob i Allahut dhe i
Dërguar i Tij, drejtuar Herakli Çezarit.*

Paqja qoftë mbi atë që pason rrugën e drejtë. Unë ju ftoj të pranoni Islamin. Nëse dëshironi siguri, pranoni Islamin. Nëse pranoni Islamin, Allahu do t'iu shpërblejë juve dyfish, nëse refuzoni të veproni kështu, përgjegjësia për gabimet e të gjithë atyre që janë nën sundimin tënd do të jetë juaja.

O pasues të Librit! Lini mënjanë të gjitha mosmarrëveshjet dhe polemikat dhe pajtohuni në një çështje, e cila është e njëjtë dhe e pakundërshtueshme për të dy palët dhe që na përket edhe neve edhe juve dhe kjo është se nuk duhet të adhurojmë askënd tjetër përveç Allahut dhe as të nderojmë ndokënd tjetër përveç Tij, si Mbështetësin tonë.

Nëse ju e mohoni këtë, duhet ta dini që, në çdo rrethanë, ne besojmë në Një të Vetmin Allah³¹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

³¹ Sahih'ul- Buhari. vol 1 fq. 5. Delhi, Asahul Matabe

Shënim. Ashtu sikurse në kohën e sotme, janë dy shtete tepër të fuqishme, të cilat e quajnë veten superfuqi, edhe në kohën e Pejgamberit (s.a.v.s.) ekzistonin dy shtete tepër të fuqishme: një ishte Irani dhe tjetri Roma, Bizanti apo Kostandinopoli. I pari ishte shteti më i rëndësishëm i Azisë dhe djepi i një civilizimi të shquar. Ai gjendej në lindje të Arabisë. Në veriperëndim ishte Perandoria Romake. Të dy shtetet ishin në kufi të njëri-tjetrit. Roma tani është kryeqytet i Italisë. Arabët e thërrisnin Bizantin me emrin e Romës.

Disa vjet më parë se të shkruhej kjo letër, Irani e kishte sulmuar Sirinë dhe Romakët kishin pësuar disfatë. Kjo është përmendur edhe në Kur'an. Romakët, me qëllim që të hakmerreshin, bënë përgatitje të mëdha dhe e mundën Iranin. Megjithëse Irani në atë kohë ishte tepër i fuqishëm dhe Romakët dukeshin se kishin rastin e një fitore kundër tyre, Kur'ani paralajmëroi një fitore të plotë për Romakët. Herakliu shkoi në Jerusalem në shenjë mirënjohjeje. U gjend pikërisht aty kur mori letrën e Pejgamberit (s.a.v.s.). Ai urdhëroi që dikush nga Arabia duhej të paraqitej para tij. Rastësisht Ebu Sufjani ishte duke qëndruar në Gaza me mallrat e tij. I dërguari i Çezarit e solli atë prej Gazës. Çezari zotëronte një oborr të madh mbretëror. Ai kishte vënë një kurore mbretërore dhe ishte ulur në fronin e tij. Duke iu drejtuar arabëve, ai i pyeti se kush prej tyre ishte më i afërt me personin, i cili e quante veten Pejgamber. Ebu Sufjani tha se ai kishte lidhje familjare me Pejgamberin (s.a.v.s.). Më pas midis tyre u zhvillua dialogu që vijon:

Çezari: Çfarë familjeje i përket ai që pretendon se është Pejgamber?

Ebu Sufjani: Është familje fisnike.

Çezari: A ka pretenduar edhe ndokush tjetër prej familjes së tij se është Pejgamber?

Ebu Sufjani: Jo.

Çezari: A ka ndodhur që ndonjë prej familjes së tij të ketë qenë mbret?

Ebu Sufjani: Jo.

Çezari: Ata që e kanë pranuar fenë e tij, a janë të varfër apo me influencë?

Ebu Sufjani: Ata janë njerëz të varfër.

Çezari: Numri i pasuesve të tij a është duke u rritur apo duke u pakësuar?

Ebu Sufjani: Ata janë duke u shtuar.

Çezari: A ka ndodhur ndonjëherë që ai të mos thotë të vërtetën?

Ebu Sufjani: Jo.

Çezari: A e ka thyer ai ndonjëherë premtimin apo marrëveshjen?

Ebu Sufjani: Ai kurrë nuk e ka bërë këtë. Por do ta shohim nëse ai do t'i përmbahet paktit të ri të paqes që e kemi përfunduar.

Çezari: A keni luftuar ndonjëherë kundër tij?

Ebu Sufjani: Po

Çezari: Cili ka qenë rezultati i luftës?

Ebu Sufjani: Disa herë kemi fituar ne, e disa herë ka qenë ai fitimtar.

Çezari: Çfarë predikon ai?

Ebu Sufjani: Ai thotë: "Adhuroni vetëm një Zot – Allahun. Mos i shoqëroni asgjë tjetër Allahut. Kryeni namazin. Jeni të devotshëm. Thuani të vërtetën. Trajtoni të afërmit me dashamirësi".

Pas këtij dialogu Çezari vuri në dukje se Pejgamberët gjithmonë u përkasin familjeve fisnike. Përveç kësaj, ai tha se përderisa askush tjetër prej familjes së Pejgamberit (s.a.v.s) nuk ka pretenduar ndonjëherë për Pejgamberi, kjo tregon qartë se nuk ka asnjë ndikim të trashëguar që të shkaktonte pretendimin e tij për Pejgamber. Po ashtu mungesa e ndonjë mbreti në familjen e tij provon se Pejgamberi nuk është i nxitur prej dëshirës për të mbretëruar. Nëse ai nuk ka gënjyer ndonjëherë, është vështirë të shpresosh se ai mund të gënjejë për Allahun. Më tej Çezari vërejti se pasuesit e Pejgamberëve në fillim janë të varfërit dhe se feja e vërtetë vazhdon të përhapet. Gjithashtu Pejgamberët asnjëherë nuk mashtrojnë askënd. Përderisa ai predikon devotshmëri, pastërti dhe adhurimin e Një Allahu të Vetëm, ai një ditë do të jetë zot i vendit, që ai (Çezari) ishte duke e zotëruar. Pas kësaj Çezari urdhëroi të lexohet letra e Pejgamberit (s.a.v.s.).

Dialogu i Çezarit me Ebu Sufjanin i zemëroi tepër oborrtarët. Prandaj Çezari i largoi arabët prej oborrit mbretëror. Sidoqoftë, dashuria për kuroren dhe fronin mbretëror, si dhe kundërshtimi i oborrtarëve nuk e lejuan Çezarin të pranonte Islamin. Por pyetjet e tij të hollësishtme dhe biseda e tij tregojnë qartë se ai u bind për vërtetësinë e Islamit, pasi ai gjykoj saktësisht se nëse një

person i cili s'ka gënjyer kurrë në jetën e tij e ka të vështirë të thotë diçka të pavërtetë rreth Allahut. Ai ishte gjithashtu i sigurt se pasuria materiale, shkëlqimi dhe pushteti nuk janë qëllime dhe synime të Pejgamberit (s.a.v.s.), por misioni i tij ishte komunikimi i mesazhit Islam mbarë botës.

Kur Çezari ishte gati të kthehej në Konstandinopojë, ai përsëri i këshilloi oborrtarët e tij të pasonin Pejgamberin (s.a.v.s.) pasi ishte ai, të cilin, ata ishin duke e pritur. Ai përveç kësaj përmendi faktin se në librat e tyre gjendej përsëkrimi i Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe ato hapur dhe qartë tregonin se ai ishte Pejgamberi i vërtetë i Allahut. Si rrjedhim, ishte në interesin e atyre vetë që të pasonin udhëzimin e Pejgamberit (s.a.v.s.). Por oborrtarët thanë se duhej të kibej parasysh edhe pëlqimi i tyre për të dërguarin arab, pasi mbretëria e tyre ishte mbretëria më e madhe e botës dhe kombi i tyre ishte kombi më i shquar i botës. Çezari tha se nëse ata nuk ishin të përgatitur të pranonin Islamin, atëherë ata shumë shpejt do të mposhteshin prej arabëve. Ai ishte shumë i inatosur prej qëndrimit arrogant të oborrtarëve dhe menjëherë e la Sirinë. Ndërsa ishte duke u larguar ai e vështroi territorin e Sirisë dhe tha se ai ishte duke e lënë Sirinë përgjithmonë. Dhe vërtetë, kështu ngjau, ai nuk u kthye më kurrë në Siri³².

³² Sahih 'ul-Buhari, vol. 1, fq. 5, Printed Delhi.



Letra e Pejgamberit, Muhammedit (s.a.v.s.),
dërguar Husro Perwezit, Perandorit (Kisra) të Iranit

6. Letra drejtuar Husro Perwezit, Perandorit të Farsit (Persisë)

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Kisrasë, mbretit të Farsit (Persisë)*

Paqja qoftë mbi atë që pason udhëzimin, beson tek Allahu dhe Pejgamberi i Tij. Unë dëshmoj se askush s'është i denjë për t'u adhuruar, përveç Allahut, i cili është Një i Vetëm dhe s'ka shok, dhe se Muhammedi është rob dhe Pejgamber i Tij. Allahu më ka zgjedhur mua Pejgamber dhe më ka dërguar për mbarë botën, me qëllim që unë të mund të fus bindjen ndaj Allahut, tek çdo njeri. Prano Islamin dhe do të jesh i sigurt. Nëse ju refuzoni, mëkatet e të gjithë Zoroastrianëve do të jenë në përgjegjësinë tuaj³³.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Goditja që mori krenaria e tij false dhe zemërimi i tij, prej një mënyre të tillë të drejtuari, janë përmendur më detajisht edhe dikund tjetër.

³³ Historia e Taberit, vol. 3, fq. 90 dhe Sahih'ul- Buhari.

7. Letra drejtuar Hurmuzit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhamedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Hurmuzit*

Unë ju ftoj ju në Islam. Pranoni Islamin me qëllim që të jeni të shpëtuar në këtë botë dhe në botën tjetër³⁴.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

Shënim. Ndërkohë që Pejgamberi ishte duke i adresuar letrën Husro Pervezit, ai i dërgoi gjithashtu një letër Hurmuzit, i cili i përkiste familjes mbretërore dhe ishte daja i Sherojes. Megjithëse në këtë kohë ai nuk i kushtoi vëmendje Letrës, më vonë ai e përqafoi Islamin.

³⁴ Risalet en-Nebewijje, vol. II, fq. 313.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ مِنَ مُحَمَّدٍ عَبْدِ اللَّهِ وَرَسُولِهِ
 سَوَّلَ إِلَى الْمُتَّقِينَ تَطْمِينًا لِقُلُوبِهِمْ وَأَمْرًا غَلِيظًا
 مِنْ أَنْ يَشْبَعَ الْعَرَبُ مِنْ دِيَارِهَا بِعَثْرِ فَنِي
 إِذْ عَوَّزْتُ بِعَسَائِيهِ الْإِسْلَامَ اسْتَلِمَ
 نَبِيَّكُمْ يَوْمَ الْكَلْبِ إِنَّهُ جَرَدٌ مَرْتِينٌ
 فَإِنْ تَوَلَّيْتُمْ فَلْيَكِلْتُمْ أَشْرَافَ الْقَبِيْلِطِ
 يَا حَسْرَةَ الْكِلْبِ تَبِعْتُمُ الْوَالِيَّ كَلْبَ تَبِعْتُمْ
 سَوَاءٌ بَيْنَنَا وَسَيِّئِكُمْ أَنْ لَا نَعْتَبَهُ إِلَّا أَنَّهُ
 وَلَا تَشْرِكْ بِرَبِّ شَيْئًا وَلَا تَتَّخِذْ مِنْ بَعْضِنَا
 بَعْضًا أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنَّكَ تَفْتَنُونَ
 تَوَلَّوْا فَرَقْتُمْ لَوْلَا إِشْرَاقُهَا بِأَبْرَارِهَا
 آمَنُونَ
 اللَّهُ
 رَسُوْلُهُ
 مُحَمَّدٌ

سَمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ مِنَ مُحَمَّدٍ عَبْدِ اللَّهِ وَرَسُولِهِ
 سَوَّلَ إِلَى الْمُتَّقِينَ تَطْمِينًا لِقُلُوبِهِمْ وَأَمْرًا غَلِيظًا
 مِنْ أَنْ يَشْبَعَ الْعَرَبُ مِنْ دِيَارِهَا بِعَثْرِ فَنِي
 إِذْ عَوَّزْتُ بِعَسَائِيهِ الْإِسْلَامَ اسْتَلِمَ
 نَبِيَّكُمْ يَوْمَ الْكَلْبِ إِنَّهُ جَرَدٌ مَرْتِينٌ
 فَإِنْ تَوَلَّيْتُمْ فَلْيَكِلْتُمْ أَشْرَافَ الْقَبِيْلِطِ
 يَا حَسْرَةَ الْكِلْبِ تَبِعْتُمُ الْوَالِيَّ كَلْبَ تَبِعْتُمْ
 سَوَاءٌ بَيْنَنَا وَسَيِّئِكُمْ أَنْ لَا نَعْتَبَهُ إِلَّا أَنَّهُ
 وَلَا تَشْرِكْ بِرَبِّ شَيْئًا وَلَا تَتَّخِذْ مِنْ بَعْضِنَا
 بَعْضًا أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنَّكَ تَفْتَنُونَ
 تَوَلَّوْا فَرَقْتُمْ لَوْلَا إِشْرَاقُهَا بِأَبْرَارِهَا
 آمَنُونَ



Letra e Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.),
 dërguar Mukaukisit, mëkëmbësit të Egjiptit

8. Letra drejtuar mäkëmbësit të Egjiptit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, robit të Allahut dhe Pejgamber i Tij,
drejtuar Mukaukisit, mäkëmbësit të Egjiptit*

Paqja qoftë mbi atë që pason rrugën e drejtë. Këndej e tutje, unë ju ftoj që ta pranoni Islamin. Nëse doni siguri, pranoni Islamin. Nëse ju e pranoni Islamin, Allahu i Madhërishëm do t'ju shpërblejë juve dyfish. Por nëse ju refuzoni ta bëni këtë, përgjegjësia për shkeljet e të gjithë atyre që janë nën sundimin tënd, do të bjerë mbi ju.

O ithtarë të Librit! Lini mënjanë të gjitha mosmarrëveshjet e polemikat dhe pajtohuni në një çështje, e cila është e njëjtë edhe për ne edhe për ju, dhe kjo është se nuk duhet të adhurojmë askënd tjetër përveç Allahut, se nuk duhet t'ia shoqërojmë askënd Atij dhe se nuk duhet të marrim ndokënd tjetër për Zot. Nëse ju e refuzoni këtë, duhet ta dini se ne, në çdo rrethanë, besojmë në Njëshmërinë e Allahut³⁵.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

³⁵ Zadu'l Me'ad, vol. 3, f. 61.

Shënim. Mukaukisi ishte emëruar si mëkëmbës i Egjiptit prej Perandorisë Romane. Ai ishte një njohës i mirë i fesë së vet. Egjipti gjithmonë kishte qenë një qendër e madhe e civilizimit dhe kishte bërë përparime të fuqishme në degë të ndryshme të artit dhe të astrologjisë. Ai gjithashtu ishte një ballkë lidhëse tregtare midis Lindjes dhe Perëndimit. Por sikurse Irani edhe Egjipti gjithashtu ishte zhytur në një korrupsion moral.

Mukaukisi u prek tepër prej sinjeritetit të Letrës dhe vuri në dukje se ishte koha që Pejgamberi i pritur të shfaqej, por ai kishte pasur përshtypjen se ai duhet të ish lindur në Siri. Më tej ai vërejti se prej Torës dhe Biblës, kishte arritur të mësonte se Pejgamberi nuk pranonte lëmoshë, por pranonte dhuratat dhe se të varfërit dhe të vobektit do të ishin pasuesit e tij. Ai urdhëroi që Letra të vendosej në një kuti fildishi dhe të ruhej e sigurt në thesarin qeveritar. Ai i dërgoi Pejgamberit (s.a.v.s.), përgjigjen që vijon:

8/a. Drejtuar Muhammedit, djalit të Abdullahut

Prej Mukaukisit

“Unë e lexova letrën tuaj dhe e kuptova atë që kishit shkruar. Unë e di se pritet ende ardhja e një Pejgamberi. Por unë mendoja se ai duhej të kishte lindur në Siri. Unë e kam trajtuar të dërguarin tuaj me respekt dhe nderim. Po ju dërgoj dy shërbëtore si dhuratë. Këto vajza i përkasin një familjeje shumë të nderuar prej nesh. Përveç këtyre, po ju dërgoj rroba dhe një kalë për udhëtim. Allahu ju ruajtë”.³⁶

Shënim. Çezari nuk mundi të përfitojë prej dritës Islame. Pushteti dhe epshtet e tërboqën atë mbrapa prej shpëtimit të vetvetes përmes dritës Islame. Dhuratat që dërgoi Mukaukisi u pranuan prej Pejgamberit (s.a.v.s.).

Letra e cila ishte vendosur në kutinë e fildishtë prej Mukaukisit, e gjeti rrugën e vet në një manastir kristian të Abimit në Egjipt. Atje një oshënar e kishte ngjitur atë në Biblën e vet. Letra ishte shkruar në një pergamen. Prej atje një orientalist francez e mori dhe ia shiti atë Sultan Abdul Mexhid Hanit të Turqisë, për një shpërblim prej 300 stërlinash.

³⁶ Tabekat Ibn Sa'd, vol.3, f.17.

Sulltani e kishte ruajtur atë në thesarin e pallatit mbretëror, se bashku me relikte të tjera të shenjta.

Studiuesit muslimanë kanë pohuar se Letra është shkruar prej as'habit të njohur dhe të shquar, Ebu Bekër Es-Siddik (r.a.).

Mukaukisi, sikurse Çezari, ka pasur gjithashtu një dialog me Mugire ibn Shu'be, një as'hab i njohur i Pejgamberit (s.a.v.s.). Mugira (r.a.) tregon: "Njëherë shkova tek oborri mbretëror i Mukaukisit, i cili më pyeti mua rreth familjes së Pejgamberit (s.a.v.s.). Unë e njoftova atë se ai i përket një familjeje të ndershme dhe fisnike. Mukaukisi vuri në dukje se Pejgamberët gjithmonë u përkasin familjeve fisnike. Pastaj ai më pyeti nëse ka pasur ndonjë rast që Pejgamberi (s.a.v.s.) të mos e ketë thënë të vërtetën? Unë i thashë se ai gjithmonë flet të vërtetën. Për këtë arsye, pa marrë parasysh kundërshtimin tonë ndaj tij, ne e quajmë atë Emin (i besueshëm). Mukaukisi vërejti se një njeri që nuk gënjen njerëzit, si mund të thotë gënjeshtër për Allahun? Pastaj ai më pyeti se çfarë lloj njerëzish ishin pasuesit e tij dhe se çfarë mendonin çifutët për të? Unë iu përgjigja se pasuesit e tij ishin më të varfërit, ndërsa çifutët ishin armiqtë e tij më të egër. Mukaukisi tha se pasuesit e Pejgamberëve në fillim janë zakonisht të varfërit dhe se ai dubet të jetë Pejgamber i Allahut. Ai më tutje vërejti se çifutët e kundërshtojnë atë për shkak të smirës dhe xhelozisë, përndryshe ata dubet të kishin qenë të sigurt në vërtetësinë e tij, pasi edhe ata gjithashtu ishin në pritje të një Pejgamberi. Mesia (a.s.) gjithashtu ka predikuar se pasimi dhe nënshtrimi ndaj Pejgamberit (s.a.v.s.) është i domosdoshëm dhe se çfarëdo cilësish të tij, që ka përmendur ai, të njëjtat cilësi i kanë përmendur edhe Pejgamberët e mëparshëm.

Mugire (r.a.) u impresionua tepër nga dialogu. Gjatë kthimit të tij prej Egjiptit, atij i qëllloi të takonte një kristian të dijshtëm, të cilin e pyeti nëse ishte në pritje të një Pejgamberi dhe, nëse ishte kështu, çfarë cilësish ishin thënë për të tek Tora dhe tek Bibla? I krishteri i devotshëm e njoftoi atë me hollësi se vërtet ata ishin në pritje të një Pejgamberi, i cili dubej të ishte Pejgamberi i fundit. Mesia (a.s.) u ka predikuar atyre se kur të shfaqej ky Pejgamber ata do të dubej ta pasonin atë. Ai, për më tepër, ka thënë se ky Pejgamber do të jetë analfabet, do jetë arab, emri i tij do të jetë Ahmed dhe tiparet dhe karakteristikat e tij do të ishin si më poshtë:

"Shtati me lartësi mesatare, sy të mëdhenj, ngjyra e tij e fytyrës do të jetë e kuqe në të bardhë. Ai do të përdorë rroba të thjeshta dhe ushqim të zakonshëm. Ai nuk do të frikësohet prej të fuqishmëve, kushdo që do të luftojë kundër tij, ai do të mund t'i bëjë ballë. Shokët e tij janë të gatshtëm që vetëm me shenjën e tij më të vogël, të japin jetën e tyre dhe e konsiderojnë atë më të dashurin prej fëmijëve, nënave, baballarëve dhe vëllezërve të tyre. Prej një vendi ai do të shkojë në një vend tjetër, i cili do jetë shkëmbor dhe ku palmat e burmave rriten me bollëk. Besimi i tij do të jetë ai i Ibrahimit (a.s.)! Ai nuk e pranon rrugën e shtrembër, Pejgamberia e tij do të jetë për të gjithë. E tërë toka do të përfshihet në lutjen e tij³⁷.

Mugira u prek aq tepër shpirtërisht prej bisedave, sa që shkoi tek Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe pranoi Islamin.³⁸

³⁷ Sujuti, Hasan'ul-Muhazira, fq.50 -51.

³⁸ Sujuti, Hasan'ul-Muhazira, fq. 50 -51.

9. Letra drejtuar Huza'a bin Ali, guvernatorit të Jemenit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Huza'a bin Ali*

Paqja qoftë mbi atë që pason rrugën e drejtë. Është e qartë se besimi im do të arrijë kufijtë e të gjithë Arabisë dhe të Iranit dhe do të triumfojë. Prandaj ju duhet ta pranoni Islamin. Në të qëndron siguria.

Nuk kam për të ndërmarë asgjë kundër vendit tuaj. Ai, si edhe më parë, do të mbetet nën juridiksionin tuaj.³⁹



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

³⁹ Mawahib Luddunnijje, e cituar prej Risalet 'un- Nebevijje. fq. 314,

9/a. Përgjigja e guvernatorit të Jemenit

“Besimi, në të cilin ju po më ftoni, është shumë i drejtë. Unë jam një orator dhe poet i famshëm. Prandaj arabët më respektojnë së tepërmi mua. Nëse ju më përfshini mua në qeverinë tuaj, unë jam i gatshëm t'u pasoj juve”.⁴⁰

Shënim. Pejgamberi nuk e pranoi kërkesën e Huza'a-s. Ai zakonisht i refuzonte kërkesat e tilla të prera dhe thoshte se çështja ishte në dorë të Allahut, i cili ia jepte tokën e Tij atij që Ai dëshironte.

Një kristian i dijsbëm e këshilloi Huza'a-n ta pranonte Islamin dhe i tha atij se Pejgamberi Arab (s.a.v.s.) nuk do ta privonte atë prej vendit të vet. Ai e njoftoi atë se Isa/Jezusi (a.s.) ka dhënë lajme të mira në Bibël, për një Pejgamber që dubet të vijë. Huza'a, megjithatë, nuk mundi ta mposhtë frikën e humbjes së vendit të tij dhe nuk e pranoi Islamin.

⁴⁰ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 18.

10. Letra drejtuar Haris Gassanit, mbretit të Damaskut

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Haris Bin Ebi Shimr*

Paqja qoftë mbi atë që pason rrugën e drejtë,
beson në të dhe e konsideron atë të vërtetë.

Unë ju ftoj të besoni në Një Allah të Vetëm, i
Cili nuk ka shok. Vendi juaj do të mbetet me ju⁴¹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁴¹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq.17.

Shënim. Harisi, mbreti i Sirisë, i përkiste familjes Gassani nga Arabia, që ishte vendosur në Siri në fund të shekullit të 2-të e.s. dhe që gradualisht kishte vendosur sundimin e vet në tërë vendin. Shuxhanë (r.a.), që kishte pasur nderin ta çonte letrën tek Harisi, i qëllloi të takojë Murin, një oborrtar të mbretit. Muri e pyeti Shuxhanë rreth Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe u prek shpirtërisht tepër kur dëgjoi për Pejgamberin. Ai vuri në dukje se pikërisht të njëjtat njoftime për Pejgamberin (s.a.v.s.) gjendeshin edhe në Bibël. Si rrjedhim, ai e pranoi Islamin, por e paralajmëroi Shuja-n të mos ia përmendte askujt faktin e pranimit të Islamit nga ana e tij.

Muri ia përmendi Mbretit Shuja-n, i cili e ftoi atë në oborrin e tij mbretëror dhe lexoi letrën. Ai u egërsua tepër pas leximit të letrës dhe tha: "Kush guxon madje të shohë në drejtim të vendit tim?". Ai urdhëroi ushtrinë e tij të bëjë përgatitjet. Në përgjigjen e tij. Harisi dha një raport të takimit të tij, drejtuar Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili tha: "Me arrogancën e tij prej mbreti ai refuzoi të pranojë Islamin, por sundimit të tij do të vijë fundi". Nën udhëheqjen e Çezarit Harisi filloi të luftojë kundër Islamit, menjëherë pas fitores së Mekes, por, më në fund, sundimi i Gasanitëve u fshi prej Sirisë në vitin e 14-të Hixhri apo 625 e.s.

11. Letra drejtuar Mundhir bin Sawa, guvernatorit të Bahreinit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Mundhir bin Sawasë*

Paqja qoftë mbi ju! Unë madhëroj Allahun, i Cili është Një dhe s'ka tjetër të adhuruar përveç Tij. Unë dëshmoj se Allahu është Një dhe se unë jam rob i Allahut dhe Pejgamber i Tij.

Këtej e tutje ju ftoj të adhuroni vetëm Allahun. Kushdo që e pranon këshillën e bën atë për të mirën e vet.

Kushdo që pason të dërguarit e mi dhe vep-ron në përputhje me udhëzimet e tyre, ai në fakt ka pranuar këshillën time.

Të dërguarit e mi e kanë lavdëruar tepër sjelljen tuaj. Ju do të vazhdoni detyrën tuaj të tashme. Duhet të keni besim të plotë tek Allahu dhe Pejgamberi i Tij.

Unë e pranova rekomandimin tuaj në lidhje me banorët e Bahreinit. Unë ua fala fajin fajtorëve. Prandaj edhe ju duhet gjithashtu t'i falni ata.

Banorët e Bahrejnit, që dëshirojnë t'i përmbahen besimit të tyre çifut apo Mexhus, janë të obliguar të paguajnë xhizjen⁴².



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Letra e mësipërme u shkrua si përgjigje e letrës së mëposhtme të Mundbir Bin Sawa:

⁴² Zadu 'l Me'ad, vol. 3, fq. 61- 62; Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3.

11/a. Letra nga Mundhir bin Sawa

“O Pejgamberi i Allahut! E mora urdhërin tuaj. Para se ta merrja atë unë gjithashtu kisha parë letrën, që ju ua kishit shkruar banorëve të Bahrejnit, duke i thirrur ata në Islam. Unë e pranova Islamin me dëshirën time.

Disa banorë të Bahreinit e pëlqyen Islamin dhe hynë në Islam, ndërsa të tjerët vazhduan besimin e tyre të vjetër. Në vendin tim banojnë zoroastrianë dhe çifutë. Ju duhet të më informoni mua për mënyrën se si duhet t’i trajtoj ata”.⁴³

Duhet përmendur këtu se Bahreini ishte nën juridik-sionin e Iranit në shekullin e 6-të e.s. Mundhir bin Sawa ishte guvernatori iranian i Bahrejnit. Ky i fundit e mori mesazhin Islam dhe e pranoi atë.

⁴³ Tabekat Ibn Sa’d, vol. 3, fq. 28.

12. Letra e dytë drejtuar Mundhirit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Paqja qoftë mbi ju! Po ju dërgoj Ebu Hurejren dhe Kudame (r.a.). Ju duhet t'u dorëzoni atyre sasinë e ushrit, zekatit dhe xhizjes që keni mbledhur në territorin tuaj⁴⁴.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁴⁴ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 19.

13. Letra drejtuar Xhaferit dhe 'Abdit, sundimtarëve të Omanit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Xhaferit dhe 'Abdit*

Paqja qoftë mbi atë që pason rrugën e drejtë. Këtej e tutje ju ftoj juve të dyve në Islam. Përqa-foni Islamin. Në të qëndron siguria. Allahu më ka dërguar mua si Pejgamber për krijesat e Tij, me qëllim që të mbjell frikën ndaj Allahut tek krijesat e pabindura ndaj Tij dhe kështu të mos ketë më justifikim për ata që e mohojnë Allahun.

Pejgamberia ime është gati duke mbërritur në vendin tuaj. Nëse ju të dy pranoni Islamin, vendi juaj, si zakonisht, do të mbesë me ju. Por nëse ju refuzoni apo kundërshtoni, kjo është një çështje që zgjidhet shpejt⁴⁵.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁴⁵ *Mewabibu'l-ludunniyye*, vëll. 1, fq. 294, cituar prej *El-Weaik'us-Sijasijje*, fq. 62.

Shënim. Xhaferi dhe 'Abdi e pranuan Islamin pas një ngurrimi të vogël dhe thanë se Pejgamberi (s.a.v.s.) duhet të veprojë vetë, para se të urdhërojë të tjerët të veprojnë dhe para se t'u ndalojë të tjerëve diçka, duhet të përmbahet vetë prej saj. Ata më tej vërejtën se nëse arrin fitore, ai nuk duhet të mburret me të mposhturit, ai nuk duhet t'i mënjanojë nga objektiviteti i tij. Ata më tej thanë se Pejgamberi gjithmonë i përmbush premtimet. Ata dëshmuuan se ai ishte Pejgamber i Allahut⁴⁶.

⁴⁶ Balag 'ul-Mubin, fq. 184.

14. Letra drejtuar trashëgimtarit të As'hama Negusit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Negusit, mbretit të Etiopisë*

Paqja qoftë mbi ju prej momentit që t'i besoni Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.).

Unë dëshmoj se askush tjetër nuk duhet të adhurohet përveç Allahut. Askush nuk është shok apo partner i tij. Ai nuk është i nevojshëm për grua apo për fëmijë. Unë dëshmoj se jam rob dhe i Dërguar i Tij.

Unë ju ftoj juve të besoni tek Allahu, i Cili është vetëm Një. Nëse dëshironi siguri pranoni Islamin.

O ithtarë të Librit! Lini mënjanë të gjitha mosmarrëveshjet dhe polemikat dhe pajtohuni në një çështje, së cilës edhe ju edhe ne i besojmë njëllë, dhe kjo është se ne nuk duhet të adhurojmë askënd tjetër përveç Allahut. Dhe Atij nuk duhet t'i shoqërojmë askënd tjetër dhe as duhet të nderojmë ndokënd tjetër përveç Krijuesit tonë. Nëse ata e kundërshtojnë këtë,

thua ju atyre: "Ju do të dëshmoni se ne i besojmë Allahut"⁴⁷.

Nëse ju nuk e pranoni këtë, përgjegjësia për shkeljet e të krishterëve tuaj do të jetë e juaja⁴⁸.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

Negusi nuk e pranoi Islamin. Ai gjithashtu nuk i ktheu përgjigje kësaj letre.

⁴⁷ Ajeti 64, i cili i referohet sures: "Ali Imran" të Kur'anit, u adresohet çifutëve dhe të krishterëve.

⁴⁸ Risalet 'un-Nebevijje, fq.291.

15. Letra drejtuar mbretërve të Himjarit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Harisit etj*

Paqja qoftë mbi ju, prej momentit që t'i besoni Allahut dhe Pejgamberit të Tij.

Pa dyshim Allahu është Ai, i Cili është Një i Vetëm dhe i Cili nuk ka shok. Ai dërgoi Musën/Moisiun (a.s.) me mrekulli dhe e krijoi Isën/Jezusin (a.s.) me fjalën e Tij. Por çifutët thonë se: "Uzejri është djalë i Allahut" ndërsa të krishterët thonë se: "Isa (a.s.) është bir i Allahut dhe se është pjesë përbërëse e Trinisë së Shenjtë"⁴⁹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁴⁹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 32.

Shënim. Mbretërit e Himjarit pas dëgjimit të letrës e pranuan Islamin me kënaqësi dhe dërguan një delegacion tek Pejgamberi (s.a.v.s.) për t'i njoftuar atij lajmin e pranimit të Islamit nga ana e tyre. Dinastia Himjar sundonte pjesën jugore të Jemenit në kohën e Pejgamberit (s.a.v.s.). Jemeni në atë kohë përfshinte pjesën jugperëndimore të Arabisë dhe Sipërfaqja e tij ishte mbi 127 mijë kilometra katrorë. Të dy vëllezërit, të cilëve Pejgamberi (s.a.v.s.) ua adresoi letrën, sundonin mbi kracinën e Jemenit.

16. Letra e dytë drejtuar mbretërve të Himjarit

Pejgamberi (s.a.v.s.) shpreh ndjenjën e gëzimit të tij të thellë për pranimin e Islamit nga ana e mbretërve të Himjarit dhe iu komunikon atyre urdhërat rreht zekatit dhe xhizjes në letrën që vijon më poshtë:

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
dërguar mbretërve të Himjarit*

Paqja qoftë mbi ju! Unë adhuroj Allahun, përveç të Cilit askush tjetër nuk duhet adhuruar.

Të dërguarit e tu mbërritën këtu në kohën që unë u ktheva prej Romës (Bizantit). Ata më sollën mesazhin tuaj, më treguan hollësisht luftën tuaj kundër të pafeve dhe kushtet që ekzistojnë atje. Allahu ju ka nderuar juve me udhëzimin e Tij. Ju duhet t'i bindeni Allahut dhe Pejgamberi i Tij obligohet ndaj jush.

Përmbajuni namazit, paguani zekatin dhe një e pesta e përfitimeve të arritura në luftërat fetare i takojnë Allahut dhe Pejgamberit të Tij.

Allahu ka caktuar pagesën e bamirësisë për pasurinë tokësore dhe kjo është *Ushri* (një e dhjeta e

prodhimit për vendet e ujitura prej shiut, ndërsa për vendet e ujitura me kanale vaditëse dhe në rastet e tjera të tokave të vaditura, tatimi është gjysma e ushrit (një e njëzeta). Zekati për 40 deve është një deve femër, për 30 deve është një deve e re, për 5 deve është një dhi dhe për 10 deve duhet të jepen dy dhi. Për 40 dele dhe dhi të të jepet një kec. Ky është tatimi i zekatit për gjedhët.

Kjo përqindje e zekatit është e obligueshme për muslimanët. Kush jep më tepër se kjo, ajo do të jetë burim për më tepër sevape (shpërbli-me) për të.

Kushdo që paguan sasinë e caktuar, dëshmon pranimin e Islamit nga ana e tij dhe ndihmon muslimanët kundër të pafeve, ai është Musliman. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Muslimanëve duhet të jenë të obligueshme edhe për ta. Për përmbushjen e këtij premtimi, unë jap garancinë e Allahut dhe Pejgamberit të Tij.

Nëse një çifut apo i krishterë përqafon Islam, ai duhet të trajtohet në të njëjtën mënyrë. Kushdo që dëshiron të vazhdojë besimin çifut apo të krishterë, nuk duhet të detyrohet ta ndryshojë religjionin e vet, por ai duhet të paguajë xhizjen, tatimi i të cilit është Një (1) dinar⁵⁰ për çdo të rritur, apo një vlerë të barasvlershme me

⁵⁰ Dinari ishte një monedhë ari dhe në ditët e sotme është e barabartë me një stërlinë.

të apo rroba me të njëjtën vlerë. Kushdo që do t'ia paguajë këtë vlerë Pejgamberit të Allahut (s.a.v.s.), përgjegjësia për mbrojtjen e tij duhet të jetë e Allahut dhe Pejgamberit të Tij. Kushdo që refuzon të paguajë xhizjen, do të konsiderohet armik i Allahut dhe i Pejgamberit të Tij⁵¹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁵¹ Historia e Taberit, vol. 3, fq. 153.

17. Letra drejtuar Farwahut, guvernatorit të Maanit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Farwah bin 'Amar*

I dërguari juaj erdhi tek unë dhe m'i dorëzoi dhuratat që ju më dërguat, më dha vlerësimin tuaj dhe më transmetoi mua lajmin e mirë mbi pranimin e Islamit nga ana juaj.

Allahu ju ka nderuar juve me udhëzimin e Tij. Nëse ju vazhdoni t'i përmbaheni bindjes ndaj Allahut e Pejgamberit të Tij dhe mbeteni me besim të plotë tek ta, kryeni lutjet dhe paguani zekatin, kjo është mirësi e madhe e Allahut, dhe dije këtë se Allahu të ka bekuar me udhëzimin e Tij⁵².



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁵² Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 31.

Shënim. Farwahu ishte emëruar si guvernator i Maanit prej qeverisë bizantine. Maani, që tani është pjesë e Jordanisë, ndodhet në veriperëndim të Arabisë. Kur Çezari mësoi për pranimin e Islamit prej Farwahun, ai i tërhoqi vërejtjen atij dhe e urdhëroi atë të heqë dorë prej besimit të tij të ri, përndryshe ai e paralajmëroi se do ta biqte atë prej detyrës së tij. Por Farwahu kundërshtoi me vendosmëri. Si pasojë Çezari e burgosi atë, por duke parë se madje edhe vuajtjet e burgut nuk e shmangën prej vendosmërisë, ai urdhëroi që Farwahu të ekzekutohet me vdekje. Fjalët e tij të fundit ishin: "Njoftojeni Pejgamberin (paqja qoftë mbi të) se edhe eshtrat e mia do të mbejnë të përulura ndaj Allahut".

18. Letra drejtuar Amr ibn Hazm El-Ensarit, guvernatorit të Jemenit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Kjo shkresë, nga ana e Allahut të Madhërishëm
dhe Pejgamberit të Tij,
i drejtobet 'Amr ibn Hazm El-Ensarit
dhe është shkruar në kohën e emërimit të tij në Jemen.*

Allahu i Madhërishëm ka thënë: "O besimtarë!
Përmbushni premtimet tuaja".

Unë dua t'u bëj me dije se në çdo çështje duhet t'i frikësoheni Allahut, pasi "Allahu është me ata, të cilët i frikësohen Atij dhe janë të virtytshëm". Unë e këshilloj 'Amr ibn Hazmin (r.a.) të pranojë obligimet ndaj Allahut në përputhje me urdhërin e Tij. Trajtojini njerëzit me dashamirësi dhe urdhëroni ata të bëjnë vepra të mira. Mësoju atyre Kur'anin e Shenjtë dhe mundësoju atyre të kuptojnë parimet themelore të Islamit. Vetëm ai që është i pastër duhet ta prekë Kur'anin. Njerëzit duhet të largohen prej mëkateve. Ata duhet të jenë të vetëdijshtëm për të drejtat dhe detyrat e tyre. Me qëllim që njerëzit të kryejnë vepra të mira, ata duhen trajtuar me mirësjellje. Por nuk duhet të ketë hezitim në tërheqjen e vërejtjes ndaj

ndokujt që është fajtor për ushtrimin e dhunës apo për shkeljen e ligjit, pasi Allahu i Madhëruar nuk e pëlqen mizorinë: Ai rreptësisht e ka ndaluar tiraninë. Mallkimi i Allahut rëntë mbi tiranët.

Njerëzit duhet të njoftohen për veprimet dhe rrugët që i udhëzojnë për në Parajsë dhe të lajmërohen për veprimet që i shtyjnë ata drejt Ferrit.

Të gjithë njerëzit duhen trajtuar me dashamirësi, me qëllim që ata të mund të kuptojnë elementet e besimit në mënyrë të mjaftueshme.

Parimet e haxhit duhet gjithashtu të tregohen me hollësi, si farzi (që është thelbësor dhe i detyrueshëm), ashtu edhe sunneti (që është më pak thelbësor, por është kryer prej Pejgamberit (s.a.v.s) duhet të përshkruhen me qartësi. Të gjitha urdhërat e Allahut përsa i përket haxhit dhe umres duhet të jenë të njohura për njerëzit.

Njerëzve duhet t'u ndalohet të falen me rroba që nuk e mbulojnë trupin dhe që gjatë namazit mund të ekzistojë rreziku që të zbulohen pjesët e fshehta të trupit. Udhëzimet përsa i përket wudusë (abdestit) duhet të shpjegohen plotësisht. Është urdhëruar që namazet të kryhen në kohë të përcaktuar dhe është urdhëruar që rukujja (përrulja para Allahut gjatë namazit) duhet të kryhet plotësisht. Gjatë lutjeve duhet të ndihet prania e rikatit (prirja për t'u penduar dhe për të qarë). Namazi i mëngjesit (salat'ul-fexhr) duhet të thuhet herët në mëngjes para lindjes së diellit.

Namazi i drekës (salat'ul-dhuhr) duhet të kryhet pasi dielli të ketë kaluar zenitin e tij dhe fillon të perëndojë. Namazi i pasdrekës (salat'ul-asr) duhet të kryhet pasi hija bëhet e pjerrët. Namazi i mbrëmjes/akshamit (salat'ul-magrib) duhet të kryhet menjëherë pas perëndimit të diellit, dhe nuk duhet të vonohet derisa të duken yjet në qiell. Namazi i natës (salat'ul-isha) duhet të kryhet në pjesën e parë të natës.

Përsa i përket namazit të xhumasë (së Premtes), urdhërohet që kur të thirret ezani (thirrja që fton për t'u falur), secili duhet të niset menjëherë për të kryer namazin dhe përpara se të niset për të kryer namazin e xhumasë duhet të ketë bërë larjen e trupit.

Nga fitimet e arritura gjatë luftrave fetare, *humsi* (një e pesta) paguhet për në rrugë të Allahut. Prej prodhimit të tokës së çdo muslimani është caktuar *ushri* (një e dhjeta e prodhimit) për vendet e ujitura prej shiut, ndërsa për vendet e ujitura me kanale vaditëse, tatimi është gjysma e *ushrit* (një e njëzeta).

Përsa u përket kafshëve, për 10 deve duhet të jepen 2 dhi, për 20 deve duhet të jepen 4 dhi. Për 40 lopë duhet jepet një lopë, për 30 lopë duhet të jepet një viç dhe për 40 dhi duhet të jepet një dhi.

Kjo taksë, zekati, është bërë obligim për muslimanët prej Allahut. Cilido që paguan më tepër, do të meritojë shpërblimin më të madh.

Njerëzit nuk duhet t'i kërkojnë ndihmë njeri-tjetrit për të luftuar për emrin e fisit apo familjes së tyre. Njeriu duhet të ndihmohet vetëm për hir të Allahut, i Cili është Një. Dhe kushdo që i fton njerëzit e tjerë në luftë vetëm për emrin e fisit apo familjes, në vend të Allahut, një gjëje të tillë duhet t'i jepet fund.

Thirrja për luftë është vetëm për hir të Allahut, i Cili është Një. Nëse ndonjë çifut apo i krishterë përqafton Islamin me vullnetin e tij të lirë, me zemër të singertë dhe pranon udhëzimin e Allahut, ai është musliman. Të drejtat dhe detyrat e tij duhet të jenë të njëjta me ato të muslimanëve të tjerë.

Cilido që vazhdon t'i përmbahet besimit të tij çifut apo të krishterë, ai nuk duhet kurësesi të detyrohet ta ndryshojë fenë e vet. Por për secilin të rritur prej tyre duhet të mblidhet nga një (1) dinar, që duhet të merret për çdo vit, me para në dorë apo me po atë monedhë. Mund të pranohen gjithashtu edhe rroba me të njëjtën vlerë.

Kushdo që refuzon ta paguajë këtë vlerë, duhet të konsiderohet armik i Allahut, i Pejgamberit të Tij dhe i të gjithë muslimanëve⁵³.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁵³ Historia e Taberit, vol. 3, fq.156 - 157.

Shënim. 'Amri (r.a.) jo vetëm që e ruajti këtë dokument, por ai gjithashtu mblodhi dhe letra të tjera të Pejgamberit (s.a.v.s.), drejtuar fiseve të ndryshme, veçanërisht çifutëve, të krishterëve, dhe i lidhi ato së bashku në një vëllim. Kjo më vonë shërbeu si burim autentik informimi, veçanërisht përsa i përket zekatit, bamirësisë, së drejtave të muslimanëve dhe jomuslimanëve, detyrave të tyre etj.

19. Letra drejtuar Ukeidirit, sundimtarit të Dummet 'ul-Xhendel

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëploti!

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Ukeidirit dhe popullit të Duma-s*

Tash keni përçafuar Islamin dhe keni hequr dorë prej adhurimit të idhujve.

Tokat rreth e qark Duma-s, tokat jobujqësore, tokat pa pronar dhe "nazul" (pronat shtetërore), mjetet e koracuara dhe krahinat, do të jenë për ne.

Të gjithë lumenjtë, burimet, vendet e kultivuara, pemët, bari, etj., do të jenë pronë e popullit të Duma-s.

Zekat për kafshët nuk do të vihet, përveç atyre të cilat kullosin në livadhe. Kafshët e padobishme nuk duhet të përfshihen në zekat.

Namazi duhet të kryhet në kohën e duhur dhe zekati duhet të paguhet ndershmërisht.

Përmbushja e të gjitha atyre që u shkruan në këtë letër garantohet me besnikëri prej anës sonë, të cilën e dëshmojnë Allahu dhe të gjithë muslimanët e pranishëm⁵⁴.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁵⁴ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 36.

Shënim. Dummet 'ul-Xhendel, që tani njihet si Xheuf, një qendër e madhe karvanësh, ndodhet në gjysmën e rrugës midis Sirisë dhe Medines. Kanana, një fis arab, jetonte atje. Megjithëse fisi ishte arab, ata kishin pranuar kristianizmin nën influencën e Perandorisë Romane. Çezari e emëroi Ukeidirin si sundimtar të Duma-s, në emër të tij. Ukeidiri e përqafoi Islamin me dëshirë dhe vullnetarisht.

PJESA E TRETË:
Letrat dhe vendimet
drejtuar kryetarëve,
udhëheqësve, prijësve
të fiseve të ndryshme
dhe individëve

1. Letra drejtuar Papës së Romës

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Paqja qoftë mbi atë që i beson Allahut. Unë besoj se Isa/Jezusi (a.s.), djali i Merjemes/Marisë ishte shpirt prej Allahut dhe fjalë e Tij. Allahu e futi atë në Merjemen e devotshme.

Unë i besoj Allahut, të gjithë Librave të Tij dhe Urdhërave të Tij, të cilat Ai m'i shpalli mua dhe të cilat Ai ia ka shpallur Ibrahimit (a.s.), Ismailit (a.s.), Is'hakut(a.s.), Jakubit (a.s.) dhe pasardhësve të tyre. Unë gjithashtu besoj në atë që Allahu i shpalli Musës (a.s.), Isës (a.s.) dhe peygamberëve të tjerë. Në fe dhe besim ne nuk bëjmë ndonjë dallim në pranimin e peygamberëve. Ne jemi muslimanë (që do të thotë nënshtrim ndaj Allahut). Paqja qoftë mbi atë që e pason udhëzimin⁵⁵.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁵⁵ Historia e Taberit, vol. 3, fq. 88.

Shënim. Bashkë me letrën drejtuar Çezarit. Pejgamberi (s.a.v.s.) i dërgoi gjithashtu një letër papës. Ky i fundit e dëshmoi peygamberinë e tij dhe vërejtë: "Pa dyshim, ai është peygamber i vërtetë". Pas kësaj, ai drejtoi një kongregacion në katedrale dhe njoftoi njerëzit se ai kishte marrë një letër prej Pejgamberit Arab Ahmed (s.a.v.s.), i cili i ftonte ata të pranonin besimin e vërtetë tek Allahu, i cili është Një. Ai pastaj dëshmoi se s'ka Zot përveç Allahut dhe se Ahmedi (s.a.v.s.) ishte rob dhe i dërguar i Allahut. Njerëzit u zemëruan së tepërmi kur dëgjuan këtë deklaratë të vërtetë dhe ata e goditën atë kaq shumë, sa që ai vdiq⁵⁶.

⁵⁶ Taberiu dhe Ibn Sa'di, vol. 3, fq. 28.

2. Letra drejtuar çifutëve të Hajberit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
i cili është sikurse Musa/Moisiu (a.s.) pejgamber
dhe i dërguar dhe që dëshmon
po atë që ka dëshmuar edhe Musa (a.s.)*

O ithtarë të Librit (Torës), a nuk ka shpallur Allahu tek Tora se: "Muhammedi (s.a.v.s.) është Pejgamber i Allahut. Njerëzit që do të jenë me të do të jenë të ashpër ndaj armiqve të Allahut. Ndërsa ndërmjet vete do të jenë të përzemërt e të dashur. Ata do të nënshtrohen e do të përuken vetëm përpara Allahut. Dhe ata do të synojnë të arrijnë bujarinë dhe dashamirësinë e Tij".

Unë ju ftoj juve të betoheni për Allahun, i Cili u dërgoi juve Torën dhe u mundësoi stërgjyshërve tuaj të ushqehen me 'mann' dhe 'salva' dhe ndau detin në dysh për ta dhe i shpëtoi ata nga tirania e faraonit. A s'është shkruar tek Tora se ju duhet të më besoni mua?

Pas njoftimit rreth meje tek Tora, a bëhet i qartë udhëzimi i drejtë prej atij të gabuarit?

Prandaj unë ju ftoj juve t'i besoni Allahut dhe Pejgamberit të Tij⁵⁷.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Çifutët dhe Kristianët e dinin fort mirë se pritej të vinte një Pejgamber dhe ata prej kohësh ishin në pritje të shfaqjes së tij. Pejgamberi (s.a.v.s.) ishte plotësisht i sigurt për paralajmërimin që bëhej për të, tek Tora.

⁵⁷ Kenz 'ul-Ummal, vol. 5, fq. 285.

3. Letra drejtuar Budeil bin Warakas

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Budeil bin Warakas*

Unë e madhëroj vetëm Allahun, përveç të Cilit nuk ka asnjë Zot tjetër.

Këtej e tutje, ju duhet ta dini se populli i Tihama-s janë më të dashurit për mua dhe në marrëdhëniet farefisnore janë më të afërt për mua. Çfarëdo që unë dëshiroj për vete, atë ia dëshiroj edhe kujtdo prej jush që shpërngulet, megjithëse ai mund të shpërngulet në një vend në vetë krahinën e tij.

Kushdo që i bashkangjitet këtij populli, do të meritojë të njëjtin trajtim, sikurse populli i Tihama-s.

Unë e vlerësoj popullin e Tihama-s dhe asgjë nuk do të ndërmerret nga ana ime që të mos jetë në pajtim me dinjitetin e tyre.

Gjatë kohës së traktatit tim me fiset arabe, populli juaj duhet të ndjehet i sigurt.

Alkama, djali Ulasa dhe dy djemtë e Hauza-s tashmë e kanë përqafuar Islamin dhe të dy ata janë shpërngulur dhe kanë deklaruar të njëjtat

kushte të marrëveshjes, sikurse ka vepruar edhe populli i Ikrama-s. Ne jemi të gjithë të barabartë përsa i përket Hallallit (të lejueshme) dhe Haramit (të ndaluara). Pa dyshim Allahu do t'ju dojë juve⁵⁸.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Abdu'l-Mutalibi, gjysbi i Pejgamberit, kishte byrë në marrëveshje me fisin Huza'a për të ndihmuar njëri-tjetrin dhe pasardhësit e njëri-tjetrit. Si rrjedhim, fisi gjithmonë e ndihmoi Pejgamberin (s.a.v.s.). Ky fis e informoi Pejgamberin (s.a.v.s.) për pushtimin e Medines nga ana e Kurejshëve dhe e çifutëve.

Ky fis jetonte në Luginën e Tihama-s, që shtrihej në jug të Mekës, përgjatë Detit të Kuq dhe Malit Sirat. Aslami ishte një degë e këtij fisi. Njerëzit e tij u paraqitën tek Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe e pranuan Islamin. Pejgamberi i shkroi këtij fisi letrën që vijon:

⁵⁸ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 25.

4. Letra drejtuar popullit të fisit Aslam

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kushdo prej fisit Aslam, që i beson Allahut, kryen namazin, paguan zekatin dhe është i sinqertë në besimin tek Allahu, do të ndihmohet në rast se ndokush do t'i sulmojë ata.

2. Në rast se Pejgamberi (s.a.v.s.) kërkon ndihmën e tyre, është obligim që ta ndihmojnë atë.

3. Fshatarët do të gëzojnë të njëjtat të drejta, sikurse edhe qytetarët.

4. Këta njerëz mund të shpërngulen kudo që të dëshirojnë⁵⁹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁵⁹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 24.

5. Letra drejtuar popullit të trevës së Tihama-s

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar njerëzve të lirë të Allahut*

Të gjithë ata që i besojnë Allahut, kryejnë namazin dhe paguajnë zekatin, janë të lirë prej skllavërisë. Muhammedi (s.a.v.s.) është sundimtari i tyre. Ata nuk do të përzihen, me përjashtim për vetë fiset e tyre dhe nuk do të ndëshkohen për krimet në të kaluarën. Ata njerëz, borxhi i të cilëve është i detyrueshëm, duhet ta paguajnë atë.

Këta njerëz nuk do t'i nënshtrohen asnjë shtypjeje apo padrejtësie. Për këdo që përqafton Islamin do të jetë përkrahja e Allahut dhe e Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.), për të gjitha çështjet e përmendura më lart.

Paqja qoftë mbi ju!⁶⁰



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁶⁰ Po aty, fq. 29.

Shënim. Siç e përmendëm më lart, Tibama është një luginë e gjatë, që shtrihet midis Detit të Kuq dhe Kodrës Serat. Në trevën malore të Tibama-s, banojnë njerëz që u përkasin fiseve të ndryshme arabe. Ata nuk zotëronin ndonjë punë apo profesion të rregullt, por përdornin plaçkitjen dhe grabitjen. Ata dërguan një delegacion tek Pejgamberi (s.a.v.s.), i cili i siguroi ata se krimet e tyre në të kaluarën do të faleshin dhe robërit e tyre do të liroheshin.

6. Letra drejtuar Halid bin Zimad 'ul-Azdit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Tokat e kultivura në zotërimin e Halid bin Zimad'ul-Azdit mbetën pronë e tij, me kusht që ai t'i besojë Allahut, i Cili nuk ka shok, të dëshmojë që Muhammedi është rob dhe pejgamber i Tij, të kryejë namazin, të paguajë zekatin, të agjërojë muajin e Ramazanit, të kryejë haxhin, të mos fusë risi në fe, të mos dyshojë në drejtësinë e Islamit, t'i mbetet besnik Allahut dhe Pejgamberit të Tij, t'i mbështesë përkahësit e Allahut dhe t'i armiqësojë armiqtë e Tij.

Është obligim i Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.) që ta mbrojë atë, ashtu sikurse ai mbron jetën dhe pronën e tij e atë të miqve dhe të afërmeve të tij.

Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë përkrahës të Halid'ul-Azdit, me kusht që të mos ketë pabesi nga ana e tij⁶¹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁶¹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 2, f. 21.

Shënim. Para shfaqes së Islamit, babai i Halid'ul-Azdit, i cili ishte jemenas, merrej me mjekësi dhe kirurgji. Gjatë periudhës së peygamberisë të Pejgamberit (s.a.v.s.), atij i qëlloi të vizitojë Mekën dhe të shohë një grup ngatërresëtarësh, që e ndiqnin Pejgamberin (s.a.v.s.) dhe e quanin atë të çmendur. Për këtë arsye Zimad-i shkoi tek Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe i tregoi atij se ai mund ta mjekonte sëmundjen e çmendurisë. Pejgamberi (s.a.v.s.) duke e madhëruar Allahun, tha disa fjale mbresëlënëse, të cilat Zimad-it i lanë përshtypje aq të thellë, saqë ai e përqafoi Islamin menjëherë. Pejgamberi (s.a.v.s.) e shkroi letrën e mësipërme drejtuar Halidit.

7. Letra drejtuar Hilal bin Umejjes, kryetarit të Bahreinit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Paqja qoftë mbi ju! Unë e madhëroj Allahun, i Cili është Një dhe nuk ka shok.

Unë ju ftoj të besoni tek Allahu, i cili është Një. Bindjuni Allahut dhe pranoni Islamin. Kjo është rruga më e mirë për ju. Siguria, është për atë që pason rrugën e drejtë⁶².



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁶² Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 27.

8. Letra drejtuar Usaibuh bin Abdullah, prijësit të Haxherit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut
drejtuar Usaibuh bin Abdullah, prijësit të Haxherit*

Akr'a e solli letrën tuaj dhe bëri një rekomandim në emër të fisit tuaj. Unë e pranova rekomandimin e tij. Unë ju përçoj lajmin e mirë se pajtohëm për ato që keni kërkuar, në përputhje me dëshirat tuaja, por mua më duket e arsyeshme që ju t'i shpjegoni kërkesat tuaja.

Nëse ju vini këtu, do të jeni i respektuar. Por edhe nëse nuk mund të vini, respekti për ju gjendet në zemrën time.

Edhe pse unë nuk kërkoj ndonjë gjë, nëse ju dëshironi të më dërgoni mua ndonjë dhuratë, unë do ta pranoja atë me kënaqësi.

Shokët e mi më kanë folur për nivelin e lartë dhe të respektuar të rangut tuaj. Unë ju këshilloj t'i kushtoni vëmendje të plotë namazit, zekatit dhe marrëdhënieve me muslimanët.

Unë kam propozuar emrin e Benu Abdullahut për komunitetin tuaj. Ju duhet ta urdhëroni

popullin tuaj të kryejë namazin dhe të bëjë vepra të mira. Merrini për vete lajmet e gëzuara.

Paqja qoftë mbi ju dhe komunitetin e besimtarëve tuaj!⁶³



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

Shënim. Usaibuhti, që gjithashtu quhej Sebbuht, ishte udhëbëqësi i Haxherit, i cili në atë kohë ishte një qytet i madh, që ndodhej në Gjirin Persik, dhe ishte pjesë e provincës arabe të El-Hisa-s. Usaibuhti e përqafoi Islamin me kënaqësi. Pejgamberi i All-llabut (s.a.v.s.) ia adresoi gjithashtu letrën e mëposhtme Benu Abdullabut.

⁶³ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 27

9. Letra drejtuar Benu Abdullahut

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Unë e këshilloj popullin tuaj të qëndrojë i devotshëm ndaj Allahut dhe të mos e marrë rrugën e shtrembër pas marrjes së udhëzimit të drejtë dhe të mos priret në drejtim të gabuar pasi që e ka pranuar rrugën e drejtë.

Delegacioni juaj erdhi tek unë. Unë u solla me dashamirësi në mënyrë që t'i kënaqja ata.

Unë mendoj se nuk është e drejtë t'ju përze prej Haxherit. Unë e kam pranuar kërkesën e delegacionit tuaj. Ju duhet të përkujtoni mirësitë me të cilat Allahu ju ka bekuar. Mua më është bërë e ditur çdo gjë që njerëzit tuaj kanë bërë. Cilido prej jush, që dëshiron të mbetet i devotshëm, nuk duhet të ngatërrohet në trazirat e shkaktuara prej të tjerëve.

Kur të dërguarit e mi të mbërrijnë tek ju, ndihmojini ata në rrugën e Allahut. Kushdo prej jush që do të kryejë një vepër të ndershme, vepër e tij e mirë nuk do të kalojë pa u vënë re as prej Allahut e as prej meje.

Shpëtimi është për atë që pason rrugën e drejtë⁶⁴.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁶⁴ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 27.

Pas pushtimit të Mekës, Profeti i Shenjtë (s.a.v.s) u adresoi letrat që vijojnë më poshtë, një numri fisesh, shumica e të cilave tashmë e kishin pranuar Islamin.

10. Letra drejtuar Nahshall bin Malikut, kryetarit të Beni Va'ilit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të All-llahut,
drejtuar Nahshall bin Malikut dhe njerëzve
të Beni Va'ilit, të cilët tashmë e kanë pranuar Islamin.*

Të gjithë njerëzit duhet të vazhdojnë të kryejnë namazin, të paguajnë zekatin, t'i binden Allahut dhe Pejgamberit të Tij, si dhe të paguajnë një të pestën e fitimeve gjatë luftrave, për Allahun dhe Pejgamberin e Tij. Vazhdoni të shpallni pranimin e Islamit dhe qëndroni larg të pafeve. Të gjithë njerëzit e tillë janë nën mbrojtjen dhe kujdesin e Allahut dhe Muhammedit (s.a.v.s.), të cilët janë përgjegjës për shpëtimin e tyre nga çdo lloj shtypjeje dhe mizorie.

Askush nuk do t'i dëbojë këta njerëz jashtë vendit të tyre dhe as nuk do t'u ngarkojë ushrin (një të dhjetën) për prodhimet e tyre. Sundimtari duhet të jetë prej vetë mesit të tyre⁶⁵.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁶⁵ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 33 dhe 49.

11. Letra drejtuar Rifa' bin Zaid Xhuzamit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të All-llahut,
drejtuar Rifa'a bin Zaidit*

Unë po e dërgoj Rifa'un te komuniteti i tij. Ai atje do të përhapë ftesën e Allahut dhe të Pejgamberit të Tij.

Cilido që e pranon këtë ftesë, do të merret si pjesëtar i taborit të Allahut dhe i të Dërguarit të Tij, ndërsa cilido që e refuzon këtë, do të jetë i siguruar për dy muaj rresht.

Shënim. Rifa'u e kishte pranuar Islamin qysh më herët. I Dërguari (s.a.v.s.) ia dorëzoi atij këtë letër dhe e dërgoi predikues te fisi i tij.

12. Letra drejtuar Benu Asadit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Benu Asadit*

Paqja qoftë mbi ju. Unë e madhëroj vetëm Allahun, përveç tij nuk ka Zot tjetër për t'u adhuruar.

Këtej e tutje ju nuk keni të drejtë të merrni të drejtën e pronësisë të burimeve dhe tokave të fisit Tai. Përdorimi i burimeve të tyre nuk është i lejuar (hallall) për ju. Gjithashtu askush nuk duhet të hyjë në tokat e tyre pa lejen e tyre.

Cilido që nuk do të më bindet mua, nuk do të jetë nën përkrahjen time.

Kadha' bin Umeri, i cili është administratori i tyre, duhet t'i qeverisë ato⁶⁶.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁶⁶ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 2.

13. Letra drejtuar prijësve të Akaba-s

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar popullit të Akaba-s*

Paqja qoftë mbi ju. Unë madhëroj Allahun, i Cili është Një dhe përveç tij nuk duhet adhuruar askush tjetër.

Unë nuk kam ndërmend të ndërmarr luftë kundër jush derisa ju të merrni me shkrim arsyen time për këtë. Është më mirë për ju që, ose të pranoni Islamin, ose të pajtoheni të paguani xhizjen dhe të pranoni të mbeteni të bindur ndaj Allahut, Pejgamberit të Tij dhe të dërguarve të tij. Të dërguarit e mi meritojnë të nderohen. Trajtojini ata me respekt. Çfarëdo që i kënaq të dërguarit e mi, do të më kënaqte edhe mua gjithashtu.

Ky popull është i informuar për urdhërat rreth xhizjes. Nëse ju dëshironi që të ekzistojë paqja dhe siguria në botë, bindjuni Allahut dhe Pejgamberit të Tij. Këtej e tutje, askush në Arabi dhe Axhem (Iran) nuk do të guxojë të hedhë ndonjë vështrim dashakeq mbi ju. Por ndërkohë nuk duhet të hiqet dorë nga rregullat e Allahut dhe Pejgamberit të Tij.

Nëse ju nuk i pranoni këto kushte dhe i lini ato anash, unë nuk kam nevojë për dhuratat dhe peshqeshet tuaja. Në këtë rast, mua do të më duhet të zhvilloj luftë (për të vendosur paqen

dhe sigurinë). Si pasojë e kësaj njerëzit më të rëndësishëm do t'iu vriten në luftë, ndërsa të zakonshmit do t'u kapen robër.

Unë ju garantoj se unë jam Pejgamber i vërtetë i Allahut. Unë i besoj Allahut, Librave të Tij, pejgamberëve të Tij dhe besoj se Mesihu, djali i Merjemes (Marisë) është pejgamber i Allahut dhe fjalë e Tij.

Hurmala (r.a.), i cili më solli 3 vasakë (afro 5 kuintalë) elb, ma sugjeroi rastin tuaj. Nëse nuk do të kishte qenë në pëlqim me urdhërin e Allahut dhe mendimin e mirë të Hurmalës për ju, atëherë për mua nuk do të kishte qenë e nevojshme t'ju drejtojë letër juve dhe në vend të kësaj do të kishte pasur luftë. Nëse ju do t'iu bindeni të dërguarve të mi, do të keni menjëherë mbështetjen time dhe ndihmën e përkrahjen e cilitdo që më është bashkangjitur mua.

Të dërguarit e mi janë Shureih-bil, Obej, Hurmala dhe Hureis (r.a.) dhe çfarëdo vendimi ata marrin në lidhje me ju, do të jetë i pranueshëm për mua.

Populli juaj është nën mbrojtjen dhe përkrahjen e Allahut dhe Pejgamberit të Tij.

Furnizojini me ushqime çifutët e Maknas, për udhëtimin drejt vendit të tyre.

Nëse ju e pranoni bindjen, paqja qoftë mbi ju⁶⁷.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

⁶⁷ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 29, 37.

Shënim. Sikurse edhe në ditët e sotme, Akaba ishte një port i rëndësishëm i Detit të Kuq. Në kohët e lashta, gjithashtu, për shkak të të qenit të saj një qendër ndërkombëtare tregtie, karvanët tregtare prej Palestinës dhe Afrikës kalonin përmes Akaba-s dhe mallrat tregtare të qyteteve bregdetare të Detit të Kuq, gjithashtu kalonin aty. Nën influencën e Romakëve, fiset lokale arabe të cilat sundonin këtu, ishin konvertuar në të krishterë, por për shkak të sjelljes shtypëse të Romakëve, ishin armiqësuar me Romakët dhe dëshironin të ishin të lirë.

Gjatë kohës së Pejgamberit (s.a.v.s.), Johana, që ishte peshkop, ishte sundimtar i Akaba-s. Në fillim ai nuk ishte përgatitur t'i përkahte muslimanët. Por kur e pa që Çezari iu shmang përballjes me muslimanët, ai u kthye në anën e Islamit. Më vonë, në vitin e 9-të Hixhri, apo 630 e.s., Çezari donte ta pushtonte Medinën me një ushtri të madhe. Por, Pejgamberit (s.a.v.s.), iu mbush mendja që ta zhvendoste rrjedhën e luftimeve në vendin e kundërshtarëve. Për këtë qëllim ai zhvendosi shokët e tij trima drejt Tebukut, ku ai e priti ushtrinë romake për afro 12 ditë. Ushtria romake u dekurajua së tepërmi prej kurajës së muslimanëve dhe u shpërnda në heshtje pa luftuar. Johana dhe prijës të tjerë të fiseve të ndryshme dërguan delegacione dhe i siguruan për bindjen e tyre ndaj Pejgamberit, i cili iu adresoi letrën e dhënë më lart. Johana vetë personalisht shkoi tek Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe hyri në një faltore islame.

14. Letra drejtuar popullit të Makna-s

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Benu Xhamba dhe popullit të Makna-s*

Paqja qoftë mbi ju! Jam njoftuar se ju jeni duke shkuar në fshatrat tuaja. Ju do të jeni i sigurt, kur kjo letër të mbërrijë tek ju. Unë i kam falur të gjitha krimet tuaja. Askush nuk do të lejohet të ushtrojë dhunë mbi ju. Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë garant për ju. Ne do t'ju mbrojmë juve, ashtu sikurse e mbrojmë vetveten.

Pagimi i një të katërtës së prodhimit të kopshteve të hurmave, të nxjerrjeve të Detit dhe tjerrjes së fijeve, është i detyrues për ju. Pas pagimit të saj, ju jeni të liruar prej pagimit të xhizjes dhe të gjitha llojet e punës së lirë. Nëse ju do të mbeteni besnikë, do të jetë obligim yni të nderojmë njerëzit tuaj të respektuar dhe të familim të gjitha fyerjet tuaja në të kaluarën.

Në fund të letrës, për muslimanët, ishte shkruar udhëzimi që pason:

Kushdo që i trajton njerëzit e Makna-s me dashamirësi, kjo do të jetë për të mirën e tij dhe kushdo që do t'i keqtrajtojë ata, kjo do të jetë në

dëm të tij. Sundimtari juaj ose duhet të emërohet prej jush ose prej atyre që kanë lidhje me mua⁶⁸.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Banorët e Makna-s, që ndodhej në gjirin Akaba, ishin çifutë. Ata dërguan një lajmës tek Pejgamberi (s.a.v.s.) për ta garantuar atë, për besnikërinë e tyre dhe i kërkuan atij një urdhëresë.

⁶⁸ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 28.

15. Letra drejtuar popullit të Azruh-it

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar banorëve të Azruh-it*

Ky popull është nën mbrojtjen dhe përkrahjen e Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.). Për çdo muaj Rexheb, (muaji i 7-të i kalendarit Islamik) prej tyre duhet të paguhet nga 100 dinarë. Allahu do të jetë mbrojtësi i tyre, në këmbim të vullnetit të tyre të mirë dhe kthimit të tyre drejt devotshmërisë.

Ky popull gëzon çdo garanci, derisa të mos njoftohet e kundërta prej Muhammedit (s.a.v.s.)⁶⁹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁶⁹ Makdisi, fq. 178

16. Letra drejtuar kryetarit të Hamdan-it

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit
Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Umeir Zimaranit*

Paqja qoftë mbi ju. Unë e madhëroj Allahun, përveç tij askush tjetër nuk duhet adhuruar.

Gjatë kthimit prej Romakëve, unë mora lajmin e pranimit të Islamit nga ana e fisit tuaj. Uri me për popullin e Hamdanit, të cilin Allahu e ka nderuar me udhëzimin e Tij. Populli juaj duhet të bëjë deklaratën e pranimit të Islamit që është: *Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhammedi (s.a.v.s.) është Pejgamberi i Tij.* Ata të cilët e kryejnë namazin dhe paguajnë zekatin, do të jenë nën mbrojtjen e Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Askush nuk do të lejohet ti shtypë apo t'i dhunojë ata. Dhe kushdo që zotëron diçka, ajo do të vazhdojë të mbetet e tij.

Nuk është e lejueshme për Ehli Bejtin (Familja) e Pejgamberit (s.a.v.s.) të pranojë lëmoshë. Malik bin Musara Ruhawi (r.a.) e ka dorëzuar mesazhin tuaj. Po jua theksoj: trajtojeni atë shumë mirë. Ai është njeriu më i mirë i grupit të tij⁷⁰.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁷⁰ Tabekat Ibn Sa'd, vol.2, fq.73 dhe 74.

Shënim. Letra e mësipërme ishte dërguar me rastin e marrjes së lajmit të mirë, se si pasojë e predikimeve të Kais bin Malikut, i cili i përkiste fisit Hamdan, i gjithë fisi e kishte përqafuar Islamin. Më herët Kais ishte prezantuar vetë tek Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe e kishte pranuar Islamin. Ai u caktua për të predikuar Islamin te fisi i tij.

17. Letra drejtuar Halid bin Velidit (r.a.)

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Halid bin Velidit.*

Paqja qoftë mbi ju! Unë e madhëroj Allahun, përveç tij askush tjetër nuk duhet adhuruar.

E mora letrën tuaj, nëpërmjet të dërguarit tuaj, në të cilën ju më kini njoftuar rreth pranimin të Islamit prej fisit Benu El-Haris. Më është bërë e ditur se ata e kanë pranuar ftesën të cilën juve ua komunikuat atyre dhe se ata dëshmuuan se nuk duhet adhuruar askush tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe nuk ka shok dhe se Muhammedi (s.a.v.s.) është rob dhe i Dërguar i Tij.

Allahu i ka nderuar ata me udhëzimin e tij. Njoftoi ata për kënaqësitë e xhennetit dhe frikësoji ata për tmerrin e xhehennemit.

Pasi ta kryesh këtë punë, eja këtu dhe thuaji atij fisi të dërgojë një delegacion tek unë⁷¹.

*Paqja, mirësia
dhe bekimi i Allahut
qoftë mbi ju!*

⁷¹ Historia e Taberit, vol. 3, fq. 156.

Shënim. Pejgamberi (s.a.v.s.) e kishte dërguar Halid bin Velidin (r.a.) tek fisi Benu Haris, i cili banonte në Jemen, për t'i ftuar ata të përqafojnë Islamin. I gjithë fisi e pranoi Islamin. Kur Velidi ia përcolli lajmin e mirë, Pejgamberi (s.a.v.s.) i shkroi atij letrën e mësipërme.

18. Letra drejtuar Musejleme Kedhabit (Gënjeshtarit)

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Musejleme Kedhabit*

Paqja qoftë mbi atë që ndjek udhëzimin!

Toka është e Allahut, i Cili e ka krijuar atë dhe, cilido prej njerëzve që dëshiron Ai, bëhet trashëgimtar i saj.

Përfundimi është i mirë për ata që i frikësohen Allahut⁷².



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁷² Po aty, vol. 3, fq. 167.

Shënimi. Është përmendur edhe më parë që Hauza, guvernatori i Jemenit, i shkruajti Pejgamberit (s.a.v.s.) se në rast se Pejgamberi pajtohej ta përfshinte atë në qeverinë e tij, ai ishte i gatshëm ta përfaqonte Islamin. Kjo kërkesë nuk u pranua prej Pejgamberit (s.a.v.s.). Pas vdekjes së Hauza-s, Musejleme e zëvendësoi atë. Menjëherë pas kësaj ai në mënyrë mashtruese e mbiquajti veten profet dhe i shkroi Pejgamberit (s.a.v.s.) se ai i ishte shoqëruar në pejgamberi dhe si rrjedhim gjysma e vendit duhej t'i jepej atij. Si përgjigje Pejgamberi (s.a.v.s.) i shkroi ajetin e Kur'anit të Shenjtë prej Sures el-A'raf, përkthimi i së cilës është dhënë më sipër dhe ia dërgoi atë Musejleme-s. Një përgjigje kaq e shkurtër, por kaq elokumente nuk ka të krahësuar.

Musejleme u vra në një betejë nga Halid bin Velidi (r.a.), pas vdekjes së Pejgamberit (s.a.v.s.).

19. Letra drejtuar Mu'adh bin Xhebelit (r.a.)

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Mu'adh bin Xhebelit (r.a.)*

Paqja qoftë mbi ju. Unë e madhëroj Allahun që është Një. Allahu i shtoftë shpërblimet ndaj jush, e qetësoftë zemrën tuaj të dëshpëruar dhe ju dhashtë durim për ta falenderuar Atë.

Në të vërtetë jetët tona, të afërmit e të dashurit tanë, dhe pasuritë tona, na janë besuar vetëm përkohësisht prej mirësive të Allahut. Ai i bën mirë robit të tij me to, derisa Ai dëshiron dhe kur vjen momenti i caktuar, Ai e merr atë.

Është obligim i njeriut ta falenderojë Allahun, kur Ai i dhuron atij begati dhe kur ajo i merrret, ai duhet ta përballojë atë me durim.

Djali juaj kishte një besim të drejtë tek Allahu. Ai ju bekoi me të derisa Ai deshi dhe kur dëshiroi, Ai e mori atë prej jush në këmbim të një shpërblimi të madh, me kusht që ju të jeni i kënaqur me vullnetin e Allahut.

O Mu'adh (r.a.)! Nëse ju tregoheni i padurueshëm ju do ta humbni shpërblimin apo vlerësimin e Allahut. Nëse ju do ta dinit se sa fitim dhe

kompensim iu është dhuruar juve për të, atëherë kjo humbje do të dukej tepër e pakët në sytë tuaj.

Premtimi të cilin Allahu ua ka dhënë njerëzve, të cilët i përballojnë fatkeqsitë dhe dhimbjet me durim, do të përmbushet plotësisht në jetën tjetër. Premtimi i Allahut do ta pakësojë pikëllimin tuaj. Ajo që është destinuar të ndodhë, duhet të ndodhë.

Paqja qoftë mbi ju⁷³.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Mu'adbi ishte një shok i respektuar i Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili e përqafoi Islamin në moshë tepër të re, kur ishte 18 vjeç. Ai i përkiste Ensarëve. Pejgamberi (s.a.v.s.) e dërgoi atë për t'i mësuar muslimanët në Jemen, ndërkohë djali i tij vdiq. Me këtë rast Pejgamberi (s.a.v.s.) i shkroi atij letrën e mësipërme për ngushëllim, duke e këshilluar atë ta përballonte humbjen me durim.

⁷³ Risalet en-Nebevijje.

20. Letra drejtuar xhinnëve

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Kjo shkresë e Pejgamberit të Allahut, Sundimtarit të botëve, është për personin që për shkak të disa arsyeve hyn në ndonjë shtëpi natën, apo qëndron në ndonjë shtëpi dhe shkakton dëm. O Mëshirues! Dhuro mirësi në të!

Këtej e tutje, midis nesh dhe jush, ekziston një shtrirje dhe një vend përsa u përket rregullave. Prandaj, nëse ju doni ndokënd dhe e pëlqeni atë, dhe nuk dalloni midis të drejtës dhe të gabuarës, dhe doni t'i drejtoheni forcës, dhe përgënjeshtroni atë që është e drejtë, atëherë ju duhet ta dini që Libri i Allahut jep gjykimin e drejtë midis nesh dhe jush. Allahu i madhërishëm thotë: Ky është Libri Im, i cili dëshmon atë që është e drejtë, për ta krahasuar me veten tuaj. Ne regjistrojmë çdo gjë që ju bëni dhe Engjëjt Tanë gjithashtu i shkruajnë ato.

Prandaj, lëre të qetë personin i cili e ka këtë shkresë timen dhe largoju adhurimit të idhujve, apo shko tek personi i cili i shoqëron dikënd tjetër adhurimit të Allahut. Çdo gjë përveç Tij është kalimtare. Në këtë botë. Ai është Sundimtari dhe tek Ai do të kthehemi të gjithë (pas vdekjes).

"Taglebun" "Ha Mim". Ata nuk do të ndihmohen. "Ha Mim 'Ajn Sin Kaf". Armiqtë e Allahut do të ndëshkohen. Argumenti tashmë ka ardhur prej Allahut. Askush përveç Allahut nuk zotëron fuqi dhe forcë. Prandaj Allahu, i cili është i Gjithëditur dhe i Gjithinformuar, mjafton t'ju shpëtojë juve prej djallëzive të tyre⁷⁴.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

⁷⁴ Sujuti, Hasa'is'ul-Kubra, vol. 2, fq. 98, 99.

Shënim. Ebu Duxhane (r.a.), një luftëtar trim dhe sypatrembur, shok i Pejgamberit (s.a.v.s.) shkoi tek ai dhe i tregoi se një natë derisa ishte shtrirë në krevatin për të fjetur, dëgjoji një zë të frikshëm, pa diçka si ndriçim dhe pa një hije që lëvizte në oborr. Më tutje tregoi se kur vazhdoi të ecë në drejtim të saj, një flakë u hodh në drejtim të tij dhe ai u frikësua se mos ajo do ta digjte atë. Pejgamberi (s.a.v.s.) vuri në dukje se ka mundësi të kishte qenë xhin. Prandaj ai shkroi letrën e mësipërme, të cilën Ebu Duxhane e mbante nën jastëkun e tij dhe flinte gjumë. Ai dëgjoji dikënd duke thënë: "O Ebu Duxhane. Pasha Latin dhe Uzzanë⁷⁵, ju më dogjët mua. Nëse ju e zhvendosni letrën prej jastëkut tuaj, pastaj tek shkruesi i letrës, unë kurrë nuk do ta vizitoj përsëri shtëpinë tuaj apo të fqinjëve tuaj". Ebu Duxhane ia tregoi ngjarjen Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili tha: "Ebu Duxhane! Largoje letrën, përndryshe prej Një të Vetmit, i Cili më ka dërguar mua si Pejgamber, grumbulli i xhinëve do të mbesim në agoni, deri në Ditën e Gjykimit".

⁷⁵ Lati dhe Uzza-ja ishin dy idhuj të mëdhenj në Arabi. Lati ishte vendosur në Taif, ndërsa Uzza-ja në afërsi të Mekes.

21. Letra drjetuar Dhul Gussa Kaisit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Benu el-Haris dhe Benu Nahad janë nën mbrojtjen e Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.). Askush nuk do t'i nxjerrë ata jashtë prej vendbanimeve të tyre dhe as do të merret ushri prej tyre, me kusht që ata të vazhdojnë ta kryejnë namazin, ta paguajnë zekatin, të qëndrojnë larg të pafeve dhe ta shpallin hapur Islam-in e tyre.

Përveç këtyre, ruajtja e rrugëve do të përfshihet ndër detyrat e tyre⁷⁶.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Dhul Gussa Kaisi ishte prijësi i fisit Benu Nahal.

⁷⁶ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 22.

22. Letra drejtuar 'Amr bin Ma'bad El-Xhuheniut

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Cilido prej këtyre njerëzve që pranon Islamin, kryen namazin, paguan zekatin, qëndron i bindur ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.), deklaron hapur Islamin e tij, qëndron larg të pafeve dhe i përmbahet pagimit të pjesës të fitimeve të luftave të shenjta për Allahun dhe Pejgamberin e Tij, do të mbetet në mbrojtjen e Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.).

Kushdo prej muslimanëve, karshi të cilit ndokush është borxhli, duhet të marrë vetëm vlerën fillestare. Interesi mbi vlerën e lënë peng nuk është i lejueshëm.

Zekati i frutave duhet të jetë një e dhjeta e prodhimit. Cilido që do t'i bashkangjitet këtij populli, duhet t'u përmbahet këtyre vendimeve⁷⁷.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

⁷⁷ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 24 dhe 25.

23. Letra drejtuar Benu Zuheirit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Benu Zubeirit.*

Nëse populli i Benu Zuheir bin Ukaish (një degë e Fisit Ukal) beson tek Allahu dhe Pejgamberi i Tij dhe ka mirëbesim tek ta, kryen namazin, paguan zekatin, qëndron larg të pafeve dhe pranon të japë pjesën e Allahut dhe Pejgamberit të Tij nga përfitimet e luftrave, ai do të jetë i sigurt nën mbrojtjen e Allahut dhe Pejgamberit të Tij⁷⁸.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Letra e mësipërme u shkrua në një pergamen me një person të quajtur En-Namir bin Taulab, i cili njoftoi përmbajtjen e urdhërave të nxjerra prej Pejgamberit (s.a.v.s.) tek fisi i tij.

⁷⁸ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 22.

24. Letra drejtuar Suheil bin 'Amrit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Sapo ta marrësh këtë letër, më dërgo menjëherë ujë⁷⁹ Zemzemi⁸⁰.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

⁷⁹ Emri i Burimit në rrethinën e Haremit të Kabes.

⁸⁰ Risalat en-Nebevijje, fq.154.

Shënim. Tashmë është përmendur më parë në këtë libër, se Subeil bin 'Amri ishte një armik i ashpër i Islamit që shkaktoi një nxitje të madhe dhe fjalime plot vrer kundër Pejgamberit (s.a.v.s.). Ai ishte personi që bëri paqe me Pejgamberin (s.a.v.s.) në emër të Kurejshëve me vetë kushtet e tij, pas një debati mjaft të madh. Pas çlirimit të Mekes, ai u fsheh në shtëpinë e vet, dhe iu lut djalit të tij, Ebu Xhundal (r.a.), t'ia falte jetën. Për persekutimet e Ebu Xhundalit, i cili e kishte përqafuar Islamin, prej babait të tij Subeil, është folur edhe më parë në këtë libër. Pejgamberi (s.a.v.s.) me shpirtmadhësi i falli të gjitha gabimet e tij në të kaluarën. Subeil u prek kaq shumë prej shpirtmirësisë së pakufishme të Pejgamberit, sa që ai sinqerisht e përqafoi Islamin dhe u bë një prej më të devotshmëve të Islamit. Është i mirënjohur fakti se askush nuk e kalonte atë në faljen e sa më tepër namazave, në agjërimin e sa më tepër ditëve dhe në dhënien e sa më tepër sadakave. Teprimi në mënyrë të skajshme në faljen e namazit dhe agjërim e dobësuan atë. Menjëherë sapo mori letrën e mësipërme, ai i dërgoi Pejgamberit (s.a.v.s.) dy kacekë me ujë Zemzemi.

25. Letra drejtuar fisit Has'am

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

O njerëz të fisit Has'am, që jetoni në pyje apo në fshatra, ata që në ditët e tyre të errësirës (përpara përçafimit të Islamit) kanë kryer vrasje, janë të falur.

Cilido prej këtij populli që pranon Islamin do të duhet të paguajë një të njëzetën e prodhimit për vendet e vaditura prej vijave ujitëse dhe një të dhjetën e prodhimit për vendet e ujitura prej shiut⁸¹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Njerëzit e fisit Has'am ishin bujq. Pejgamberi (s.a.v.s.) u dha amnisti të përgjithshme kriminelëve të fisit, në letrën e mësipërme.

⁸¹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 34.

26. Letra drejtuar Zemel bin 'Amr el-Uzrit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Kam dërguar Zemel bin 'Amrit tek populli i tij. Kushdo që përqafoi Islamin, përfshihet në grupimin e Allahut.

Dhe kushdo që refuzon të pranojë Islamin, ka garanci për sigurinë e tij edhe për dy muaj⁸².



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Zemel bin 'Amr u paraqit vetë tek Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe përqafoi Islamin. Pejgamberi (s.a.v.s.) e dërgoi atë me letrën e mësipërme tek populli i tij.

⁸² Risalet en-Nebevijje, f. 151 dhe 152.

PJESA E KATËRT:

**Vendimet, rregullat,
udhëzimet, dokumentet,
e të tjera të shpërndara
prej Pejgamberit (s.a.v.s.),
drejtuar udhëheqësve
të fiseve të ndryshme
apo individëve**

1. Vendimet e Pejgamberit (s.a.v.s.) drejtuar 'Amr bin Murra Xuheniut

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Kjo shkresë është prej Allahut, të Lartit, të Madhërishmit. Ai shpalli se çfarë është e drejtë, nëpërmjet Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.) dhe i dha atij një Libër udhëzues. 'Amr bin Murra do të ketë autoritet të plotë mbi vendin e tij. Ai mund t'i kullotë kafshët e tij dhe mund t'u japë atyre për të pirë kudo që ai dëshiron, me kusht që ai t'i përmbahet pagimit të zekatit të caktuar, përsa i përket kafshëve të tij. Nuk do të ketë zekat për kafshët që përdoren për tërheqje.

Allahu dhe të gjithë muslimanët dëshmojnë për këtë marrëveshje⁸³.

⁸³ Kenz 'ul-ummal, cituar prej Risalet en-Nebevijje, f. 225 - 228.

Shënim. Amr bin Murra i përkiste fisit Xhubeini dhe zotëronte disa toka. Ai kishte shkuar për të kryer haxhin, kur një natë ai pa në ëndërr, sipër Kabes, një shkëlqim verbues, në të cilën u dukën qartë malet e Madinës dhe Xhubeiniut. Ai gjithashtu dëgjoji dikënd të thoshte: "Errësira shkoi dhe u shfaq drita. Pejgamberi i fundit erdhi. Islami u shfaq. Idhujt e tyre u thërrmuan dhe koha e miqësisë dhe dashurisë filloi". Ai u zgjua shumë i tronditur. Pas pak kobe dëgjoji për Pejgamberin (s.a.v.s.) dhe shkoi tek ai. Pejgamberi (s.a.v.s.) e njoftoi atë për pejgamberinë e tij dhe i tregoi se Islami ndalon vrasjet e paligjshme, dhunën, idhujtarinë dhe i urdhëron ata të agjërojnë një muaj në vit. Ai më tej pohoi se ai njeri që i pranon këto urdhëra do të shkojë në parajsë, e kush refuzon t'i kryejë ato, do të shkojë në ferr. 'Amri menjëherë e përqafoi Islamin dhe kërkoi leje që të shkojë tek fisi i tij dhe t'u predikojë atyre Islamin. Njerëzit e fisit të tij, përveç njërit, e përqaftuan Islamin. Gjatë kthimit të tij, Pejgamberi (s.a.v.s.) i dha vendimet e mësipërme për njerëzit e fisit të tij.

2. Vendimet drejtuar Muttarif bin Kahin 'ul-Bahilit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Profetit të Allahut,
drejtuar Muttarif bin Kahin 'ul-Bahilit*

Cilido prej fisit tuaj që do të kthejë në të punueshme ndonjë vend djerrë, ai vend do të jetë i tij.

Këta njerëz duhet që për 30 lopë të japin një lopë si zekat; për 40 dhenë të japin një dele njëvjeçare, dhe për 50 deve të japin një deve 6 vjeçare.

Mbledhësit e zekatit nuk kanë të drejtë t'i shtrëngojnë ata të marrin prej tyre zekatin e ndonjë vendi tjetër përveç livadheve të tyre. Të gjithë njerëzit e fisit janë nën mbrojtjen e Allahut⁸⁴.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁸⁴ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 43, 49.

3. Vendimet drejtuar Xhuhanna për paqe

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Prej Allahut dhe Pejgamberit të Allahut, Muhammed

Kjo letër paqeje është për Xhuhannan, për banorët e Elas, për të shkolluarit e tyre, për varkat lundruse dhe karvanët që mund të jenë në det apo në tokë. Ata njerëz, prej Sirisë, Jemenit dhe Siemenit, të cilët do të jenë me ta, përfshihen gjithashtu në këtë mbrojtje. Për të gjithë ata është garancia e Allahut dhe e Muhammedit, Pejgamberit të Tij. Por kushdo që nuk do ta respektojë këtë premtim, nuk do të jetë nën përgjegjësinë e tyre mbrojtëse.

Uji i burimeve, ku po qëndrojnë këta njerëz, nuk duhet t'i mohohet ndokujt dhe ata nuk kanë të drejtë të bllokojnë ndonjë vend apo udhë detare⁸⁵.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Vendimet e mësipërme të dhëna prej Pejgamberit (s.a.v.s.) iu drejtuan Xhubannas.

⁸⁵ Po aty, f. 37.

4. Dokumenti dhuruar Temim 'ud-Darit (r.a.)

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Muhammedi, Pejgamberi i Allahut, të drejtën e pronësisë të Beit Habron, Beit Ainon, El-Martom dhe Beit Ibrahim, ia ka akorduar Tamim'ud-Dari dhe shokëve të tij. Çdo gjë që gjendet atje do të jetë e tyre.

Pas tyre, pasardhësit e tyre do të jenë pronarët e tyre.

Kushdo që do të mundohet t'i privojë ata nga kjo pronësia, mallkimi i Allahut dhe engjëjve të Tij do të bie mbi të⁸⁶.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁸⁶ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 75.

Shënim. Tamim 'ud-Dari, një osbënar kristian prej Palestine, u paraqit vetë së bashku me një pjesëtar të fisit të tij, tek Pejgamberi dhe përqafoi Islamin. Ai ishte kaq i sigurt në drejtësinë e Islamit dhe përhapjen e tij të shpejtë, sa që iu lut Pejgamberit (s.a.v.s.) t'i japë një akt pronësie, përsa i përket Beit Habronit etj., megjithëse në këtë kohë Kurejshët e kishin bërë jetën e Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe shokëve të tij, të mjeruar dhe jashtëzakonisht të vështirë. Pejgamberi (s.a.v.s.) me mjaft bujari ia plotësoi atij lutjen. Kur u kthye pas betejës së Tebukut, Tamim 'ud-Dari u paraqit përsëri para Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe i kërkoi që ta ripërtrinte dokumentin. Dokumenti i mësipërm iu dha në pajtim me lutjen e tij.

5. Vendimet drejtuar fisit Laham

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Cilido prej Fisit Laham që përqafton Islamin, kryen namazin, paguan zekatin, paguan humsin (një të pestën) për Allahun dhe Pejgamberin e Tij dhe qëndron larg pabesimtarëve, do të jetë nën mbrojtjen dhe përkrahjen e Allahut dhe Profetit të Tij.

2. Por kushdo që do të zbrapset prej fesë Islame, Allahu dhe Pejgamberi i Tij nuk do ta përkrahin atë.

3. Nëse ndonjë musliman do të dëshmojë për ndonjë person se ai është musliman, ky person do të jetë nën mbrojtjen dhe përgjegjësinë e Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.) dhe ai do të përfshihet midis muslimanëve⁸⁷.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

⁸⁷ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 37.

6. Vendimet drejtuar Benu El-Bekkas

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Benu el-Bekka*

Cilido prej jush që përqafon Islamin, kryen namazin, paguan zekatin, qëndron i bindur ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.) e shokëve të tij, dëshmon hapur pranimin e Islamit dhe ndërpret lidhjet me pabesimtarët, është nën mbrojtjen e Allahut të Lartë e të Madhërishëm dhe të Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.)⁸⁸.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Një delegacion prej tre vetash të Fisit Benu el-Bakka, në të cilin ndodhej Muavia bin Saur, u paraqit tek Pejgamberi (s.a.v.s.). Ibn Thaur i kërkoi Pejgamberit (s.a.v.s.) t'ia bekonte djalin e tij Bishr. Pejgamberi (s.a.v.s.) e kaloi dorën e tij mbi fytyrën e Bishrit dhe u lut për mirëqënien e tyre. Thuhet se ky fis, i cili zakonisht përballëj me zininë e urisë, asnjëherë nuk ka vuajtur më nga skamja në territorin e vet dhe prej andej e tutje gjithmonë kanë përparuar.

⁸⁸ Po aty, vol. 3, f. 45.

7. Drejtuar Benu Ukailit

Në enër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Ky vërtetim i Muhammedit, Pejgamberit të Allahut, është për Rabi, Muttarif dhe Anas.

Këtyre njerëzve u jepen tokat e luginës Akik. Derisa ata do të vazhdojnë të kryejnë namazin, të paguajnë zekatin dhe të mbeten të bindur ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.), ata do të gëzojnë të drejtën të marrin përfitimet prej luginës Akik⁸⁹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Një delegacion i fisit Ukail u paraqit tek Pejgamberi dhe përqafoi Islamin. Pejgamberi (s.a.v.s.) u dha atyre një hapësirë toke në luginën Akik. Delegacioni tjetër i fisit Benu Ukail mori një qendër me burime ujërash të quajtur Nuzeim.

⁸⁹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 45.

8. Letra drejtuar Benu Ukailit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Ky vërtetim i Muhammedit, Pejgamberit të Allahut, është për Rabiun, Muttarifin dhe Anasin.

Këtyre njerëzve iu jepen tokat e luginës Akik. Derisa ata do të vazhdojnë të kryejnë namazin, të paguajnë zekatin dhe të mbeten të bindur ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.), ata do të gëzojnë të drejtën të marrin përfitimet prej luginës Akik⁹⁰.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁹⁰ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 45.

9. Drejtuar fisit Barik

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar njerëzve të fisit Barik*

Askush nuk do t'i këpusë frutat e prodhuara prej banorëve të fisit Barik, përveçse me lejen e tyre. Nuk do të lejohet kullotja e kafshëve në livadhet e tyre në ndonjë prej stinëve të dimrit dhe të verës. Sidoqoftë, nëse ndonjë musliman, duke mos pasur livadh, kalon nëpërmjet tokës së tyre me kafshë për t'i kullotur ato, do të jetë në përgjegjësinë e banorëve të fisit Barik ta mirëpresin atë, e shumta për tri ditë. Kur frutat në kopshtet e tyre të piqen, udhëtari gëzon të drejtën të mbledhë dhe të hajë prej frutave të rëna aq sa të plotësojë dëshirën e tij, por ai nuk gëzon të drejtën të bartë fruta me vete⁹¹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁹¹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 81.

10. Drejtuar Zur'a Dhi Xhezan

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Zur'a Dhi Xhezan*

Unë dëshmoj se s'ka tjetër të adhuruar përveç Allahut dhe se unë jam rob dhe Pejgamber i Tij.

Kur të dërguarit e mi Mu'adh bin Xhebel, Abdullah bin Zaid, Malik bin Ibada, Akaba bin Nimr, Malik bin Murara dhe shoqëruesit Theri, të mbërrijnë aty, ju duhet t'i mirëprisni ata dhe t'ua dorëzoni atyre zekatin dhe xhizjen pasi t'i keni mbledhur ato.

Malik Bin Murara më ka njoftuar se prej gjithë fisit Zumavi ju e keni përqaftuar Islamin i pari dhe se ju keni luftuar kundër pabesimtarëve. Për këtë unë u jap lajmin e mirë të bekimeve dhe dua t'ju ngulit juve në mendje që të silleni mirë me vendasit tuaj. Askush nuk duhet trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe ndihma e tyre nuk duhet të refuzohet.

Pejgamberit të Allahut duhet t'i binden të gjithë, të pasur e të varfër. Nuk është e lejueshme për të apo për ndonjë prej të afërmve të tij të pranojë lëmoshë. Zekati që merret është për

muslimanët e varfër dhe udhëtarët dhe pagimi i saj do të thotë pastrim i pasurisë.

Njerëzit që kam dërguar tek ju, në sajë të diturisë dhe veprave të tyre, janë pasues të mirë të rrugës sime. Si rrjedhim, ata meritojnë trajtimin tuaj më të mirë⁹².

Paqja, mirësitë dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁹² Historia e Taberit, vol. 3, f. 153 - 154.

11. Drejtuar prijësve të 'Abahilës, Hadrameutit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar prijësve të Abahilës*

Ju duhet t'i përmbaheni kryerjes së namazit dhe pagimit të zekatit. Është e obligueshme dhe e domosdoshme për secilin prej atyre, për të cilin zekati është i detyrueshëm, të paguajnë zekatin për kafshët, të cilat kanë kullotur në livadhe në pjesën më të madhe të vitit.

Përsa i përket zekatit, nuk është e drejtë të mashtrohet mbledhësi i zekatit me qëllim që të shmanget pagimi i zekatit apo të zvogëlohet ai.

Është gjithashtu përgjegjësi dhe obligim juajë ta ndihmoni ushtrinë Islame me furnizime ushqimore. Dhe për çdo grup prej 10 burrash është e domosdoshme të siguronin ngarkesën e një deveje me drithëra.

Personi i cili e fsheh pasurinë e tij, që në këtë mënyrë t'i kursejë paratë e tij, i ngjan një fajdexhiu që jeton në sajë të kamatës⁹³.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁹³ Risalet en-Nebevijje, f. 295, 297.

Shënim. Për shkak të përpjekjeve intensesive të Hazreti Alisë, Mu'adh bin Xhebelit dhe Ebu Musasë (r.a.), të cilët Pejgamberi (s.a.v.s.) i kishte dërguar tek Hadramenti, e tërë popullsia e Jemenit u konvertua në fenë Islame. Kur Wa'ili, prijësi i Hadramentit u paraqit tek Pejgamberi, ai e bekoj atë dhe i dha vendimet e mësipërme për popullin e tij.

Në një tjetër urdhër të Pejgamberit (s.a.v.s.) njoftohet përqindja e zekatit dhe ndëshkimi për imoralitet. Teksti i tij është si vijon:

12. Letra e dytë drejtuar prijësve të 'Abahilës, Hadrameutit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për 40 dhi është e domosdoshme si zekat një dhi mesatare.

2. Prej objekteve, të cilat janë përfituar nëpërmjet meje, duhet të paguhet një e pesta.

3. Personit, i cili dhunon një virgjëreshë, duhet t'i jepen 100 kamzhikë dhe ai duhet të dëbohet prej vendit të tij për një vit. Ndërsa personi, i cili është fajtor për tradhti bashkëshortore me një grua të martuar, duhet të gurëzohet deri sa të vdesë.

4. Nuk duhet të ketë turp apo plogështi (në ekzekutimin) në atë që Allahu e ka bërë të detyrueshme.

5. Çdo pije alkoholike është e ndaluar.

6. Wa'il bin Huxher emërohet si Guvernator i të gjithë popullit të Hadrameutit⁹⁴.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁹⁴ Risalet en-Nebevijje, f. 295, 297

13. Drejtuar Wa'il bin Huxherit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Wa'il bin Huxherit*

Meqenëse ju e keni përqafuar Islamin, të gjitha pasuritë dhe kalatë tuaja do të mbeten në pronësinë tuaj. Ju si zakonisht do t'i zotëroni të gjitha ato.

Sidoqoftë ju do të duhet të jepni një të dhjetën e prodhimit ('ushr). Vendimi lidhur me mosmarrëveshjet do të bëhen prej dy gjykatësve së bashku. Do të ndërmerren hapa që mbi ju të mos të kryhet shtypje e asnjë lloji, deri në institucionalizimin e rregullave të fesë.

Pejgamberi i Allahut dhe të gjithë muslimanët janë ndihmësit tuaj në këtë çështje⁹⁵.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

⁹⁵ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, fq. 25, 79.

Shënim. Wa'ili i ishte ankuar Pejgamberit (s.a.v.s.) se të afërmit e tij kishin marrë në mënyrë të paligjshme zotërimin e mjaft pronave të tokës së tij. Pejgamberi (s.a.v.s.) premtoi të japë më tepër sesa kërkesa e tij dhe i dha atij urdhërat e mësipërme. Por Wa'ili shumë shpejt u vel me luksin e kësaj jete të përkohshme dhe preferoi Pejgamberin (s.a.v.s.) personalisht dhe ishte së fundi një nga shokët më të shquar të Pejgamberit (s.a.v.s.). Për ata që e kuptojnë kuptimin e vërtetë të kësaj jete luksi i përkohshëm i kësaj bote është i pakuptimtë.

14. Drejtuar kryetarëve të Jemenit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Shuraihbilit dhe Harisit, etj*

Të dërguarit tuaj mbërritën këtu me humsin (një e pesta) e përfitimeve të luftrave), që dërguat ju.

Allahu ka caktuar "ushrin" për prodhimet e tokave dhe frutave të kopshteve të ujitura prej reshjeve. Ndërsa "ushri", për fushat dhe kopshtet që janë të vaditura, është sa gjysma (një e njëzeta ose 5%), me kusht që në të dyja rastet sasia e prodhimit të arrijë 5 wasak (afro dy kuintal të ditëve të sotme)

Përqindja e zekatit për devetë dhe dhitë është:

1. Për 5 deri në 24 deve, që kullosin në livadhe, duhet të jepet një dhi.

2. Prej 25 deri më 35 deve duhet të jepet një "bint mahaz" (një deve e re e cila të ketë hyrë në vitin e dytë të jetës).

3. Prej 36 deri në 45 deve duhet të jepet një "bint labun" (deve e re, e cila ka hyrë në vitin e tretë).

4. Prej 46 deri në 60 deve duhet të jepet një "hikka" (deve femër e cila ka hyrë në vitin e katërt).

5. Prej 61 deri në 90 deve duhet të jepet një "xhiz'a" (një deve femër që të ketë hyrë në vitin e pestë).

6. Prej 91 deri 120 deve duhet të jepen 2 "hikka".

7. Për më tepër se 120 deve, për çdo 40 deve më tepër është caktuar një "bint labun", dhe për çdo 50 deve më tepër është caktuar një "hikka".

8. Për dhitë që kullosin në livadhe, për 40 deri në 120 dhi, zekati është një dhi.

9. Për 121 deri në 200 dhi, duhet të jepen dy dhi.

10. Prej 201 deri 300 dhi, duhet të jepen 3 dhi dhe në këtë mënyrë për çdo 100 dhi, shtohet një dhi.

11. Një kafshë e padobishme, e gjymtuar dhe e vjetër, nuk duhet të jepet si zekat.

12. Për të shmangur zekatin, kafshët e dy personave as duhet të bashkohen, as të ndahen.

13. Për çdo 5 aukias⁹⁶ prej argjendi, obligimi i zekatit është 5 dirhem dhe për më pak se 5 aukias, nuk pagueht zekat.

14. Për më tepër se 5 aukias, zekati është 1 dirhem për çdo 40 dirhem.

15. Për floririn, në çdo 40 dinarë⁹⁷, është i obligueshëm 1 dinar.

⁹⁶ Aukia = 40 dirhemë dhe 1 dirhem është afro një e dhjeta e një onsi, i cili është i barabartë me 28,3 gr.

⁹⁷ Dinari, një monedhë floriri, është e barazvlefshme me 1 funt = 45,3 gr të ditëve të sotme.

16. Nuk është e lejueshme për Muhammedin (s.a.v.s.) dhe të afërmit e tij, të pranojë sadakë dhe zekat. Këto janë vetëm për udhëtarët e varfër etj.

17. T'i shoqërosh dikend tjetër Allahut, ta vrasësh një musliman të pafajshëm, t'i shman-gesh xhihadit (luftës), të jesh i pabindur ndaj prindërve, të akuzosh padrejtësisht një person të pafajshëm, të mësosh magjinë, të marrësh kama-të dhe të grabisësh pasurinë e një jetimi, janë mëkatet më të mëdha përpara Allahut.

18. Askush nuk duhet ta prekë Kur'anin pa e pastruar vetveten.

19. Umra në Shtëpinë e Allahut është një haxh më i vogël.

20. Nuk mund të ketë divorc përpara nika-hut (martesa formale). Me qëllim që një skllav të lihet i lirë është e domosdoshme që së pari ai të blihet.

21. Lutjet nuk mund të kryhen me rroba të cilat nuk e mbulojnë tërë trupin. Është e paleju-eshme (për një grua) të lutet pasi t'i bëjë flokët e saj në formë gunge.

22. Ndaj cilitdo që vret një mu'min (besimtar të vërtetë) duhet të caktohet kisas (ndëshkimi me vdekje), por nëse trashëgimtarët e personit të vrarë pajtohen të pranojnë disa (shpërblimin e gjakut), për të vrarin duhet të jepen 100 deve si kompensim. Shpërblimi për sytë, buzët, shpinën, gjuhën dhe pjesët personale, është i njëjtë.

23. Shpërblimi për një këmbë është 50 deve. I njëjti kompensim është edhe për mamuma (dëmtimin e kafkës, e cila depërton deri tek membrana e trurit). Shpërblimi për jaefa (dëmtimi i barkut) është një e treta. Kompensimi i plagosjes për goditjen me shkop është 15 deve dhe për gishtat e dorës apo të këmbës kompensimi është 5 deve.

Shpërblimi për muzeha (plagosjen e kokës, e cila dëmton kafkën) është gjithashtu 5 deve.

Në kisasin (ndëshkimin) për vrasjen e një gruaje, vrasësit qoftë burrë apo grua, duhet t'i caktohet ndëshkimi me vdekje.

Kjo është përqindja e kompensimit për një njeri të zakonshëm. Një njeri i pasur duhet të paguajë 1.000 dinarë si kompensim⁹⁸.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

Shënim. Siç është përmendur edhe më herët, Pejgamberi (s.a.v.s.) dërgoi 'Amr bin Hazm El-Ensariun si guvernator të Jemenit. Në këtë kohë ai ua dërgoi vendimet e mësipërme administratorëve të tij Shuraih-bilit dhe Harisit.

⁹⁸ Risalat en-Nebevijje, p. 155 dhe 156.

15. Vendimet drejtuar Jezid Binal-Muhaxxhel Harithit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Toka e Nimra-s, pasuritë e saj të ujitjes dhe Wadi Ar-Rahman në pyjet e Nimra-s, do të mbesin në pronësinë e tij.

Jezidi dhe pas tij pasardhësit e tij do të jenë prijësit e fisit të tyre Benu Malik. Askush nuk do të ndër marrë luftë kundër tyre, apo nuk do t'i përzerë ata prej kolonive të tyre.

Shkruar prej Mugire bin Sheube⁹⁹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

Shënim. Vendimet e mësipërme iu dorëzuan delegacionit të fisit Benu El-Harith, i cili vizitoi Pejgamberin (s.a.v.s.) nën udhëheqjen e Jezid El-Harithit.

⁹⁹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 22.

16. Drejtuar Benu Muavij bin Xherwelit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Cilido prej këtij populli që përqafoi Islamin, kryen namazin, paguan zekatin, i bindet Pejgamberit (s.a.v.s.), paguan humsin për Allahun dhe Pejgamberin e Tij (s.a.v.s.) nga fitimet e luftrave dhe deklaroi Islamin e tij, është nën mbrojtjen e Allahut dhe Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.). Çdo gjë, që ishte e tyre në kohën e përqaimit të Islamit do të mbetet e tyre. Ata do të konsiderohen si pronarë të vendit brenda kufijve ku shtrihen dhentë kur janë duke kullotur¹⁰⁰.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

¹⁰⁰ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3. f. 23.

17. Urdhërat drejtuar Dhumeir Saisë

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Kjo shkresë e Mubamedit, Pejgamberit të Allahut,
është për Dhumeir Laisi*

Pejgamberi i Allahut ka vendosur që Dhumaira Laisi të jetë i lirë prej skllavërisë. Tani ai është krejtësisht i lirë. Nëse ai dëshiron të qëndrojë me Profetin e Allahut, ai mund të qëndrojë. Dhe nëse dëshiron të shkojë tek familja e tij, ai mund të shkojë.

Asnjë person nuk duhet ta trazojë atë në ndonjë mënyrë, përveç nëse kjo ka lidhje me rregullat e Allahut dhe të drejtat e njerëzve të tjerë. Cilido musliman që e takon Dhumeira-n, duhet ta trajtojë atë me mirësjellje¹⁰¹.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

¹⁰¹ Isti'ab, vol. 1, f. 229.

Shënim. Një herë Pejgamberi (s.a.v.s.) gjeti një grua duke qarë. Ai ndaloi dhe e pyeti për arsyen e pikëllimit të saj. Gruaja i tregoi atij se djali i saj ishte skllav dhe i shitur. Ajo më tej tregoi se ajo ishte duke qarë, pasi ai ishte mbështetja e vetme e jetës së saj. Pejgamberi (s.a.v.s.) u prek tepër prej tregimit të saj. Ai menjëherë dërgoi një person dhe e bleu Dhumeiran prej zotërisë së tij, e la atë të lirë dhe nxori urdhërat e mësipërme.

18. Urdhërat drejtuar Benu Nehadit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Paqja qoftë mbi atë që i beson Allahut dhe Pejgamberit të Tij!

Çdo person që kryen namazin është mu'min (besimtar) dhe cilido që paguan zekatin është musliman. Dhe cilido që pohon Njeshmërinë e Allahut dhe beson tek Pejgamberi i Tij, nuk do të konsiderohet fajtor përpara Allahut.

Ju keni të drejta të plota t'i përdorni livadhet tuaja dhe askush nuk do t'i presë pemët tuaja. Gjatë mbledhjes së zekatit, ju duhet të tregoheni të bindur dhe kafshët e sëmura dhe të vjetra nuk duhet të jipen si zekat.

Cilido që do t'i përmbahet me vendosmëri këtij premtimi, do të jetë obligim i Pejgamberit (s.a.v.s.) ta ndihmojë atë. Dhe për cilindo që nuk do ta respektojë këtë premtim, kjo do të ishte në dëm të vetes së tij¹⁰².



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

¹⁰² Risalat en-Nebevijje, f. 105 - 107.

19. Urdhëri drejtuar 'Abd Jeguth Al-Harithit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Tokat e punueshme, të cilat ishin në zotërimin e Abd Jeguth El-Harithit, në kohën që ai përqafoi Islamin, gjithçka e tyre, kopshtet e hurmave etj. do të mbeten të tij dhe të njerëzve të fisit të tij, të cilët do t'i binden dhe do ta pasojnë Abd Jeguth.

Derisa këta njerëz do të vazhdojnë të kryejnë namazin, të paguajnë zekatin dhe humsin prej fitimeve të luftrove të shenjta, atyre as do t'u ngarkohet ushri për prodhimet e tokave të tyre, e as nuk do të shpronësohen prej tokave të tyre¹⁰³.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

¹⁰³ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 221.

20. Urdhërat drejtuar Rebi'a bin Dhi Merhab El-Hadrumeutit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Pasuria dhe begatitë e këtij populli, sklevërit e tyre, burimet, kanalet, fshatrat, pemët, bari i pyjeve që rritet në Hadrumeut, do të jenë për familjen e Dhi Merhab.

Kanali me të cilin këta njerëz kryejnë vadijen, që rrjedh prej Ali Kais, do të jetë i tyre.

Prodhimet e kopshteve, të cilat u janë lënë peng atyre, do të jenë e drejtë e personit i cili ua ka lënë atyre peng. Pengmarrësi nuk mund të nxjerrë fitime prej sendit të lënë peng. Allahu dhe Pejgamberi i Tij (s.a.v.s.) nuk kanë për të ndërmarrë asgjë ndaj dikujt që do ta kundërshtojë këtë. Do të jetë obligim i muslimanëve ta ndihmojnë familjen e Dhi-Merhab. Në mënyrë të menjëhershme muslimanët duhet t'i shpëtojnë ata prej humbjes së jetës dhe pronës. Allahu dhe Pejgamberi i Tij (s.a.v.s.) janë përkrahësit e tyre¹⁰⁴.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

¹⁰⁴ Po aty, f.21.

21. Vendimet drejtuar fisit Kelb

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Benu Xhinab të fisit Kelb
dhe përkrabësve të tyre*

Për ata që e kryejnë namazin, paguajnë zekatin, e ruajnë besimin e tyre të fortë dhe përpiqen t'i përmbushin premtimet e tyre, është obligim që nëpërmjet zekatit të japin një dhi, për çdo pesë dhi, të cilat mbikëqyren prej një bariu dhe për 50 deve femra të japin një deve femër pa të meta, së cilës i ka ngordhur i vogli i saj.

Nuk do të vihet zekat për kafshët që bartin ngarkesa në tokat që janë të vaditura prej kanaleve ujitëse, ndërsa për vendet e ujitura prej shiut duhet të paguhet gjysma e ushrit.

Kafshët të cilat humbasin rrugën në hapësirën e tyre, do të jenë të atyre. Asgjë më shumë se sa vlera e caktuar nuk do t'u ngarkohet atyre.

Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë dëshmitarë të kësaj shkrese.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

22. Vendimet drejtuar Mehr bin El-Abjad

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kolonitë e muslimanëve të vërtetë të fisit Mehra nuk do të shkretohen apo rrënohen. Askush nuk do t'i pushtojë ata, e as nuk do të zhvillojë luftë kundër tyre.

2. Është detyrë e këtyre njerëzve të veprojnë në pajtim me urdhërat e fesë.

3. Sendi i humbur do të duhet t'i rikthehet pronarit të vet.

4. Kafshët nuk duhet të mbahen të etura.

5. Mosbindja, bisedat e pasjellshme dhe gjakderdhja duhet të shmangen.

6. Personi i cili do t'u bindet këtyre vendimeve do të jetë nën mbrojtjen e Allahut dhe të Pejgamberit të Tij (s.a.v.s.), ndërsa shkelësi do të konsiderohet si të ishte duke bërë luftë kundër Allahut¹⁰⁵.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

Shënim. Një delegacion i fisit Mehra shkoi te Pejgamberi (s.a.v.s.) nën udhëheqjen e Mehr bin Abjad dhe përqafoi Islamin. Me këtë rast atyre iu dhanë vendimet e mësipërme.

¹⁰⁵ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 34.

23. Vendimet drejtuar 'Amir bin Eswed Tait

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar 'Amir bin Eswed Tait*

Kolonitë, puset dhe burimet e Amirit dhe fisit të tij Tai, do të mbesin në zotërimin e tyre, me kusht që ata të kryejnë namazin, të japin zekatin dhe të qëndrojnë larg të pafeve.

Shkruar prej Mugires¹⁰⁶.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

¹⁰⁶ Tabekat Ibn S'ad, vol. 3, f. 34.

24. Vendimet drejtuar Habib bin 'Amar El-Tait

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Pasuria, tokat, pronat e banimit dhe burimet e atij personi që përqafton Islamin dhe kryen namazin, do të mbesin në pronësinë e tij. Asgjë nuk do të merret prej sendeve në zotërim të tij. Allahu dhe Pejgamberi i Tij janë dëshmitarë të kësaj shkrese¹⁰⁷.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

Shënim. Dy vendimet e mësipërme iu dhanë, prej Pejgamberit (s.a.v.s.), dy kryetarëve të fisit Tai, kur ata u paraqitën tek Pejgamberi (s.a.v.s.) dhe kërkuan ripërtëritjen e të drejtave të pronave të tyre. Ky fis është i mirënjohur kudo në botë për shkak të Hatim Tait, bamirësisë e të cilit ishte e pakufishme.

¹⁰⁷ Po aty, fq. 23.

25. Urdhërat drejtuar Benu Xhuweinit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Muhammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Benu Xhuwain*

Cilido prej fisit Benu Xhuwain beson tek Allahu, kryen namazin, paguan zekatin, qëndron larg të pafeve, mbetet i bindur ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij dhe i përmbahet me vendosmëri Islamit, çdo person i tillë është nën mbrojtjen e Allahut dhe Pejgamberit të Tij. (s.a.v.s.).

Tokat, burimet dhe gjithçka që ata i zotërojnë dhe i përdorin ligjërisht, do të mbesin në pronësinë e tyre¹⁰⁸.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

¹⁰⁸ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 22.

26. Dokumenti dhuruar Zubeir bin Awwamit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

*Prej Mubammedit, Pejgamberit të Allahut,
drejtuar Zubeir bin Awwamit*

Unë ia dhurova Zubeirit tërë tokën e Shawakut. Askush nuk duhet t'i ndërhyjë atij.

Shkruar prej Aliut (r.a.)



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

Shënim. Zubeiri (r.a.) ishte kushëriri (djali i hallës) i Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili e përqafoi Islamin në moshën e hershme 16 vjeçare. Pejgamberi (s.a.v.s.) e kishte bërë zakon të thoshte se çdo pejgamber ka Hawarët (apostujt) e vet dhe se Zubejri ishte apostulli i tij. Ai ishte personi që mori pjesë në të gjitha luftërat. Pejgamberi (s.a.v.s.) i dhuroi atij një çiflig në dokumentin e mësipërm.

27. Dokumenti dhuruar Ausa bin Hurmele Xhuheniut

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Pejgamberi i Allahut (s.a.v.s.) tokën e Dhi'l-Merwah ia ka dhuruar Ausa bin Hurmeles. Ai ia dhuroi atij tërë pjesën e tokës prej Belkeses deri në Musn'a dhe prej Xhelefetit deri në kufi të Xhebeli- Kibla. Askush nuk ka të drejtë ta kundërshtojë atë në këtë çështje¹⁰⁹.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

¹⁰⁹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 26.

28. Urdhërat drejtuar Benu Xhurmuzit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Njerëzit e Benu Xhurmuzit do të gëzojnë paqe dhe siguri në kolonitë e tyre. Çfarëdo pasurie dhe prone që ata e kanë pasur në kohën e pranimit të Islamit do të vazhdojë të mbetet në pronësinë e tyre¹¹⁰.

Shkruar prej Mugire (r.a.).



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

¹¹⁰ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 24.

29. Dokumenti dhuruar Benu Shamahut

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Ky është dokumenti të cilin Pejgamberi Muhammed (s.a.v.s.) ia ka dhuruar Benu Shamahut të fisit Xhuhain. Unë iu kam dhuruar atyre tokën e Sufaina-s, të cilën ata e kanë shenjuar dhe kanë filluar ta kultivojnë. Askush nuk duhet t'i trazojë ata¹¹¹.

Shkruar nga Akaba (r.a.)



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

¹¹¹ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 24.

30. Dokumenti dhuruar Benu El-Harisit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Saria dhe vendet malore të tij i janë dhënë Benu El-Harisit, me kusht që ata ta kryejnë namazin, të japin zekatin, të qëndrojnë larg pabesimtarëve dhe të mbesin të devotshëm dhe të bindur ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij¹¹².



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

¹¹² Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 22.

31. Dokumenti dhuruar Bilal bin Haris El-Muzanit

Në emër të Allahut, të Gjithëmeshirshmit, Mëshirëplotit

El-Nehal, Xhuz'a e të tjerë i janë dhuruar Bilal El-Muzani-t. Përveç këtyre, atyre u janë dhuruar El-Muzza dhe Gaila. Tokat e larta dhe të ulëta të të gjitha këtyre vendeve do të jenë të tyre. Ata gjithashtu zotërojnë burimet, të cilat gjenden në këto vende, me kusht që ata t'i përmbahen Islamit fuqimisht¹¹³.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

¹¹³ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3. f. 25.

32. Dokumenti dhuruar Hiram bin Abd'As-Sulamit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Hiram bin Abdit i dhurohet 'Izama dhe pjesa e Shawakut, që është e tij, do të lejohet të mbetet e tij. Askush nuk duhet të ushtrojë dhunë apo shtypje mbi të në këtë drejtim dhe as do të lejohet që këta njerëz të dhunojnë apo të tiranojnë të tjerët¹¹⁴.

Shkruar prej Halid bin Sa'idit.



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

¹¹⁴ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 26

33. Dokumenti dhuruar Sa'id bin Sufjanit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Kjo dëshmi është një dokument, në bazë të të cilit Pejgamberi i Allahut (s.a.v.s.) i ka dhuruar Sa'id bin Sufjan Er-R'alit kopshtin e hurmave të Es-Sawarakisë. Askush nuk duhet ta marrë në pyetje atë në lidhje me këtë.

Shkruar prej Halid bin Sa'idit.¹¹⁵



*Pejgamberi
i Allahut
Mubammed*

¹¹⁵ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 34.

34. Dokumenti dhuruar 'Utba bin Farkadit

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Në bazë të këtij dokumenti, Pejgamberi (s.a.v.s.) i ka dhuruar Utba bin Farkadit, tokën afër Malit Merwa në Meke për ndërtimin e një shtëpie. Askush nuk duhet ta pengojë atë në këtë drejtim¹¹⁶.

Shkruar prej Muaviut.



*Pejgamberi
i Allahut
Muhammed*

¹¹⁶ Tabekat Ibn Sa'd, vol. 3, f. 34.

Epilogu

Dëshiroj ta përfundoj këtë përpilim me një ndjenjë të thellë mirënjohjeje dhe falenderimi ndaj Allahut, i cili më mundësoi të përkthej letrat, traktatet, paktet, vendimet dhe urdhërat e Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s.), për të mirën dhe udhëzimin e njerëzve që flasin apo kuptojnë anglisht. Dashtë Allahu me Mëshirën dhe Bujarinë e Tij të pakufishme, të denjojë ta mbështesë këtë përpjekje modeste, me aprovimin e Tij të përzemërt. Qëllimi i Pejgamberit (s.a.v.s.) ishte përcjellja e mesazhit të Allahut, gjithë popujve arabë, gjithë vendeve të afërta dhe të largëta, perandorëve të ndryshëm, mbretërve, mëkëmbësve, guvernatorëve, kryetarëve, udhëheqësve e të tjerë, dhe t'i ftonte ata të pranonin Islamin. Po ashtu, qëllimi i këtij përpilimi modest është ta komunikojë udhëzimin e Pejgamberit te sa më shumë njerëz që të jetë e mundur dhe t'u njoftojë atyre detyrat dhe përgjegjësitë e tyre konkrete. Kështu në Ditën e gjykimit, ata nuk do të mund të justifikohen se aksush nuk i ka informuar ata

rreth mësimëve Islame, të cilat janë të vetmet që tregojnë rrugën e drejtë dhe të vërtetë të jetës. Mijëra e mijëra peygamberë (a.s.) janë dërguar prej Allahut, për të kthyer të paudhëzuarit në rrugë të drejtë.

Kur për shkak të nxitjes së shejtanit, Ademi (a.s.) bëri mëkatin e parë, për të cilin Allahu e kishte paralajmëruar atë, si ndëshkim ai me gruan e tij, u urdhëruan të dalin nga parajsja. Pasi u falën prej Allahut, ata u dërguan në tokë. Allahu, megjithatë u tha atyre se cilido që vepron sipas udhëzimeve që Ai do t'u dërgojë atyre "... nuk duhet të ketë as frikë, as pikëllim" (II : 38). Kjo nënkuptohet për pasardhësit e Ademit (a.s.).

Prandaj sa herë që njerëzimi shkonte në udhë të gabuar, peygamberët dërgoheshin për t'i mbajtur ata në udhën e drejtë. Asnjë peygamber nuk e kundërshtonte ndonjë peygamber tjetër, që kishte qenë para tij dhe asnjë Libër i Allahut nuk ishte kundër ndonjë Libri tjetër të Tij. Asnjë prej peygamberëve nuk shpiku ndonjë religjion të ri. Në pajtim me këtë, në Kur'anin e Shenjtë, shpallet qartë:

"Ne e kemi shpallur Tevratin, në të cilin ka udhëzime dhe dritë. Me këtë kanë marrë vendime, ndaj atyre që ishin hebrenj, peygamberët që ishin të përulurit e Allahut. Po edhe njerëz të urtë e të dijsbëm, prej të cilëve është kërkuar ta ruajnë Librin e Allahut, dhe ata e patën dëshmuar këtë." (5 : 44)

Në ajetin 46, të së njëjtës sure është shpallur:

"Pas atyre kemi dërguar Isanë, të birin e Merjemes, i cili vërtetonte Tevratin e shpallur përpara tij, kurse atij i dhamë Inxhilin, ku kishte udhëzim e dritë, dhe përforcim për Tevratin e shpallur para tij, si udhëzim e këshillë për të devotshmit." (5 : 46)

Kur'ani i Shenjtë përsërit se prej të gjithë peygamberëve që ka dërguar Allahu, nuk gjendet askush që të kundërshtojë mësimet e pararendësve të tij, ato që të fusë për herë të parë një besim të ri. Po ashtu, Allahu nuk dërgoi ndonjë prej Librave që të përmbajë diçka të kundërt me Librat e mëparshëm. Në të vërtetë, çdo Libër i Allahut vërtetonte Librat e mëparshëm. Krijuesi dhe dërguesi i Librave është Një, prandaj qëllimet dhe synimet e tyre duhet të ishin të njëjta. Po ashtu, duhet të ishin edhe mësimet e tyre.

Ishte një ndjenjë krenarie dhe superioriteti falls, që i bëri disa njerëz ta quajnë vetveten çifutë, kristianë etj. Allahu nuk krijoi kaq dallime, përndryshe Ai dhe peygamberët e tij (a.s.) do të kishin paralajmëruar për këtë. Meqë burimi, zhvillimi dhe ndryshimet e besimit çifut e kristian, si edhe jeta e puna e Musës dhe Isës (a.s.) janë shqyrtuar hollësisht dhe me vëmendje, është gjetur se që të dy besimet nuk kanë pasur emërtimet që kanë tani, për një periudhë shumë të gjatë kohe, së paku jo gjatë periudhës së jetës së të dy peygamberëve. Kjo tregon qartë se ata nuk

kanë patur ndërmend t'u japin ndonjë emër tjetër mësimëve të tyre, përveç Islamit. Po ashtu, askush prej pejgamberëve nuk pretendoi ndonjë lidhje gjinie me Allahun Fuqplotë, se Ai nuk ka nevojë për të afërm dhe nuk kërkon përkrahje apo ndihmë prej ndokujt, për ndonjë punë. Ai është Një dhe i Gjithëfuqishëm.

Njëshmëria e Allahut dhe Gjithëfuqishmëria e Tij, është një nga veçoritë më të rëndësishme dhe më dalluese të Islamit. Të gjitha religjionet e tjera ose i shoqërojnë dikënd tjetër Allahut, ose e ndajnë Atë në shumë zotëra, dhe kjo përbën burimin e vërtetë të konfliktit, pështjellimit dhe çrregullimit. Rrjedhim thelbësor dhe i natyrshëm i ndarjes së përgjegjësisë në ndonjë fushë të veprimtarisë është pështjellimi dhe konfuzioni. Nëse në fushat e veprimtarisë ekziston përplasje me vetë burimin e fuqisë dhe autoritetit, duke hyrë në juridiksionin e këtij autoriteti, kjo shërben si shkak për të kaluar në kaos dhe çrregullim. Si rrjedhim, Islami e konsideron shirkun (të shoqëruarit e Allahut me dikënd tjetër) si një nga mëkatet më të mëdha dhe më të urryera. Është tepër shprehëse dhe e fuqishme thënia se: *"Nuk ka Zot përveç Allahut dhe Muhammedi është Profet i Tij"*. Pa një besim të patundur në këtë, askush nuk mund të jetë musliman.

Mendjemadhësia, krenaria falso, siguria e tepruar në zotërimin e dijeve dhe aftësive, pasuria

dhe pozitativat e larta, shpesh të mbajnë larg rrugës së besimit tek Allahu, tek të dërguarit dhe tek Librat e Tij. Shumica e peygamberëve ishin tallur prej njerëzve me rangje dhe pozita të larta. Gjykimet e tyre të gabuara dhe të shtrembëruara i çuan ata drejt të menduarit se e tërë bota erdhi në ekzistencë ose aksidentalisht ose rastësisht. Është plotësisht e pabesueshme që diçka që vetë u krijua në mënyrë aksidentale të mund të zhvillohet me përpikmërinë, rregullsinë dhe saktësinë e një mekanizmi oreje. Kur'ani i Shenjtë vazhdimisht u referohet mrekullive të krijuara prej Allahut në trajtën e diellit, hënës, yjeve, kodrave, deteve, lumenjve, shiut, ujit, tokave pjellore, frutave, drithrave ushqyes, luleve, perimeve, kafshëve, gjedhëve dhe të tjera objekte të tilla të panumërta. A mundet ndonjë njeri që me ndihmën e të gjithë njerëzve të tjerë të krijojë madje një organizëm të vogël të gjallë si miza apo mushkonja? Prandaj në vend që të ngrejë supozimin e thjeshtë se bota erdhi në ekzistencë në mënyrë të rastësishme apo nëpërmjet bashkëveprimit të disa elementeve, do të ishte e arsyeshme që ai të besojë tek Allahu, i Cili krijoi gjithçka me qëllim dhe jo për zbavitje.

Ata njerëz që nuk i besojnë Allahut, pikërisht ata dyshojnë në vërtetësinë e Librave të Allahut. Gjatë kohës së hershme të shfaqjes së Islamit, Arabët deklarorin se Peygamberi (s.a.v.s.) e

kishte shpikur vetë Kur'anin. Allahu me vetë Madhërinë e Tij e përgënjeshtroi këtë pohim dhe u bëri atyre thirrje të krijojnë një sure të vogël si ato të Kur'anit dhe të thërrasin ndihmësit e tyre t'i ndihmonin ata në këtë punë. Nuk na duket pa vend të përmendim në lidhje me këtë, se arabët e konsideronin veten letrarë tepër të aftë e të shkathët, shkrimtarë e poetë retorikë dhe i konsideronin të tjerët memecë, por ata u treguan të paaftë të pranonin sfidën. Këtu qëndron edhe shkaku që një person, i cili nuk dinte absolutisht të lexonte dhe të shkruante, sado i aftë apo i zgjuar të ketë qenë, nuk do të mund të përpilonte një libër si Kur'ani i Shenjtë, i cili përmban udhëzim dhe dritë për gjithë njerëzimin, për gjithë kohërat që do të vijnë, i cili përveç të qënit një pjesë e përkryer dhe e papërsëritshme e majave të letërsisë botërore, përmban xhevahire të ndritshme të këshillave dhe urdhërave, se si të jetojmë në këtë vend të përkohshëm me dashuri shpirtërore e vëllazërore, në qetësi e paqe të lumtur. Gjithashtu janë treguar në mënyrë tërheqëse rrëfime, për t'i tërhequr vëmendjen njerëzve për dhunën, pashpirtësinë, urrejtjen e paarsyeshme dhe sjelljen e përbuzshme të njerëzve kundrejt peygamberëve të kohërave të tyre. Si rezultat i sjelljeve të tyre të këqija, zemërimi i Allahut i goditi ata në trajtën e tërmeteve, stuhive të tmerrshme, zisë së urisë, epidemive dhe para së

gjithash me Përmbytje, e cila e shkretoi tokën. Pavarësisht nga ndëshkimi i rreptë i Allahut, njerëzimi vazhdoi të ecë në rrugën e mëkatit dhe vazhdon të veprojë kështu edhe sot.

Përsa u përket Shkrimeve të Shenjta, njerëzit i përgënjeshtrojnë peygamberët (a.s.). Madje sot, një grumbull njerëzish injorantë e mohojnë vërtetësinë e Peygamberit (s.a.v.s.) për shkak të fanatizmit dhe paragjykitimeve. Tani është e qartë, si drita e ditës, se Tora origjinale dhe Bibla përmbanin referime rreth ardhjes së Peygamberit (s.a.v.s.). Është kjo arsyeja që rabinët, priftërinjtë dhe peshkopët, të cilët e kanë lexuar Torën dhe Biblën origjinale të pandryshuar dhe të cilët ishin vërtet të drejtë, të ndershëm dhe besonin tek Allahu, shpallën hapur peygamberinë e Peygamberit (s.a.v.s.). Është thënë edhe më herët në këtë libër se Peygamberi (s.a.v.s.) i kishte shkruar një letër Papës së Romës dhe e kishte njoftuar atë rreth peygamberisë së tij. Papa jo vetëm besoi në peygamberinë e tij, por gjithashtu e dëshmoi atë në një kongregacion. Por dëgjuesit injorantë e morën atë si fyerje ndaj besimit të tyre dhe me zemërim të papërmbajtur e goditën Papën për vdekje. Gjen-den edhe referime prej disa të kristianëve të mirinformuar, të cilët gjithashtu e vërtetojnë peygamberinë e tij. Por ata që kishin sensin e krenarisë falso dhe kishin shkuar në rrugë të shtrembër për shkak të nderimeve dhe përfitimeve të përkohshme të

kësaj bote, jo vetëm që e mbajtën sekret pejgamberinë, por edhe i ndryshuan shkrimet e shenjta. Madje gjendeshin edhe përshkrime të Pejgamberit (s.a.v.s.) në shkrimet e shenjta, por ato u ndryshuan me paramendim, në mënyrë të tillë, që identiteti i Pejgamberit (s.a.v.s.) të mund të bëhej i dyshimtë.

Në ditët e sotme, artistë me përvojë mund të vizatojnë portrete njerëzish, pas dëgjimit me kujdes të përshkrimit të tipareve të tyre fizike, veçanërisht përsa i përket syve, hundës, gojës, mjekrës, flokëve, shtatit, gjatësisë etj. Të tilla piktura imagjinare janë zakonisht mjaft të përpikta. Po ashtu, në kohërat e lashta, mjeshtrit mund të pikturonin përshkrimin e njerëzve pas njohjes së pamjes së tyre, formës, shtatit, gjatësisë dhe përshkrimit të fytyrës. Në këtë libër është përmendur letra drejtuar Çezarit, të cilën Pejgamberi (s.a.v.s.) e besoi në kujdesin e Dahiut (r.a.), i cili ia dorëzoi atë Çezarit në oborrin e tij mbretëror.

Ibn Xheuziu, një hulumtues i mirënjohur dhe kritik i historisë Islame, bëri një zbulim interesant në biografinë e Umerit (r.a.). Ai kishte zbuluar se Dahiut (r.a.) kishte parë një numër të madh pikturash në të gjitha anët e pallatit të Çezarit. Ky i fundit e njoftoi atë se ato ishin pikturat e pejgamberëve dhe e pyeti atë se cila prej tyre ishte piktura e Pejgamberit (s.a.v.s.). Pasi i vëzhgoi me kujdes pikturat, Dahiut tregoi në drejtim të një pikturë dhe tha se ajo ishte piktura

e Pejgamberit (s.a.v.s.). Çezari tha: "Vërtet! Kjo është piktura e Pejgamberit (s.a.v.s.). Ai përsëri e pyeti se piktura e kujt është ajo, që gjendej në të djathtë të tij? Dahi i tregoi se ai ishte Ebu Bekr Es-Siddiku (r.a.), shok i Pejgamberit (s.a.v.s.). Pastaj Çezari e pyeti se piktura e kujt ishte ajo që gjendej në të majtë të tij? Dahi i tha se ajo ishte piktura e Umer Farukut (r.a.), shokut të tij të dytë". Pasi dëgjoji këtë Çezari tha: "Sipas paralajmërimit të Torës, këta janë dy personat, ndër të cilët religjioni juaj do të arrijë në zenitin e tij." Është e qartë se disa piktorë me përvojë duhet të kenë shqyrtuar hollësisht përshkrimin e Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe të shokëve të tij (r.a.) të Tora dhe të Bibla dhe më pas kanë pikturuar portretet. Ky supozim vërtetohet prej Kur'anit të Shenjtë, i cili thotë:

"Atyre që u kemi dhënë Librin e njohin atë (pejgamberin) siç i njohin bijtë e vet. Por një grup prej tyre për shkak të armiqësisë dhe smirës me çdo kusht e fshehin të vërtetën, edhe pse e dinë." (Kur'ani 2:146)

Çezari i bëri të ditur se pikturat kanë ardhur në zotërimin e tij nëpërmjet pejgamberit Daniel. Xhubeiri dhe Ibn 'ul-Wahhabi gjithashtu deklaruan se i kanë parë pikturat e Pejgamberit (s.a.v.s.), përkatësisht në një manastir kristian në Basra dhe në oborrin mbretëror të Perandorit të Kinës.

Gjendet edhe një ndodhi tjetër historike interesante me tepër rëndësi, e cila krijon bindjen

plotësisht, jashtë çdo fije dyshimi, se Ithtarët e Librit kanë pasur dëshmi të sigurta dhe të padyshimta, me ndihmën e të cilave ata pa vështirësi në apo ngurrimin më të vogël mund të njihnin Pejgamberin (s.a.v.s.) dhe shokët e tij. Ka qenë viti 639 e.s. apo viti i 17-të Hixhrij, kur 'Amr El-'Asi e rrethoi Jerusalemin dhe i dërgoi një letër komandantit të vendit, nëpërmjet një personi që e njihnte gjuhën romake, por ai ishte udhëzuar të mos zbulonte faktin se e njihnte gjuhën e tyre. Qëllimi ishte që të merreshin vesh mendimet e popullit të Jerusalemit. Kur letra u lexua, komandanti i tha popullit të tij se dukej e pamundur që 'Amr bin El-'Asi mund të ishte në gjendje të pushtonte Jerusalemin, i cili do të duhej të pushtohej prej një personi në emrin e të cilit gjendeshin vetëm tri shkronja. Mbas kësaj ai përshkroi njeriun i cili do ta pushtonte Jerusalemin dhe tha se ky përshkrim nuk i përshtatej 'Amrit. Si rrjedhim, ai arriti në përfundimin se 'Amri nuk ishte i aftë të pushtonte Jerusalemin. Në këto kushte ai e përcolli të dërguarin thujse me moskokëçarje dhe pa ceremoni. Pas kthimit të tij, ai e njoftoi 'Amrin rreth gjithçkaje që ai kishte dëgjuar. 'Amri tha se përshkrimi i përgjigjej Umer Farukut (r.a.), i cili ishte halif në atë kohë.

Kur Umeri (r.a.) u njoftua për gjendjen, ai menjëherë shkoi në Jerusalem, ku ai menjëherë u njoh prej njerëzve, të cilët ia lanë në dorë qytetin

atij, pa asnjë ngurrim¹¹⁷. Kjo dëshmon qartë rreth vërtetësisë së pejgamberisë së Muhammedit (s.a.v.s.), që njerëzimi e ka njohur nëpërmjet Shkrimeve të Shenjta dhe historisë. Por edhe nga pikëpamje të tjera nuk është e vështirë të arrihet në të njëjtin konkluzion të logjikshëm dhe të arsyeshëm.

Është fakt i pamohueshëm se ka pasur pejgamberë të vërtetë dhe pseudopejgamberë. Por nuk është e vështirë të bësh dallimin midis tyre. Vërtetë, është ambicie natyrale e të gjithë njerëzve të arrijnë kulmin e famës, të bëhen të pasur dhe të ushtrojnë influencë, forcë dhe autoritet. Për të arritur këto qëllime, njeriu ndonjëherë përdor mjete të papëlqyeshme. Kjo është ajo që i dallon ata. Një pejgamber i vërtetë asnjëherë nuk tërhiqet prej këtyre shpërblimeve mediokre të kësaj bote dhe asnjëherë nuk i shmanget misionit, për të përmbushur detyrën, për të cilën ai është dërguar në këtë botë.

Kur Pejgamberi (s.a.v.s.), nën urdhërin e Allahut, filloi të kthejë mizorët dhe shkelësit e ligjit në rrugë të drejtë dhe mohoi haptas adhurin e idhujve, Kurejshët u shtangën. Ata e kishin tallur Pejgamberin, e kishin fyer, e kishin sharë, i kishin shkaktuar vuajtje dhe e kishin plagosur atë.

¹¹⁷ Historia e Taberit, vol.4, f. 158, El-Bidaje we-n-Nihaje, vol. 4, f. 55 dhe Tarih'ul-Kamil, vol. 4, f. 193.

Ata mendonin se Pejgamberi (s.a.v.s.) ishte nxitur prej dëshirës për të fituar famë, pasuri, fuqi dhe pozitë të lartë. Për këtë arsye Utbe bin Rebia, në emër të Kurejshëve, e takoi Pejgamberin dhe e pyeti se çfarë dëshironte ai, a dëshironte Shtetin e Mekës? Apo dëshironte të martohej me ndonjë vajzë prej familjeve të shtresave të larta? A dëshironte ai të arrinte kulmin e pasurisë? Ata i premtuan se do të vendosnin të gjitha këto gjëra në dispozicionin e tij. Ata gjithashtu ishin dakord të vendosnin Mekën nën komandën e tij, me kusht që ai të hiqte dorë prej predikimeve të tij. Kurejshët ishin plotësisht të sigurt se ai do ta pranonte ofertën e tyre. Si përgjigje, Pejgamberi (s.a.v.s.) lexoi ajetin 6 dhe 9 të kapitullit Fussilet, të Kur'anit, që thotë:

"Thuaj: Unë jam njeri sikurse edhe ju, që më shpallët se Zoti juaj është vetëm Një Zot, prandaj jini korrekt ndaj Tij dhe kërkonit falje!"

Thuaj: "A, me të vërtetë ju mohoni Atë i cili ka krijuar tokën për dy ditë, madje i bëni edhe shok?! Ai është Zot i botërave!"

Kur 'Utbe u kthye, ai ishte shndërruar plotësisht në tjetër njeri. Ai i njoftoi Kurejshët se ato që ofronte Muhammedi nuk ishin poezi, por diçka tjetër. Prandaj për këtë arsye ai ishte i mendimit se Muhammedi nuk duhej të shqetësohej. Më tej ai vërejti se nëse ai ishte i suksesshëm dhe e merrte në zotërim Arabinë, do të

ishte nder edhe për ta, në të kundërtën Arabia do t'i jepte fund atij. Kurejshët nuk e pranuan këtë mënyrë veprimi.

Umeri (r.a.) ishte krejtësisht kundër Islamit dhe armiku më i egër i Pejgamberit (s.a.v.s.). Ai ishte jashtëzakonisht agnosticist, madje edhe ndaj atyre që e pranonin Islamin. Më së fundi ai vendosi t'i japë fund jetës së Pejgamberit (s.a.v.s.). Rrugës ai takon rastësisht Naim bin Abdullahun, i cili e pyeti se ku ishte duke shkuar. Umeri (r.a.) e njoftoi atë për qëllimin e tij. Naimi i tha atij të vendoste së pari rregull në shtëpinë e tij dhe i tregoi atij se motra e tij dhe burri i saj tashmë e kishin përqaftuar Islamin. Kjo e egërsoi më tepër Umerin (r.a.). Ai menjëherë u kthye dhe shkoi tek shtëpia e motrës së vet dhe i dëgjoji ata duke lexuar Kur'anin e Shenjtë. Ata u përpoqën ta fshihnin Kur'anin. Ai filloi ta mendojë dhëndrin e tij. Motra e tij u përpoq ta shpëtojë burrin e saj, por Umeri filloi ta godasë edhe atë gjithashtu. Por ajo i tha: "*Umer, çfarëdo që ti të bësh, Islami nuk mund të çrrënjohet prej zemrës sime*". Këto fjalë e prekën atë tepër. Ai vështroi motrën e tij të gjakosur me dhembshuri dhe dashuri dhe i kërkoi asaj t'i tregonte se çfarë ishin duke lexuar ata. Motra e tij e vendosi Kur'anin përpara tij dhe ai filloi të lexojë. Surja El-Hadid, ajeti i parë:

"Allahun e lartëson çka ka në qiej e në tokë. Ai është i Forti, i Urti".

Ai u impresionua së tepërmi prej çdo fjale. Kur ai arriti në fillim të ajetit të 7-të që thotë: *"Besoni Allahun dhe Profetin e Tij"* - ai tha i entuziasmuar: *"Dëshmoj se s'ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është peygamber i Tij"*.

Menjëherë ai nxitoi për te Peygamberi (s.a.v.s.), i cili e pyeti: *"Umer, me çfarë qëllimi ke ardhur?"*

Këto fjalë i shkaktuan drithma atij dhe ai me përulësi iu përgjigj: *"Të fitoj besimin (tek Allahu dhe peygamberi i Tij)."*

Kjo ngjarje solli një kthesë rrënjësore dhe Islami filloi të zgjerohej gradualisht. Kjo ishte kryesisht pasojë e kurajos, burrërisë, qëndresës, këmbënguljes dhe durimit të Peygamberit (s.a.v.s.) dhe shokëve të tij besnikë, të cilët nuk i përfillën shqetësimet e mundimshme, vështirësitë, mjerrimin, skamjen dhe privimet. Madje floriri, argjendi dhe paratë ishin të një rëndësie të papërfillshme për ta. Sasi të mëdha floriri, ari, dinarësh dhe derhermësh, i ishin dërguar Peygamberit (s.a.v.s.), por ai, të gjitha ato, ua shpërndante nevojtarëve, të paaftëve dhe të varfërve. Një copë argjendi kishte mbetur pa shfrytëzuar. Peygamberi (s.a.v.s.) shkoi në shtëpi, por nuk ishte i qetë dhe nuk mundi të qetësohej derisa ia dha arin një të varfëri. Ndërsa në shtëpinë e vet për disa ditë me radhë nuk ishte gatuar ushqim. Këtu qëndron kriteri i drejtë i vërtetësisë së një njeriu dhe mbi të gjitha i peygamberisë. Diku në këtë libër,

gjendet një referim i shkurtër për peygamberin e rremë, i cili jepet pas pasurisë materiale, fuqisë dhe famës.

Peygamberi (s.a.v.s.) mund të grumbullonte pasuri të panumërt. Ai mund të ishte një perandor despot dhe i fuqishëm. Ai mund të kishte ndërtuar për vete pallate të pakrahasueshme. Ai mund të kishte një numër të madh shërbëtorësh dhe shërbëtoresh. Por ai nuk dëshironte asgjë prej këtyre. Ai thajse ecte pa asnjë grosh në xhep, hante bukë elbi të pabluar mirë, të cilën ai e gëlltiste poshtë me ndihmën e ujit, për të mposhtur urinë e tij. Ai flinte në një krevat me gjethe hurmash ose në një shtrat të thjeshtë të thurur me vargje të gjetheve të palmës, të cilat linin shenja të thella në trupin e tij. Njëherë Umeri (r.a.) shkoi ta shihte Peygamberin (s.a.v.s.), të cilin e gjeti të shtrirë në shtrat. Në trupin e tij gjendeshin gjurmë të thella të lëna prej thurjeve të ashpra. Në një qoshe gjendej një grusht tërshërë. Në qoshen tjetër varej një kacek ujë. Lotët rrëshqitën nga sytë e Umerit (r.a.) dhe ai filloi të qajë me ngashërim. Peygamberi (s.a.v.s.) e pyeti se çfarë e bëri atë të qajë. Umeri (r.a.) tha: "E çfarë arsyeje më të madhe mund të ketë për të qarë? Çezari dhe Kisraja janë zhytur në luksin e kopshteve dhe pallateve përrallore, ndërsa ju, megjithëse jeni Peygamber, jetoni në kushte kaq të mjera". Peygamberi (s.a.v.s.) iu përgjigj qetësisht:

"A nuk je i kënaqur me faktin se ata kanë këtë botë, kurse ne tjetrën". A mund të gjendet dëshmi më e madhe se kjo, për vërtetësinë e tij.

Bota nuk mund të paraqesë, madje një shembull të vetëm të ndonjë personi tjetër, i cili shkëlqen me kaq madhësi në të gjitha fushat e mundshme të veprimtarisë njerëzore, ashtu sikurse Pejgamberi (s.a.v.s.). Ai lindi jetim dhe kur i mbushi 6 vjet i vdiq edhe nëna e tij. Më pas ai u mor nën përkujdesjen e gjyshit të tij dhe, pas vdekjes së tij, të xhaxhait të tij. Në moshën dhjetë apo dymbëdhjetë vjeçare ai u mor me ruajtjen e dhenve. Kjo ndoshta nënkuptohet si një fillim drejt përgjegjësisë së tij të madhe në të ardhmen, të udhëheqjes së mbarë botës. Ai u mor prej xhaxhait të tij, në një udhëtim tregtie për në Siri, në moshën 12 vjeçare. Në Basra ata zbritën në një manastir të një oshënari kristian, i cili pasi e pa Pejgamberin (s.a.v.s.) tha: "Ky është Sejjid 'ul-murselin" (Zotëriu i pejgamberëve).

Pas kësaj Pejgamberi (s.a.v.s.), si fëmijë, e shoqëroi shumë herë, xhaxhain e tij, Ebu Talibin, në udhëtimet e tij tregtare. Emri i tij si njeri i mirë, i drejtë dhe tregtar i ndershëm, u përhap gjithandej. Tregtarët kërkonin pjesëmarrjen e tij në punët e tyre tregtare, gjë që ai e pranonte me kënaqësi. Kështu ne e shohim atë në rininë e tij të hershme të mbajë titullin "Tregtar i ndershëm". Ai e prezantoi veten si mishërim të vërtetësisë,

drejtësisë dhe ndershmërisë. Ai gjithmonë i përmbahej fjalës dhe premtimeve të tij dhe mbante qëndrim të drejtë e të ndershëm. Njerëzit i dhanë atij titullin "Emin" (I ndershëm dhe i drejtë). Për shkak të këtyre cilësive, Hadixhja (r.a.), një e vejë tepër e pasur dhe e devotshme, i kërkoi atij t'i merrte mallrat e saj tregtarë për në Siri dhe i premtoi se do t'i paguante atij dyfishin e shpërblimit, që zakonisht ajo u paguante të tjerëve. Pejgamberi (s.a.v.s.) e pranoi propozimin dhe i mori mallrat e saj për në Siri. Hadixhja (r.a.) i dërgoi propozim për martesë Pejgamberit (s.a.v.s.), tre muaj pas kthimit të tij, dhe dasma u bë në shtëpinë e saj.

Pas kësaj erdhi faza e pejgamberisë. Në lidhje me këtë, duhet thënë se madje edhe para pejgamberisë së tij, Pejgamberi (s.a.v.s.) gjithmonë u ishte shmangur zakoneve që të çonin drejt shirkut (të shoqëruarit e ndokujt tjetër me Allahun). Ai kurrë nuk kishte treguar respekt për ndonjë idhull. Ai shpesh shkonte tek shpella Hira dhe qëndronte atje për ditë të tëra. Atje ai zhytej në mendime dhe meditonte. Pikërisht aty iu dha shpallja për herë të parë. Pejgamberi (s.a.v.s.) u trondit. Kur u kthye dhe ia rrëfeu ngjarjen Hatixhes (r.a.), ajo e shpuri atë tek një i afërm i saj kristian, që quhej Waraka bin Neufel, i cili ishte një njohës i mirë i Torës dhe Biblës. Pasi e dëgjoji të tërë ngjarjen, ai dëshmoi pejgamberinë

e tij. Ai nuk ishte vetëm peygamber, por edhe gjykatës, ligjdhënës, administrator, sundimtar dhe gjeneral gjithashtu. Me aftësitë e tij, me të cilat ai përballonte detyrat që qëndronin para tij, sado të vështira të ishin ato, ai i provoi botës se ishte gjykatësi më i arsyeshëm, më i drejtë dhe më i paanshëm, para të cilit edhe miqtë edhe armiqtë ishin të barabartë, se ishte ligjdhënësi më madhështor, administratori më i aftë dhe më mendjekthjellët, sundimtari më zemërmirë, më i mëshirshëm dhe më mirëdashës, i cili ishte më tepër mirëbërës, mësimdhënës dhe i përulur ndaj Allahut sesa sundimtar. Si gjeneral ai ishte një njohës i mirë i strategjisë së luftës dhe madje edhe detajet më të vogla nuk i kalonin vëmendjes së tij. Ai vetë i rregullonte radhët e rreshtat e luftëtarëve, dhe i mbante ato në vijë të rregullt. Ai gjatë zhvillimit të luftimeve e ndalonte rreptësisht rrëmujën. Ai vetë jepte udhëzime rreth çdo çështjeje. Në betejën e Uhudit, muslimanët pësuan humbje të rëndë, sepse nuk i zbatuan udhëzimet e tij. Në vitin e 5-të Hixhrij, Kurejshët vërshuan për të pushtuar Medinën me një ushtri të madhe prej 24 mijë luftëtarësh, e cila përfshinte të gjitha fiset arabe dhe çifute. Peygamberi (s.a.v.s.) vërejti se në tri anë të Medines gjendeshin shtëpi dhe kopshte hurmash, të cilat siguronin një mbrojtje të mirë. Prandaj ai hapi një hendek në anën e katërt të pambrojtur. Kurejshët

sulmuan furishëm. Megjithatë, ata nuk mundën ta kapërcejnë hendekun. Beteja vazhdoi për afro një muaj. Armiku filloi të lëkundet dhe të dobësohet moralisht. Në këtë kohë një erë e fuqishme i shkulli çadrat në kampin e kundërshtarëve. Armiqtë e lanë fushëbetejën të dekurajuar plotësisht.

Kështu Pejgamberi (s.a.v.s.) dha dëshmi të përsosmërisë së tij në të gjitha fushat e jetës. Bota nuk ka paraqitur deri tani një personalitet të tillë kaq të përkryer.

Allahu është Një dhe i Gjithëfuqishëm. Të gjithë pejgamberët (a.s.), posaçërisht Pejgamberi i Tij i fundit (s.a.v.s.) dhe Librat e Tij janë të vërtetë. Përse të mos e ndjekim të gjithë rrugën e drejtë të Allahut, e cila është e vetmja që të udhëheq drejt paqes, qetësisë, sigurisë dhe mirëqenies së të gjithë njerëzimit?

Çdo qenie njerëzore, çfarëdo ngjyre, gjuhe apo vendi qoftë, meriton respekt dhe ka të drejtë të jetojë në këtë botë me nder dhe në paqe. Varet tani prej nesh ta bëjmë këtë botë një qiell të paqes apo ta kthejmë atë në skëterrë.

9 789989 580598

ISBN 998958059-6



LOGOS-A ■ LETRAT E MUHAMMEDIT A.S.

Sulltan Ahmed Kureshi